Shaban Çupi

FLAKADANËT E LIRISË

2

Monografi

2022

Hani i Elezit në vite të ndryshme

Një pamje tjetër e Hanit të Elezit

Vështrim i përgjithshëm mbi trevën e Hanit të Elezit

1. Pozita gjeografike e komunës së Hanit të Elezit

Treva e Hanit të Elezit shtrihet në pjesën jugore të Kosovës dhe përkufizohet me Republikën Veriore të Maqedonisë. Vijës kufitare, dhe përballë fshatrave të Hanit të Elezit, shtrihen fshatra të tjera shqiptare, si Bllaca, Nigishtani, Greqani, Radusha, Jazhinca dhe si rrallë kund në botë, një komb përkufizohet padrejtësisht me vetveten e tij.
Historikisht kjo trevë ka frymuar ndërmjet Kaçanikut dhe Shkupit dhe pothuajse të gjitha ngjarjet që kanë ndodhur, në një formë apo tjetër pjesëmarrëse ishte edhe kjo trevë.
Fshatrat e kësaj treve janë të vjetër dhe evidentohen edhe në defterët osman të shekullit XV, ndërsa në lashtësi, gjallërimi i kësaj treve dëshmohet me gjetjet arkeologjike, ekzistimi i dy kalave, ajo e Hisarit në Rezhancë dhe tjetra në mes fshatit Dimcë dhe Bardh të cilat në jug ndërlidhen me kalanë e Justinianit në Shkup.
Këtë trevë e ndanë në dy pjesë lumi Lepenc, në rrjedhën e djathtë, malet e Sharrit dhe në të majtë, malet Rodope. Reka e Dimcës dhe Përroi i Rezhancës (Ortika), shpesh herë kanë shkaktuar vërshime në këtë trevë duke shkaktuar dëme jo të vogla, madje ekziston një gojdhënë e përcjellur në breza se në vendbanimin e sotëm të Hanit të Elezit ka ekzistuar një vendbanim tjetër të cilin e kanë përmbysur ujërat. Gjetja e pllakava – stellave të shekullit II e III, varre të vjetra, sarkofak, themele kishash paleokristiane e relikte të tjera, këtë gojdhënë e bëjnë shkencërisht të pranueshme. Toponimet dhe mikrotoponimet janë tejet domethënëse dhe na ndërlidhin natyrshëm në histori me indin tonë iliro-dardan.
Treva e Hanit të Elezit ka në një florë e faunë të pasur dhe një gërshetim klimash, përkatësisht një kufi klimatik i cili është i dobishëm për shëndetin e njeriut. Edhe kjo trevë, si i tërë fati i keq i trojeve shqiptare në histori, ka pësuar në rrëmujat e kohas, duhe humbur jeta njerzish dhe të mira materiale.Nga shtatori i vitit 2005, kjo trevë ka statusin e komunës dhe është aktive në të gjitha proceset shoqërore. Ka rreth 83 km² dhe dhjetë mijë banorë. Aktualisht ka këto vendbanime: Hani i Elezit, Seçishtë, Kryenik, Rezhancë, Gorancë, Puset e Nikës, Laç, Paldenicë, Dërmjak, Dimcë, Dermjak, Neçavc, Meliq dhe Lagjen e Re dhe ate të Ujit të Thartë.

2. Lufta për arsim, emancipim dhe avansim politik

Lufta e Dytë Botëror këtë trevë e gjeti krejtësisht analfabete. Të rrallë ishin ata që dinin shkrim lexim, andaj që nga viti 1946 u hapën edhe shkollat e para shqipe, por mungonin mësimdhënësit e trevës. Që të zhvillohej mësimi shqip, erdhën mësues nga viset e tjera shqiptare dhe vendosën themelet e shkollimit i cili u ngrit nëpër dekada me aq fuqinë dhe mundësinë që kishte. Megjithate, kishte njerzë arsimdashës të cilët e dinin se një komb zhvillohet vetëm nëpërmjet arsimimit dhe me kalimin e kohës u krijuan edhe kuadrot e para mësimdhënëse ku edhe në këtë drejtim nuk munguan sukseset. Në anën tjetër, duke i shfrytëzuar rrethanat pas rënies së Rankoviqit, dhe pas demonstratave të fuqishme të vitit 1968 u krijua Autonomia e Kosovës, por fatkeqësisht nën sqetullën e Serbisë dhe politikës së saj hegjemoniste.

3. Demonstratat e vitit 1981 dhe ndikimi i tyre në Han të Elezit

Në vitin 1978, 1979, 1980, 1981 u krijua një masë domethënëse studentore dhe meqë politika autonomiste ishte mbyllur në vetveten e saj, shpërthyen demonstratat e pranverës së vitit 1981, fillimisht me karakter social, por që shumë shpejtë u avancuan në kërkesa politike për Kosovën Republikë. Në vend që të njihej kjo kërkesë paqësore e studentëve dhe masave punonjëse, regjimi i Beogradit me tërë forcën e tij e lau në gjak këtë shtresë demonstruesish e në anën tjetër synohej mbytja e kësaj ideje shtetformuese, pasiqë politika jugosllave e kishte kuptuar mirë se nëpërmjet Kosovës Republikë, Kosova synonte shtetin e saj. Filluan burgosjet masive, diferencimet brenda llojit dhe shkatërrimi i gjërave progresiste që u krijuan me mund. Kjo frymë represive sllave e përfshiu edhe trevën e Hanit të Elezit, ku burgosi, torturoi, diferencoi dhe anatemoi shtresa që patën guximin politik që në mënyrë të fshehur dhe të hapur luftonin për Kosovën Republikë. Burgosja e këtyre shtresave studentore dhe intektuale ndikuan në zgjimin kombëtar të trevës dhe me 26 janar 1990 shpërtheu edhe demonstrata e parë në Han të Elezit.

4. Rezistenca paqësore dhe kryengritja e armatosur

Në këto rrethana të rënda, socializmi jugosllav kolapsoi, bashkë me atë edhe ai në Europën juglindore. Në ish Jugosllavi u vendos sistemi shumë partiak e në dhjetorin e vitit 1989 u formua edhe Lidhja Demokratike e Kosovës dhe u shemb monizmi si sistem. Masat e gjëra shoqërore iu bashkangjitën kësaj Lidhje me të vetmin qëllim avancimin shtetndërtues të Kosovës. Pavarësisht se me 2 korrik 1990 Kuvendi i Kosovës shpalli Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës dhe me 7 shtator 1990 miratoi edhe Kushtetutën e Republikës së Kosovës në Kaçanik, represioni serb me të gjithë arsenalin e tij shtypte çdo gjë avancuese me burgosje, ndjekje, vrasje

e presione të tjera. Në këtë ingranazh dhune kaloi edhe popullata e kësaj ane. Përballë kësaj gjendje dhe kundër dhunës serbe në Han të Elezit u zhvilluan protesta të ndryshme dhe në çdo protestë, vetëdija për liri e çlirim ngritej, saqë një ditë u kuptua se lufta me armë është e domosdoshme, pavarësisht sakrificave.

5. Formimi i Brigadës 164,, Gafurr Loku'' të UÇK-së dhe lufta për liri

Dalja e UÇK-së në skenë më 28 nëntor 1997, ndikoi që shumë shtresa atdhetarësh të rreshtohen nën flamurin e saj të lirisë, por kur më 5, 6 e 7 mars 1998 u sulmua familja Jashari në Prekaz dhe u vra Komandanti i UÇK-së Adem Jashari, situata mori krejtësisht rrjedhë tjetër. Në të gjitha anët shpërtheu vrulli i lirisë dhe djalëria e Kosovës iu bashkangjit radhëve të UÇK-së. Kjo ndodhi edhe në Han të Elezit, ku fillimisht fshehurazi, filloi futja e armëve. Ndërkohë grupi zbulohet e për pasojë një pjesë e grupit burgoset, ndërsa pjesa tjetër që arriti të shpëtoj nga këto arrestime, formuan Njësitin e UÇK-së në Puset e Nikës i cili gradualisht dhe në rrethana lufte u ngrit në Brigadë çlirimtare. Kjo Brigadë dha një kontribut maksimal për liri dhe si rezultat i kësaj lufte dhe ndihmën që na e dhanë forcat ndërkombëtare të NATO-s, më 11 qershor 1999 u çlirua treva e Hanit të Elezit.. Kjo Brigadë u ballafaqua me sulmet gati të përditshme nga ana e forcave policore-ushtarake serbe e njëkohësisht duke rënë në fushën e luftës edhe dëshmorët e lirisë.

6. Dëshmorët e komunës së Hanit të Elezit

Kjo vetëdije e ngritur kombëtare e cila u bë në rrethana të rënda e me përplotë sakrifica, arriti edhe kulmin e flijimit për liri, rënien e dëshmorëve të cilët ishin dhe mbetën krenaria e kësaj treve. Në Pashtrik më 14 dhjetor 1998 ra Veli Ballazhi, më 21 shkurt 1999 u vranë Gafurr e Driton Loku, më 2 e 3 mars 1999 ranë Nuri Bushi e Xhemsedin Suma, në Koshare bie Imri Curri, në malet e Kaçanikut bie Imer Vila, ndërsa në burgun e Dubravës vritet Suad Brava. Pas përfundimit të luftës së Kosovës, në vitin 2001 shpërtheu lufta në viset shqiptare në Maqedoni dhe meqë shumë pjesëtarë të UÇK-së nga kjo anë po merrnin pjesë në luftën për çlirimin e trojeve në Maqedoni, në altarin e lirisë ranë edhe Elham Curri, Ilaz Thaçi, Baki Krasniqi, Nehat Curri, Qemal Thaçi dhe më vonë statusi i dëshmorit iu njoh edhe Ramadan Shitit dhe Izet Bushit.

7. Monografi për dëshmorët

Në vitin 2012, shkruam monografinë për dëshmorët e komunës së Hanit të Elezit dhe e botuam me emrin ,,Flakadanët e lirisë'' dhe në shenjë nderimi e respekti e botuam nën autorësinë e Familjeve të Dëshmorëve. Në rrjedhë

të kohës, vargu i dëshmorëve u shtua edhe për dy të tjerë, si: Ramadan Shiti e Izet Bushi dhe në 20 vjetorin e rënies u ngritën pllaka të tjera përkujtimore për dëshmorët dhe u mbajtën manifestime e Akademi të ndryshme. Ndërtuam shkollën muze për mësuesin Ilaz Thaçi në Kryenik, e nga ana tjetër, Presidenti i Republikës së Kosovës, z. Hashim Thaçi, (aktualisht padrejtësisht në burgun e Hagës), në vitin 2019, me titullin Hero i Kosovës ka dekoruar: Veli Ballazhin, Gafurr Lokun, Driton Lokun, Nuri Bushin, Xhemsedin Sumën, Imri Currin, Imer Vilën e Suad Bravën, andaj nevoja për një rifreskim dhe zgjerim të monografisë u bë i domosdoshëm, por tani me emrin ,,Flakadanët e lirisë 2''.

Nëpërmjet kësaj monografie dhe vet titullit të saj, ne synojmë ta ruajmë monografinë e parë, pra të ruajmë materien dhe kontinuitetin e monografisë duke e plotësuar ate nëpër dekada me elemente dhe ngjarje të reja që ndodhin në kohë. Ideja është që kohë pas kohe, monografia e Flakadanëve të rifreskohet, ashtu siç po e rifreskojmë ne pas dhjetë viteve distancë nga botimi i parë. Në këtë mënyrë ky projekt monografik do të jetë i qëndrueshëm në kohë dhe do të bartë mesazhin nëpër breza.

Autori: Shaban Çupi, Paldenicë, 2022

DËSHMORËT E KOMUNËS SË HANIT TË ELEZIT

Veli Ballazhi



Gafurr Loku

Driton Loku



Xhemsedin Suma

Nuri Bushi

Imri Curri

Imer Vila

Suad Brava

Elham Curri

Ilaz Thaçi

Nehat Curri

Baki Krasniqi

Izet Bushi

Qemal Thaçi

Ramadan Shiti

I përjetshëm qoftë kujtimi për dëshmorët e kombit, LAVDI!

Veli Ballazhi (1978-1998)

...Ërfëllizës së dhjetorit
Ia dhash armët e mia
T`i bart n`Puse t`Nikës
Që të agoj liria...

Atë vit, kur Lidhja Shqiptare e Prizrenit, shënonte 100 vjetorin e themelimit të saj, në Lagjen e Re të Hanit të Elezit, përkatësisht në shtëpinë e Beqir Ballazhit, lindi dëshmori i lirisë Veli Ballazhi, për të mbetur i pavdekshëm në faqet e historisë kombëtare ashtu si gjithë dëshmorët tjerë të atdheut.

Veli Ballazhi rrjedh prej një familje, e cila në Lagjen e Re të Hanit të Elezit ishte zhvendosur nga Puset e Nikës.Ky fshat gjatë rrjedhave të historisë, si vend malor që ishte, gjetën strehim shumë kaçak e në mesin e tyre edhe tribuni i komunës së Kaçanikut, nacionalisti Avdyl Dura.

Kjo familje ishte aktive edhe në ngjarjet e vitit 1981 e më pas. Djali i axhës së dëshmorit, Nexhat Ballazhi, në vitin 1987, zbulohet dhe arrestohet me shumë shokë të tij për veprimtari ilegale politike të cilët me grupin e tyre „Kushtrimi'' shpërndanin rrezet e lirisë pothuajse në çdo skaj të kësaj treve. Dënimi i Nexhat Ballazhit me shokë si dhe bisedat që bëheshin çdo natë në familjen Ballazhi rreth zhvillimeve në Kosovë, në shpirtin e Veliut të ri, kalitën shpresën e lirisë, forcuan ndjenjën e çlirimit.

Kur në qershorin e vitit 1998, në Puset e Nikës, u formua njësiti i parë i UÇK-së, flaka çlirimtare e kësaj ushtrie të lavdishme po depërtonte në çdo shtëpi të trevës së Hanit të Elezit dhe kjo shkëndijë e përflakshme ndezi edhe shpirtin e njomë të njëzetvjeçarit Veli Ballazhi. Ai me 13 tetor të vitit 1998 së bashku me kusherinjtë e tij Samet Ballazhin dhe Mehmedali Ballazhin, nëpërmjet Maqedonisë, nga pika kufitare e Qafës së Thanës kalojnë në Shqipëri.

Pasi u përshëndetën me familjen, që të tre, nga shtëpia dolën një nga një që te mos i hetonte policia serbe e cila ishte afër shtëpive tona, rrëfen vëllau i dëshmorit, Fehmi Ballazhi, gjithashtu pjesëtar i UÇK-së që nga 14 prilli 1999 në Kosharen heroike pranë Brigadës 138 ,,Agim Ramadani''.Te ura mbi lumin Lepenc e përqafova fort duke i uruar rrugë të mbarë dhe nga malli që më shpërtheu në shpirt i thash se pas teje do të vijë edhe unë sepse kjo është dita që e kemi pritur të gjithë, vazhdon rrëfimin e tij Fehmiu duke shtuar se ky ishte edhe takimi im i fundit me vëllaun tim për së gjalli.

Ne, thotë Samet Ballazhi, bashkëluftëtar i Veliut, duke vërejtur se për t`iu bashkangjitur Njësitit të UÇK-së në Puset e Nikës duhej të kishim armë, vendosëm që me Veliun dhe Mehmedaliun të kalojmë në Shqipëri dhe nga tetori e deri më 12 dhjetor të vitit 1998 stërvitemi në bazat e UÇK-së. Meqenëse dëshira jonë ishte që sa më parë të futeshim në Kosovë, me 13 dhjetor kalojmë nga Vlana në Cahan dhe nga Cahani me 14 dhjetor së bashku me 148 ushtarë të tjerë, futemi në Pashtrik por, para se të arrijmë në Lubizhdë të Hasit biem në pritën e ushtrisë serbe ku do të zhvillohen luftime të rrepta dhe krahas armikut të parë, të dytin e kishim borën dhe acarin e madh si dhe peshën e rëndë me armatim në shpinë,thote ai.

Më 13 dhjetor 1998, komandanti Mujë Krasniqi, pasi ishte konsultuar me komandantët dhe vëzhguesit e terrenit për ta kaluar kufirin, kishte tubuar luftëtarët e lirisë, të cilëve iu kishte mbajtur një fjalim. Komandanti kishte kërkuar nga të gjithë luftëtarët që nuk ndiheshin mirë, ose ata që ishin të sëmurë, të mos lëviznin, ndërsa të gjithë ata që ndiheshin të fortë dhe të disponuar për të hyrë në frontet e luftës në Kosovë të bëheshin gati [1]. Njëri nga ata që me plotë dëshirë u paraqitë për të depërtuar në Kosovë, përkundër borës së madhe dhe acarit të papërballueshëm në një lartësi mbidetare deri në 1700 metra, ishte edhe dëshmori i lirisë Veli Ballazhi gjithnjë duke e mbajtur mend fjalën e

[1] Feniksët e lirisë -11, fq.56/57

komandantit Mujë Krasniqi se kufirin do ta kalojmë madje duke u ndeshur edhe me luftë ndaj forcave pushtuese serbe që shqiptarët i kishin ndarë me kufinjë.

Në mëngjesin me acar të dimrit, më 14 dhjetor 1998, luftëtarët e lirisë pasonin kolonën, të cilës i printe komandanti Mujë Krasniqi, Beqir Gashi, Rifat Mëziu, Gani Elshani, Luljeta Shala, Afrim Musliu dhe me të arritur në vendin e quajtur te ,,Likenet e Hasit'', forcat serbe të pozicionuara në pritë, befasisht sulmojnë kolonën, fillimisht me minahedhës mu në mesin e kolonës për të krijuar huti e më pastajt nga të gjitha anët. Sulmi kishte qenë i planifikuar hollësisht nga forcat armike, të cilat kishin filluar breshërinë e goditjeve pasi që shumica e luftëtarëve ishin futur në rrezen ku vepronte arma armike. Kishin filluar përleshjet fyt për fyt, ndërsa luftimet kishin zgjatur me orë të tëra. Në fushën e nderit dhe në altarin e atdheut bie komandanti Mujë Krasniqi[2] .

Bashkëluftëtari tjetër i dëshmorit, Avni Shiti, rreth luftës në Pashtrik dhe rënies së dëshmorit Veli Ballazhi thotë se pos meje në grupin e Hanit të Elezit që përjetuam këtë betejë të përgjakshme ishin edhe Samet Ballazhi, Mehmedali Ballazhi, Vehbi Mici, Azem Suma dhe tanimë dëshmori Veli Ballazhi duke shtuar se me 13 dhjetor kah ora nëntë e mëngjesit jemi nisur në drejtim të Pashtrikut dhe kemi udhëtuar tërë ditën dhe tërë natën. Rreth orës pesë të mëngjesit të 14 dhjetorit kemi rënë në pritën serbe dhe pas luftimeve të shumta, rreth orës dhjetë jemi plagosur unë, Azem Suma dhe Samet Ballazhi dhe këta të fundit zihen të gjallë. Rreth mesditës së 14 dhjetorit jemi takuar me Veli Ballazhin e Vehbi Micin (Hani i Elezit) si dhe Afrim Musliun[3] e Selim Selimin nga fshati Belinc, komuna e Shtimes të cilët kërkonin shokët e tjerë që gjatë sulmit nuk dihej a ishin të gjallë apo të vrarë. Veliu ka qenë i armatosur me AK 47, një shkorpion, 2000 fishekë, 8 bomba dhe me një peshë të rëndë në shpinë, gjithnjë me një vullnet të pathyeshëm për luftë. Duke kërkuar shtigjet për t`u tërhequr në drejtim të Shqipërisë dhe për të qarë rrethimin nëpër atë murlan të pazakontë, kemi qëndruar bashkarisht deri rreth orës 23 të natës dhe gjatë tërë kohës ishim të sulmuar, madje edhe nga helikopterët ushtarak. Meqë unë isha i plagosur në këmbë dhe s`mundja të ecja, u ndala që dalëngadal të udhëtoj pas gjurmëve të shokëve, ndërsa me mua mbet Vehbi Mici dhe Selimi i fshatit Belinc të Shtimes i cili vdes në

[2] Feniksët e lirisë- 7,fq.173

[3] Afrim Islam Musliu(1971-1998) ishte nga fshati Belinc i komunës së Shtimes.Radhëve të UÇK-së iu bashkangjitet që nga maji i vitit 1998 dhe kufirin Shqipëri-Kosovë, duke sjellur armatim, e kishte kaluar 15 herë. Më gjerësisht ,,Feniksët e lirisë- 8"

duartë tona i ngrirë nga acari. Me Afrim Musliun u nisën për t`u tërhequr në drejtim të Shqipërisë, Veli Ballazhi dhe tre-katër shokë të tjerë që s`më kujtohen emrat. Pas 10-15 minutave kemi dëgjuar rafale të gjata jo shumë larg nga ne. Në këto rrethana Veli Ballazhi me shokë, pas një lufte ballë për ballë me pushtuesin, bie në pritën tjetër serbe për të mbetur i pavdekshëm në historinë e kombit shqiptarë. Ishte mesnata e datës 14-15 dhjetor 1998, kujton pjesëtari i UÇK-së Avni Shiti nga Hani i Elezit.

Në tmerrin e këtij dhjetori me acar e stuhi, ku ushtarët e UÇK-së kishin hasur në një rrethim të thellë dhe të papërballshëm, në përjetësi kaluan 41 dëshmorë e në mesin e tyre edhe Veli Ballazhi nga Hani i Elezit. Rënia e Veliut në Pashtrik shënonte edhe rënien e dëshmorit të parë nga kjo trevë nën emblemën e lavdishme të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Shumë luftëtarë të 14 dhjetorit, të mbetur gjallë nga kjo plojë armike, rrëfejnë se krahas përdorimit të armëve të lloj-llojshme që përdori armiku, nuk munguan as edhe helmet kimike, gjë që shumë luftëtarë nga gjendja normale e vetëdijes, kalojnë në një gjendje halucinacionesh dhe një humbje kontrolli në kohë dhe hapsirë.

Gjatë këtyre luftimeve, evokon Samet Ballazhi, nga forcat serbe plagosem në kokë dhe serbët arritën të më kapin të gjallë dhe pos meje, zihet rob edhe Azem Suma po ashtu i plagosur si dhe shtatë luftëtarë të tjerë. Fillimisht na dërgojnë në burgun e Prizrenit ku torturohemi rëndë dhe pastaj me helikopter, transferohemi në burgun ushtarak të Nishit, ku më pas lirohemi gjatë shkëmbimit të njohur me ushtarët serb.

Beqir Ballazhi (tani i ndjerë), duke përkujtuar rënien e birit të tij, thoshte se Veliu në luftë shkoi me lejen tonë, por nuk dinim rënien e tij në Pashtrik.Më 16 dhjetor 1998, policia serbe rrethoi shtëpitë tona dhe na morën për në të ashtuquajturat biseda informative mua dhe vëllaun tim Haqifin si dhe Muhabi Shytin e Shaban Micin, djemtë e të cilëve poashtu kishin luftuar në Pashtrik dhe na dërguan në stacionin policor serb të Ferizajt dhe na thanë se „është vrarë" Samet Ballazhi. Por, kur të nesërmen shkuam që t`i marrim kufomat në morgun e Prizrenit, kuptuam se ishte vrarë Veliu, por kufomën nuk e kishte në morg, ndërsa djali i vëllaut tim Sameti ishte zënë rob lufte.

Remzi Ballazhi, axha i Veliut, thotë se në morgun e Prizrenit, kam vërejtur gjymtyrë trupi dhe koka të këputura duke shtuar se kam kontrolluar të gjithë trupat e pajetë të luftëtarëve për të gjetur kufomën e Veliut, por kur vërejta se trupi i tij nuk gjendej në morg, familja jonë mori përsipër katër trupa pa jetë ushtarësh sa për t`i tërhequr që mos t`iu

humbin kufomat dhe i varrosëm në Polac krahas ushtarëve të tjerë me nderime të larta ushtarake, kujton ai.

Ndërsa Xhemil Ballazhi, rreth atyre ditëve dramatike thotë se pas verifikimit të fotografive në Shtabin e UÇK-së në Krushë, ku ishte prezent edhe Ragip Hoti, i vëllau i Ukshin Hotit, i cili na ndihmoi në verifikimin e fotove të ushtarëve të vrarë në Pashtrik, por nuk mundëm ta gjejmë edhe këtu fotografinë e Veliut, por nga Shtabi u këshilluam që nga morgu të tërheqim 4 kufoma të ushtarëve të vrarë, sepse familjet e të vrarëve nuk kishin njohuri për bijtë e tyre. Tërheqja e kufomave është bërë nën inçizimin e kamerave serbe dhe OSBE-së. Kufomat e tërhequra i vendosëm në kamiona dhe gjatë tërë natës kemi udhëtuar në pritje dhe përcjelljen e ushtarëve të UÇK-së nëpër vijat e luftës, ku në Llashkadrenoc u sistemuam për pushim në familjet shqiptare dhe në mëngjesin e së nesërmes shkuam në Polac ku edhe u bë varrimi i tyre me nderime ushtarake.

Dhjetori i atij viti për familjen e gjërë Ballazhi, ishte ndër muajt më dramatik. Veliu mbeti i vrarë në Pashtrik, por trupi i tij i pajetë mbet i pagjetur. Shkëmbimi i njohur i ushtarëve të UÇK –së me ato serb, bëri që familjes Ballazhi t`i kthehet Sameti, ndërsa ky ndërrim për UÇK-në kishte një rëndësi të veçantë sepse pushtuesi u detyrua që në rastin konkret t`i nënshtrohej kërkesave të SHP të UÇK-së.

Gjeneral Rrustem Mustafa – Remi, duke kujtuar këtë ngjarje të madhe, gjatë vizitës që i bëri pas lufte, familjes së dëshmorit tha se ,, kjo ngjarje kishte një rëndësi të madhe për UÇK-në, për strategjinë e saj dhe për forcën e saj e në anën tjetër ishte e mirë edhe për familjet e ushtarëve të zënë rob".

Masovizimi i UÇK-së me ushtarë të rinj dhe fillimi i sulmeve të NATO-s ndaj Serbisë pushtuese, ushtarët e Zonës Operative të Pashtrikut, zgjerojnë hapsirën kontrolluese dhe me 5 maj 1999, gjejnë trupin e pajetë të Veli Ballazhit të cilin nga 14 dhjetori 1998, e kishte ruajtur bora e Pashtrikut dhe me nderime ushtarake varroset në vendin e rënies.

Hasjani, Curr Osmanollaj, pjesëtar i Brigadës 126[4] të Pashtrikut, duke kujtuar gjetjen e kufomës së dëshmorit Veli Ballazhi në Pashtrik, thotë se,, trupin e pajetë të dëshmorit Veli Ballazhin e kemi gjetur te vendi i quajtur ,,Lugu i Zi''. Identitetin e tij e zbuluam nga pasaporta të cilën e kishte

[4] Brigadat që e përbënin ZOP ishin:Brigada 121,122,123,124,125,126,127,128. ZOP kishte 5 mijë deri në 7 mijë luftëtarë. Për çlirimin e atdheut dha 400 dëshmorë.Komandant i Brigadës 126, e cila vepronte në rajonin e Hasit, ishte Safet Gashi. Më gjerësisht shih Mr.Sadik V.Krasniqi ,,Lufta për çlirimin e Kosovës (1997-1999)

pasur në xhepin e uniformës dhe pasi i hoqëm gjoksoren me bomba e fishekë e varrosëm bashkë me uniformën në Pashtrik me nderime të larta ushtarake".

Rënia e dëshmorit Veli Ballazhi me 14 dhjetor `98, rrëfen ish komandanti i Brigadës 164 të UÇK-së, Rufki Suma, ishte një sinjal edhe më i qartë se pushtuesi serb do të ndërmirrte ofenzivë për shpërbërjen e pikës sonë luftarake, por edhe njësitë tona të logjistikës u mobilizuan edhe më tepër për t`i bërë rezistencën e duhur pushtuesit,e cila rezistencë do të dëshmohet që nga shkurti i vitit 1999, e deri në qershorin e atij viti, ndërsa zv.komandanti i Brigadës, Mehmet Ballazhi[5] shton se vrasja e Veliut në Pashtrik, jo që i zmbrapsi luftëtarët, por mobilizimi dhe radhët vullnetare u shtuan për çdo ditë e më tepër, por edhe dëshmorët binin njëri pas tjetrit dhe me 11 qershor 1999, treva e Hanit të Elezit çlirohet përfundimisht.

Pas përfundimit të luftës, dëshmori Veli Ballazhi zhvarroset nga Pashtriku dhe me 29 gusht të vitit 1999, rivarroset krahas dëshmorëve të tjerë në varrezat e dëshmorëve në Puset e Nikës si dëshmor i Brigadës 164 „Gafurr Loku" të UÇK-së dhe emri i dëshmorit është përtëri në familjen Ballazhi si dhe në shkollën fillore të fshatit Guranë.

Rapsodi në shenjë nderimi për dëshmorin e rënë për liri, këndon:

Shumë të fala nga Beqir Gashi
Bashkë me Beqën,Veli Ballazhi
Për liri kur pushka krisi
I pari ish dhe Mujë Krasniqi.

Flet Pashtriku me Sharrin plak
Ra Veliu t`marrim hak
U dha lajmi deri në Llap
Pushkë e topa u zbrazën flakë…

Dëshmori Veli Ballazhi në luftën për liri ra në moshën 20 vjeçare dhe ishte i pamartuar. Ai me gjakun e tij, theu mitin e kufirit të pathyeshëm dhe për aktivitetin e tij atdhetar, Qeveria e Përkohshme e Kosovës, SHP i UÇK-së, Zona e VI-të e TMK-së, Kuvendi komunal si dhe nga Batalioni 36 i TMK-së, dëshmorin e kanë nderuar me Mirënjohje. Për dëshmorin janë shkruar tekste këngësh dhe artikuj në gazetat ditore të

[5] Mehmet Ballazhi kah mesi i nëntorit, me detyrë të Shtabit të UÇK-së,nga Puset e Nikës kalon në qendrën stërvitore në Shqipëri, ku i trajnon ushtarët e rinjë nga treva e Hanit të Elezit që aso kohe ishin rreth 50 ushtarë dhe kjo njësi merr pjesë në beteja të rëndësishme si në Pashtrik e gjithashtu në Koshare.Mehmet Ballazhi rikthehet në Puset e Nikës më 16 mars 1999.

Kosovës. Në shenjë nderimi, bashkëluftëtarët dhe bashkëvendësit e dëshmorit që aktualisht punojnë në mërgim, në vitin 2009, me vetëkontributin e tyre, ngritën bustin e dëshmorit në oborrin e shkollës fillore të fshatit Guranë e cila në vitin 2005 është emëruar me emrin e tij.

Nga e majta: dëshmori Veli Ballazhi, Naser Kuka, Mehmedali Ballazhi e Samet Ballazhi në qendrën stërvitore të Vlanës

Varrosja e dëshmorëve më 5 maj 1999 në Pashtrik

Fotografi nga varrimi i dëshmorëve të 14 dhjetorit, trupat e të cilëve u gjetën në muajin maj të vitit 1999.
Pashtrik: 5 maj, 1999

Varri i dëshmorit Veli Ballazhi në Pashtrik. Për rreth anëtarët e familjes së dëshmorit në ditën e zhvarrimit, gusht 1999

Nga e djathta: I pari Samet Ballazhi, ndërsa i treti nga radha, dëshmori Veli Ballazhi

Mërgimtarët nga komuna e Hanit të Elezit, të cilët me kontributin e tyre material ngritën bustin e dëshmorit Veli Ballazhi në shkollën fillore të fshatit Guranë

Pranë bustit (të ri) të dëshmorit i cili u ngrit nga komuna e Hanit të Elezit. Në nderim (në rrethana pandemie): Familja, institucioni komunal dhe arsimtarët e shkollës e cila bart emrin e dëshmorit

Autori i monografisë në mesin e familjes së dëshmorit Veli Ballazhi.Në fokus babai i dëshmorit Beqir Ballazhi, tanimë i ndjerë



Gafurr Loku (1949-1999)

28 Nëntori i vitit 1912 shënon ditën kur në Vlorën heroike, Ismail Qemali, sot e njëqind vite më parë, shpalli Pavarësinë e Shqipërisë për shqiptarët kudo që shtriheshin në trojet etnike. Përkundër kësaj shpallje dhe këtij akti të madh kombëtarë, meqë shqiptarët ishin të pakrahë dhe të pambështetur nga të tjerët, Konferenca e Ambasadorëve në Londër e vitit 1913 vendosi në dëm të shpalljes së kësaj Pavarësie dhe në vend që të njihej e drejta historike e popullit shqiptarë për vetëvendosje, më shumë se

gjysma e trojeve etnike mbeti jasht kufijve të Shqipërisë së sotme bregdetare.

Trojet shqiptare të mbetura jasht kufijve, për 100 vjet me radhë u përballën me një shtypje të egër sllave me të gjitha përmasat e një etnocidi. Krahas kësaj, populli shqiptarë që mbet me të padrejtë jashtë trungut të tij, përveç kësaj shtypjeje u përball edhe me politikën regjionalizuese duke i ndarë shqiptarët në banovina e krahina të ndryshme me të vetmin qëllim që t`i sundojnë e asimilojnë më lehtë. Përballë këtyre projekteve kobzeza për shqiptarë, gjiri i popullit lindi atdhetarë që sfiduan planet pansllaviste të zhbërjes së shqiptarëve e në mesin e këtyre atdhetarëve fisnik ishin edhe Rafi Halili[6] e Gafurr Loku, i pari i lindur në Gajre të Tetovës, ndërsa i dyti në Kotlinë të Kaçanikut legjendar.

Gjimnazi i qytetit të Tetovës ishte vendtakimi i parë ku Rafi Halili takohet me të pathyeshmin e Grykës së Kaçanikut, Gafurr Lokun me të cilin edhe fillon veprimtarinë atdhetare kundër lubisë jugosllave, e cila në synim të parë dhe të fundit kishte zhdukjen e popullit shqiptarë nga faqja e dheut.

Pas analizës të gjithanëshme që i bënë situatës së përgjithshme në viset e pushtuar dhe pasi përfunduan me vendimin se kudo ku jetojnë shqiptarët duhet të jetë edhe shteti shqiptar, Rafi Halili bashkë Gafurr Lokun tanimë dëshmor më 4 maj 1968, ngritën flamurin kombëtar shqiptarë në Fabrikën e Tekstilit në Tetovë duke shënuar kështu veprimin e parë konkret për çlirimin e atdheut, veprim i cili tmerroi strukturat pushtetmbajtëse

[6] Rafi Halili është i lindur në vitin 1950 në fshatin Gajre të Tetovës.Në vitin 1962 shpërngulet në Tetovë. Bashkë me Gafurr Lokun është themelues i organizatës Politike Kombëtare „Kushtrimi i lirisë" . Aktiviteti i këtij atdhetari daton nga 4 maji i vitit 1968. Për ngritje të flamurit dënohet me një muaj burg.Për pjesëmarrje në demonstratat e 68-tës në Tetovë, përjashtohet nga gjimnazi dhe nje vit me radhë mësimet i ndjek në Dardanë të Kosovës. Pas shkollës së mesme regjistrohet në Fakultetin Juridik në Prishtinë.Nga UDB-a arrestohet me 21 shtator 1972 në Prishtinë. Dënohet në gjykatën e Shkupit me 7 vjet burg. Prej torturave të rënda,për disa muaj me radhë s`ka mundur të lëvizë. Pas lirimit nga burgu menjeherë rifillon veprimtarinë dhe sërish arrestohet në vitin 1982 në Tetovë.Gjatë arrestimit të tij, zhvillohet një luftë e vërtetë. Rafiu plagoset rëndë në gojë dhe fyt dhe një kohë s`ka mundur të flasë. Pos Rafiut, UDB-a arrestoi edhe vëllaun e tij Vegjiun, të cilin pas torturave 15 ditëshe e lirojnë, ndërsa nënën Shukrie e dënojnë me 7 vjet burg dhe motrën Hireme gjithashtu me 7 vjet burg kurse Rafiu dënohet me denim kapital prej 20 viteve. Nga burgu lirohet në vitin 1992 pas demonstratave të shumta në Tetovë për lirimin e tij. Ka mbajtur mbi 16 vite burg, kryesisht në Shutkë dhe Idrizovë. Rafi Halili ka vdekur më 28 janar të vitit 2022 dhe është varrosur në varrezat e qytetit në Tetovë.

jugosllave, sepse krahas flamurit të vendosur në hyrje të fabrikës, ata shkruan edhe parullën:
„ Është ngjallur Gjergj Kastrioti - Skënderbeu i cili do të bashkojë Shqipërinë ’’ dhe kjo për pushtuesin ishte e tmerrshme, e patolerueshme.

Pas këtij akti madhor, UDB-ja aktivizohet me gjithë potencialin e saj antishqiptar dhe arrinë t`i zbulojnë autorët e kësaj vepre të madhe. Rafi Halili dënohet si i mitur me një muaj burg, ndërsa Gafurr Loku me dënim administrativ dhe njëkohësisht UDB-a hapi dosjen e përndjekjes ndaj këtyre atdhetarëve të cilët do t`i ndjek këmba-këmbës gjatë tërë jetës së tyre.

Krahas ngritjes së flamurit, Rafi Halili e Gafurr Loku për të ngritur vetëdijen kombëtare, në masat shkollore filluan organizimin për bojkotimin e orëve mësimore dhe kërkojnë që mësimet të zhvillohen në gjuhën shqipe e jo në ate maqedonase, ndërsa profesorët pa asnjë kusht të jenë shqiptar.[7] Kërkohej edhe mbishkrimi i emërtimit të shkollës dhe administrata të jetë në gjuhën shqipe, të ketë drejtues të tjerë shqiptarë si sekretarë, pedagogë, etj.[8]

Por, kur më 23 dhjetor 1968, shpërthejnë demonstratat për flamur në Tetovë, të cilave u printe atdhetari Mehmet Gega. Rafi Halili dhe Gafurr Loku edhe pse të mitur ishin ndër protagonistët më të zëshëm në këtë demonstratë dhe për pjesëmarrje në këto demonstrata, Rafi Halili përjashtohet nga gjimnazi dhe për një vit shkollor qëndron në Dardanë (ish Kamenicë) të Kosovës, ndërsa demonstratat u shtypën me dhunë dhe dënimet ndaj pjesëmarrësve në këto demonstrata ishin të mëdha[9].

Pas këtyre aktiviteteve dhe pas përballjeve, që ideologët e çlirimit kishin me UDB-në, ata e vranë frikën në trupin e tyre dhe me përkushtim të jashtëzakonshëm vazhduan udhën e lirisë nëpër betejat e tjera kombëtare.

Për të ngritur nivelin e veprimit, në vitin 1969 Rafi Halili e Gafurr Loku formuan Grupin ilegal „Bashkimi’’, ndërsa me rritjen e celulave dhe me shtimin e numrit të anëtarëve bënë riorganizimin e grupit dhe formojnë Organizatën Politike Kombëtare „ Kushtrimi i lirisë’’, kryetar i së cilës ishte Rafi Halili, ndërsa Kryetar i Këshillit Kombëtar të Organizatës zgjedhet Gafurr Loku.

---

[7] Rami Kamberi „Ikona e kushtrimit të lirisë’’ fq.55, Tetovë, 2010
[8] Po aty fq.56
[9] Sipas Atnan Alitit, për pjesëmarrje në demonstratë u dënuan 170 persona, ndërsa 54 vetë me denim mbi 1 vit.

Platforma politike e Organizatës ilegale politike ,,Kushtrimi i lirisë'' ishte formimi i shtetit kombëtar shqiptar, përkatësisht të Shqipërisë etnike.

Veprimtaria atdhetare e dëshmorit Gafurr Loku ka një shtrirje të gjërë, sepse Gafurr Loku veproi në të gjitha trevat shqiptare, veproi kudo që ishte nevoja. Aq sa veproi në viset shqiptare në Maqedoni, po aq luftoi në Kosovën e robëruar, andaj veprimtaria e tij atdhetare mund të plotësohet vetëm me një monografi të vetme dhe me një trajtim të thellë shkencor.

Duke pasur parasysh natyrën e monografisë së dëshmorëve të Komunës së Hanit të Elezit, veprimtarinë atdhetare të dëshmorit Gafurr Loku po e kalojmë nëpër datat më të rëndësishme të jetës së tij.




Rafi Halili Gafurr Loku

Ideologët e Organizatës Politike Kombëtare ,,Kushtrimi i lirisë''

- Gafurr Loku u lind më 11 gusht 1949 në fshatin Kotlinë të Kaçanikut nga i ati Xhaferi dhe nëna Rabishja, të cilët në jetën e tyre martesore kishin tetë fëmijë, shtatë djem e një vajzë. Gafurr Loku ishte fëmiu i katërt i familjes Loku.
- Një pjesë të shkollimit fillor e kreu në fshatin e lindjes, ndërsa pjesën tjetër në Han të Elezit
- Për një kohë, familja e tij shpërngulen nga fshati i lindjes Kotlinë dhe vendosen në Lagjen e Demzenëve në Paldenicë.
- Viteve të 60- ta shpërngulet në Tetovë, ku edhe regjistrohet në gjimnazin e Tetovës.

- Me 4 maj 1968, si nxënës i vitit të II të, bashkë me shokun e tij Rafi Halilin e ngritën flamurin kombëtar shqiptar në fabrikën e Tekstilit në Tetovë.
- Për këtë vepër zbulohet nga organet e ndjekjes dhe meqë ishte i mitur dënohet me dënim administrativ.
- Merr pjesë fuqishëm në demonstratën e 23 dhjetorit 1968 në Tetovë dhe ishte njëri nga organizatorët e saj
- Pjesëmarrja e tij në demonstrata evidentohet edhe në dokumentet sekrete të UDB-së, përkatësisht në dosjen e tij politike në një vëllim prej 250 faqeve të formatit A4

Dëshmori Gafurr Loku gjatë vitit shkollor 1967/68, si nxënës i vitit të III në Tetovë, ku edhe fillon aktivitetin atdhetar.

- Si nxënës i vitit të III të gjimnazit është njëri nga shkruesit e parollës „Në zemrën time dhe tënden qëndron Shqipëria''
- Në vitin 1970 regjistrohet në Fakultetin Ekonomik të Prishtinës
- Gjatë vitit 1969,1970,1971 formon celula atdhetare për çlirimin e trojeve shqiptare si në Gjepçisht, Poroj, Zhelinë, Shipkovicë, Gajre, etj.
- Gjatë këtyre viteve Gafurr Loku dhe bashkëveprimtarët e tij, arrijnë të ngritin flamujtë kombëtarë shqiptarë në të gjitha qytetet shqiptare në Maqedoni.

- Më 28 nëntor 1970 miratohet Statuti i Organizatës Politike Kombëtare „Kushtrimi i lirisë'' dhe Gafurr Loku në kuadër të kësaj Organizatës ilegale zgjedhet Kryetar i Këshillit kombëtarë të organizatës.
- Teksti i betimit pranë kësaj organizate ishte:

Unë, Shqiptar Shqipëria, biri i tokës Shqipëri që më pagëzoj shqiptar: Betohem para flamurit dhe kombit tim se: do të veproj për lirinë dhe bashkimin e atdheut në një shtet, duke ia falur edhe jetën. Në mos kryerjen e detyrës apo të dështimit tim, në emër të popullit, pajtohem të dënohem me vdekje.

Rroftë populli shqiptarë - Rroftë Shqipëria[10]!

- Krahas statutit, Organizata përpiloi edhe programin, preambulën dhe Kodin moral të organizatës
- Krahas Programit politik të OPK „Kushtrimi i lirisë'' Organizata ku vepronte Gafurr Loku shpërndante edhe hartën e atdheut në të cilën shkruhej:

Vëllezër shqiptarë, dikur atdheu ynë ishte deri në brigjet e lumit Po dhe, e shoqëronin malet Alpe, kurse në jug e shoqëronte deti Mesdhe, kah perëndimi e shoqëronin detet : Adriatiku dhe Joni e në lindje shkëlqente deri në Budinë. Atdheu me këtë pamje i mbeti historisë, andaj të jemi syçelë që kjo Shqipëri e mbetur të na mbetet trashëgim për fëmijët tanë, se pastaj brezat që vinë pas do të na akuzojnë për tradhti [11].

- Gafurr Loku merr pjesë në marrjen e pushkëve nga kabineti paraushtarak i gjimnazit, armë të cilat u dedikoheshin Organizatës për rezistencë të armatosur
- Me 1 maj 1972 Gafurr Loku me shokë, vendosin flamurin kombëtarë shqiptarë në sheshin e qytetit të Tetovës
- Me 4 korrik 1972 vendosë flamujtë kombëtarë në Tetovë, Kërçovë e Gostivar
- Me 26 korrik 1972 është shpërndarës i pamfleteve në afërsi të Univeristetit të Tetovës dhe Bibliotekës së qytetit
- Me 21 shtator 1972 nga UDB-a sllave arrestohet në Prishtinë

[10] Rami Kamberi: Ikona e OPK „Kushtrimi i lirisë'' fq.144,Tetovë, 2010
[11] Rami Kamberi: Ikona e OPK „Kushtrimi i lirisë'' fq.164,Tetovë, 2010

- Hetimet ndaj Gafurr Lokut zhvillohen në burgun famëkeq të Shutkës së Shkupit[12]
- Me 21 janar 1973 del para gjyqit të Shkupit dhe dënohet me 5 vite burg të rëndë[13]
- Pas përfundimit të hetimeve transferohet në burgun famëkeq të Idrizovës
- Në këtë burg takohet me dëshmorin Rexhep Mala
- Në burgun e Idrizovës qëndron me: Rafi Halilin, Rushit Nesimin, Elmaz Ademin, Ajet Ajetin dhe me të burgosurit politik nga Kosova: Ajet Runikun, Xhafer Shatrin, Hasan Dërmakun, Nejazi Korçën, Shpëtim Pollozhanin,etj.
- Është njëri nga pjesëmarrësit e grevës për lirimin e Rexhep Malës nga qelitë e Idrizovës
- Gjatë vuajtjes së burgut nga puna e rëndë që bënte i dëmtohen mushkritë nga thartinat
- Në vitin 1976 familja e tij shpërngulen nga Tetova dhe vendosen në fshatin Seqishtë të Hanit të Elezit[14]
- Nga burgu i parë lirohet me 21 shtator 1977 duke mos gëzuar asnjë ditë amnestie
- Pas daljes nga burgu gjatë majit të vitit 1978, qëndron i shtrirë në spitalin e Prishtinës si pasojë e dëmtimit të mushkrive në burg
- Në vitin 1978 martohet më Hasibe Rakën nga Kaçaniku, martesa e tij bëhet në Lagjen e Re të fshatit Seqishtë
- Në vitin 1979 i lind djali i tij Dritoni, të cilin serbët ia vrasin pas njëzet viteve
- Përsëri vazhdon studimet pranë Fakultetit Ekonomik në Prishtinë, të cilin ia kishin ndërprerë dhunëshëm në vitin 1972
- Në vitin 1979 përsëri shpërngulet në Tetovë
- Në prill të vitit 1980 dërgohet në kryerjen e shërbimit ushtarak në Sarajevë ku qëndron vetëm 3 muaj

---

[12] Gafurr Loku thoshte se torturat në burgun e Shutkës ishin të tmerrshme.Udbashët ndërroheshin dy nga dy, ndërsa mua më mbajtën tetë ditë pa gjumë për t`më humbur koncentrimin.Koka ziente, trupi s`duronte më dhembjet, ndërsa krihët më dukeshin se janë bërë si hunj.

[13] Aktakuza i ngarkonte se me veprimtarinë e tyre ilegale kanë „indoktrinuar" me ideologji nacionaliste mbi 1500 anëtarë

[14] Për t`i ikur syrit vëzhgues dhe përndjekës të UDB-së, babai i Gafurrit, Xhaferi, zbatoi një strategji të migrimit nga një vend në vendin tjetër.

- Pas shpërthimit të demonstratave të vitit 1981 ishte njëri prej propoganduesve më të fuqishëm të kërkesës politike: Kosova-Republikë
- Është në njohuri të aksionit të shpërndarjes së pamfleteve në Tetovë e rrethinë të datave: 27 qershor 1981, 8 korrik 1981, 16 shtator 1981, 17 shtator 1981, 21 dhjetor 1981 të cilat i shpërndante organizata ilegale „Kushtrimi i Lirisë'' në krye me atdhetarin Rafi Halilin
- Me 9 mars 1982 i bastiset shtëpia e tij në Tetovë[15]
- Më 13 mars 1982, UDB-ja e arreston në Kaçanik[16]
- Hetimet ndaj Gafurrit zhvillohen përsëri në burgun e Shutkës
- Në hetimet ndaj tij merr pjesë ekipi specializues i UDB-së
- Gjatë hetimeve të pandërprera e sidomos ato të datave 28, 29 dhe 30 prillit 1982, Gafurr Loku do të pësoj një gjendje të rëndë shëndetësore dhe psiqike, ai do t`i sulmon me lapsin kimik edhe fizikisht udbashët duke dashur t`i verboj ata, tenton të thyj derën dhe të kërcej nga dritarja që t`i përfundoj torturat e mëtejme mizore. Në raportin e udbashëve rreth kësaj situate thuhet se kjo gjendje ka mundur të vijë si rezultat i lodhjes së tepërt, pagjumësisë së vazhdueshme, barërave që ia dhamë si dhe përballja me një gjendje të pashtegdalëshme.
- Përkundër krejt këtij tmerri udbesk sllav, Gafurr Loku me 16 gusht 1982 del para Gjykatës së Qarkut në Shkup dhe dënohet me 3 vite e 6 muaj burg në bazë të nenit 133, të cilin dënim e vuan përsëri në burgun e Idrizovës pa gëzuar asnjë ditë amnestie[17]

---

[15] Shtëpia në Tetovë i bastiset në orët e hershme të mëngjesit dhe siç deklaron bashkëshortja e Gafurrit, arrita që para se të futet policia në dhomë të zhdukë disa material ilegale. Policia mori disa shirita magnetofonik ku Gafurri kishte të inçizuara lajme e komente nga Radiotelevizioni shqiptar për ngjarjet në Kosovë.Meqë Gafurri ishte në Kaçanik, UDB-a arrestoi babain Xhaferin, vëllezërit Shefketin, Muhametin dhe Kadriun. Pas malltretimeve, të tjerët i lirojnë, ndërsa Kadriu në burgun hetues qëndron 3 muaj ditë.

[16] Gafurr Loku arrestohet nga udbashët e Kaçanikut Halit Loku e Afet Rexhallari dhe ia dorëzojnë kryeinspektorit të sektorit të III të UDB-së, Maslarov Trajko, udbashit nga Maqedonia dhe njëkohësisht Gafurr Lokut ia bastisin banesën në Kaçanik, pronë e Hamdi Rakës.

[17] Për lirimin e Gafurr Lokut nga burgu, në vitin 1983, intervenon edhe Amnesti internacional, seksioni i Japonisë dhe përkundër arsyetimit se Gafurr Loku është burgosur vetëm se ka shpreh mendimin e tij politik, kërkesa e tyre refuzohet.

- Pas dënimit të dytë të Gafurrit, përsëri familja e tij nga Tetova shpërngulen në Kosovë, konkretisht në fshatin Paldenicë të Hanit të Elezit.
- Nga burgu i dytë lirohet me datën 14 shtator 1985 dhe të njejtën ditë i vdes babai i tij Xhaferi, pasi kishte arritur të përqafojë djalin e tij të sapo liruar nga burgu[18].
- Përsëri vazhdon studimet në Prishtinë dhe arrinë t`i përfundoj tri vite të Fakultetit Ekonomik.
- Në fabrikën e Çimentos, këtu në Han të Elezit, kërkon punë fizike, por dyert për Gafurrin ishin të mbyllura.
- Në vitin 1988 doli në Zvicërr, por qëndron vetëm 1 muaj, përsëri kthehet në Kosovë[19].
- Gjatë këtij viti kishte përpjekje për ta arrestuar për herë të tretë.
- Viteve të 90-ta, kur u themelua Këshilli i Finacimit në Han të Elezit (1992), Gafurr Loku ishte sekretar i këtij këshilli.
- Që të mbijetoj shkolla shqipe, Gafurr Loku ishte edhe inkasant i këtij Këshilli[20]
- Mori pjesë në të gjitha demonstratat dhe protestat që u zhvilluan në Han të Elezit
- Merr pjesë në pajtimin e zënkave dhe gjaqeve në Han të Elezit dhe më gjërë
- Ishte aktiv në pritjen dhe përcjelljen e delegatëve të Mbledhjes Konsultative të LPRK-së e cila u mbajt fshehurazi me 23 dhe 24 prill 1993 në Kollare të Kërçovës e në të cilën mbledhje u morën vendime të rëndësishme çlirimtare.
- Me themelimin e Shoqatës Humanitare „Nëna Terezë'' (1994)[21] në Han të Elezit ishte kryetar i saj.

---

[18]Për ngritjen e flamurit më 4 maj 1968 në Tetovë i tregova babait, thoshte Gafurri. Ai pas më shikoi thellë e thellë tha: Gafurr, mbi shpinë paske marrë një barrë të rëndë. UDB-a ka me të ndjek tërë jetën, por mbasi i ke hyrë kësaj pune, qoje deri në fund

[19] Gafurr Loku ka qëndruar në qytetin Mirshvil, në banesën e Numan Beadinit nga Xhepqishti i Tetovës ku edhe takohet me shokët e tjerë si me Elmaz Ademin, Rushit Nesimin, etj.

[20] Nga viti 1990 pushtuesi serb me çdo kusht përpiqej të rrënoj shkollën shqipe. Mësimdhënësit mbetën pa paga, ndërsa nxënësit e shkollës së mesme dhe studentët u detyruan të mësojnë nëpër shtëpi private. Ta mbrosh dhe ta ndihmosh mbijetesën e shkollës shqipe atyre viteve, nuk ishte gjë e lehtë. Ishte një veprim atdhetar që meritonte respekt. Me të hollat që mblidhte Gafurri nëpër popullatë, mbijetonin mësimdhënësit e në rrjedhë të kësaj edhe shkolla shqipe.

- Ishte edhe anëtar i kryesisë edhe në Nënkëshillin për Mbrojtjen e Drejtave dhe Lirive të Njeriut (1997) në Han të Elezit
- Me formimin e Shtabit Lokal të UÇK-së me 19 qershor 1998 në Puset e Nikës, ishte në lidhje direkte me Shtabin dhe nga ai ngarkohet me detyra konkrete për masovizimin e UÇK-së me ushtarë të rinjë, në furnizimin e njësitit me armatim, mjete material dhe ndihma të tjera për nevojat ushtarake.
- Gafurr Loku bashkë me djalin e tij Dritonin vriten me 21 shkurt 1999 në Paldenicë të Hanit të Elezit. Vritet nga njësitë elite të „Dorës së Zezë'' serbe[22]
- Varrimi i tij bëhet me 24 shkurt 1999 në fshatin Paldenicë
- Gjatë luftës, Brigada 164 e UÇK-së mori emrin e tij.
- Zhvarrimi i tij bëhet me 21 shkurt 2001 dhe rivarroset në varrezat e dëshmorëve në Puset e Nikës.
- Kazerma e TMK-së në Han të Elezit kishte emrin e tij[23]
- Pas lufte, veprimtaria atdhetare e dëshmorit Gafurr Loku është nderuar me Mirënjohje nga Qeveria e Përkohshme e Kosovës, SHP i UÇK-së, Zona e VI e TMK-së, Kuvendi komunal dhe nga Batalioni 36 i TMK-së. Për dëshmorin janë thurur këngë, janë shtypur libra dhe është realizuar një Dokumentar. Me vendim presidencial është shpallur Hero i Kosovës.

---

[21] Shoqata Bëmirëse Humanitare „Nëna Terezë'' lujti një rol tejet të madhë në mbijetesën e qytetarëve të kësaj treve. Ndihmat që shpërndante Shoqata zbuste varfërinë e skajshme të familjeve shqiptare.Në krye të kësaj pune me vlerë ishte dëshmori Gafurr Loku.

[22] **a**. Më gjerësisht shih Kallëzimin penal kundër Serbisë ngritur nga KK i Hanit të Elezit dhe i dërguar në Prokurorinë e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë më dt.25.1.2012

b. Shih dëshminë me shkrim të Osman Cakës nga fshati Vataj të Kaçanikut, dhënë Kuvendit komunal të Hanit të Elezit më 23.4.2011 rreth vrasjes së Gafurr Lokut

c. Shih Padinë civile të Osman Cakës PP.NR.464/01 ngritur pranë Gjykatës së Qarkut në Prishtinë kundër krimelëve serb në Kaçanik të Vjetër

[23] Me përfundim e luftë dhe pas transformimit të UÇK-së, në Han të Elezit ngritet Batalioni 36 i xhenios, ndërsa kazerma ku vepronte TMK-ja kishte emrin e dëshmorit Gafurr Loku. Me transformimin e TMK-së në FSK dhe pas strukturimit të kësaj të fundit, shuhet edhe kazerma që barte emrin e dëshmorit Gafurr Loku.

Varrimi i Gafurr Lokut dhe djalit të tij Dritonit u bë në rrethana të rënda më 24 shkurt 1999 në fshatin Paldenicë. Fjalimin mortor e mbajti Zylbehar Hasallari, në atë kohë kryetar i Degës së LDK-së. Nga KMLDNJ qendra në Prishtinë, fjalim mbajti edhe shoku i burgut Binak Ulaj, ndërsa para varrimit, në shkollën fillore të fshatit u mbajt tubimi komemorativ për dëshmorët, të cilin e udhëhoqi Shaban Çupi



Fotografia që e ka numrin në gjoks të Gafurr Lokut, është fotografi e bërë nga UDB-a në burgun e Idrizovës

Thënie nga dëshmori Gafurr Loku:
Derisa të jemi të copëtuar, kurrë policët sllav s`kanë për t`u larguar nga shtëpitë tona. Derisa të jemi nën këmbën e maqedonit, malazezit dhe serbit, plagët tona kurrë s`do të shërohen, andaj vetëm bashkimi ynë kombëtarë e territorial do të zgjidh njëherë e përgjithmonë fatin tonë. Për këtë qëllim dhe për këtë ideal, jetën e dhanë dhe do ta japin kush e din edhe sa e sa atdhetarë. Pa bashkim s`ka fuqi, pa bashkim s`ka liri!

Në nderim të dëshmorit në 20 vjetorin e rënies. Shokë burgu, udhëheqës institucionesh, familja, farefisi, eprorë, ushtarë e invalid të UÇK-së. Në rend të parë kryengritësit, Rafi Halili e Hydajet Hyseni

Shoku i burgut Elmaz Ademi nga Tetova në një fjalim rasti për dëshmorin

Shoku i burgut dhe njëherit Kryetari i Shoqatës së të Burgosurve në Maqedoni, Shpëtim Pollozhani nga Struga në një fjalim rasti.

Fotografi e përbashkët e shokëve pjesëmarrës në Akademinë Mirënjohëse për dëshmorin Gafurr Loku më 21 shkurt 2022, Hani i Elezit

Nderim në vendin e rënies së dëshmorëve Gafurr e Driton Loku, 2022

Thënie nga dëshmori Gafurr Loku:

I robëruari nuk ka shumë dëshira. Thellë në zemrën e tij frymon vetëm një dëshirë që i robëruari dëshiron ta shohë, ta gëzojë e ta përjetojë dhe t`ua lë trashëgim pasardhësve. Ajo dëshirë është Liria. Kjo fjalë nuk ka shumë shkronja, por rrezet e saja ta ngrohin zemrën, ta njomin shpirtin.

Driton Loku (1979-1999)

Driton Loku u lind më 30.6.1979 në fshatin Paldenicë nga babai Gafurri dhe nënë Hasibja. Shkollën fillore e kreu në fshatin e lindjes, ndërsa të mesmën – drejtimin axhustator në Han të Elezit. Meqenëse babai i tij Gafurri, ishte burgosur në marsin e vitit 1982, Dritoni si fëmijë bashkë me nënën viziton babain nëpër burgjet sllave si në Shutkë e Idrizovë ku shpesh herë nuk u lejohej vizita. Nëpër këto burgje, Dritonit si fëmijë do t`i skaliten tablot e dhunës, tablot e pushtuesit dhe robëria e thellë e shqiptarit. Hekurat gri të burgut, rrapëllima e dyerve dhe britmat e ndonjë të burgosuri shqiptar që torturohej në çelitë e Idrizovës, e kjo bëhej më qëllim që të thenin shpirtërisht familjet e të burgosurve, ndikuan në shpirtin e Dritonit të ri. Kur u rrit më i madh, kuptoi se trojet shqiptare ishin të okupuara rëndë dhe këte për të saten herë ia kishte rrëfyer edhe babai i tij Gafurri, andaj Driton Loku në rrjedhë të kohës dhe ngjarjeve që po zhvilloheshin, ishte edhe pjesëmarrës në të gjitha protestat që mbaheshin aso kohe kundër pushtuesit serb në Han të Elezit. Në kuadër të këtyre protestave që organizoheshin kundër dhunës serbe e sidomos protestat e marsit dhe prillit të vitit 1998 ku me të madhe borhoritej për UÇK-në, Driton Loku arrestohet nga policia serbe dhe si ,,shpërblim'' që ishte edhe i biri Gafurr Lokut, torturohet tepër rëndë në stacionin policor të Hanit të Elezit, ku për pasojë disa ditë me radhë qëndroi i shtrirë në shtrat, duke u futur edhe në lëkurë dashi[24].

[24] Më gjerësisht ,, KK Hani i Elezit - Padi penale kundër Serbisë'' dhe fotoja e torturës

Viti 1998 në vetveten e tij ngërthen ngjarje të rëndësishme kombëtare, vrasja e komandantit legjendar Adem Jashari dhe shpërthimi i luftës në shumë pjesë të Kosovës, te rinia djaloshare e trevës së Hanit të Elezit solli mesazhin e lirisë, andaj në fillim të janarit të vitit 1999, Driton Loku së bashku me Minir Çupin, Safet Doshlakun, Gazmend Dernjanin e Nusret Laçin të gjithë nga fshati Paldenicë dhe Ali Belën nga fshati Gjurgjedell nëpërmjet Ferizajt kalojnë në Lypjan, ku edhe qëndrojnë një natë në shtëpinë e mikut të Nusret Laçit, ndërsa të nesërmen pas disa orë udhëtimi nëpër male, arrijnë në fshatin Sedllar dhe i bashkangjiten radhëve të UÇK-së në Brigadën 121 ,,Ymer Alushani'' ku siç deklaron Minir Çupi, komandant kishim ,,Blinin'', duke shtuar se atje gjetëm rreth 20 ushtarë e brenda pak ditëve numri i tyre arrin rreth 80 veta dhe se çdo ditë merreshim me ushtrime ushatarake. Më pas vazhdon rrëfimin e tij Miniri, dalim në fshatin Divjakë dhe atje u takuam me Rashit Bardhin, Samet Ballazhin e Azem Sumën nga Hani i Elezit. Pas disa ditëve qëndrimi pranë kësaj Brigade, kthehemi nga andej me qëllim që t`i bashkangjitemi radhëve të UÇK-së në Puset e Nikës, dëshmon ai.

Me kërkesën e Gafurr Lokut drejtuar Shtabit të UÇK-së në Puset e Nikës, kërkohet kthimi i Dritonit nga njësitë e UÇK-së në Sedllar dhe bashkangjitja e tij njësitit të UÇK-së në Puset e Nikës sepse ishte vend më i afërt dhe më i njohur për Dritonin.

Në rrjedhë të këtyre ngjarjeve dhe planit serb për të sulmuar forcat e UÇK-së në Puse të Nikës me 21 shkurt 1999, rreth orës 20, njësitë elite të ,,Dorës së Zezë'' serbe, organizojnë atentat ndaj atdhetarit Gafurr Lokut e në këtë rast bashkë me Gafurrin vritet edhe djali i tij Dritoni ku siç shkruan Fitnete Ramosaj në librin e krimeve serbe në Kosovë ,, Pa apologji 2 '' kjo vrasje e dyfishtë është bërë edhe për të përhapur tmerr e panik te popullsia shqiptare.

Varrimi i Dritonit dhe babait të tij bëhet në rrethana të rënda në fshatin Paldenicë më 24 shkurt 1999, në pjesëmarrjen e gjithë popullatës së kësaj ane, ndërsa rivarrimi i tyre bëhet me nderime ushtarake në vitin 2001 në varrezat e dëshmorëve në Puset e Nikës.

Driton Loku vritet në moshën 20 vjeçare dhe ishte i pamartuar.
Pas lufte, Qeveria e Përkohshme e Kosovës, SH i Përgjithshëm i UÇK-së, Zona e VI e TMK-së,Kuvendi komunal si dhe Batalioni 36 i TMK-së, dëshmorin e kanë nderuar me mirënjohje. Një rrugë në komunën e Hanit të Elezit bartë emrin e tij. Me vendim presidencial është shpallur Hero i Kosovës.

Për dëshmorët Gafurr e Driton Loku, u ngrit edhe pllaka përkujtimore në 20 vjetorin e rënies, në vitin 2019



Krahas përurimit të Pllakës përkujtimore për dëshmorët Gafurr e Driton Loku, në 20 vjetorin e rënies u përurua edhe libri monografik ,, Gafurr Loku- simbol lirie e bashkimi''të autorit Shaban Çupi

Fjalë rasti në përurimin e librit:

Gafurr Loku simbol lirie e bashkimi

Të gjithë pajtohemi se çkado që bëjmë për dëshmorët është pak. Megjithate ne bëmë disa përpjekje që kohë pas kohe t`i mbajmë të

pranishëm në mesin tonë gjithë dëshmorët e kësaj treve, qoftë nëpërmjet manifestimeve, qoftë nëpërmjet dokumentarëve, qoftë edhe nëpërmjet këngëve e librave.
Kësaj radhe paraqitemi me librin ,,Gafurr Loku-simbol lirie e bashkimi'' sepse vërtetë Gafurri ishte e tillë, edhe simbol lirie, edhe simbol bashkimi. Dëshmori Gafurr Loku është një aset me vlera të rralla kombëtare dhe gjeografia e veprimit të tij atdhetarë përfshinë një shkallë të gjerë.Ai nuk ishte vetëm i Hanit të Elezit.
Mos të harrojmë, Gafurr Loku me shokë dhe Lëvizja për liri, për 30 vite me radhë, trasuan shtratin e lindjes së kryengritjes gjithpopullore për liri, ashtu siç ishin pushkët e Rexhep Malës e Nuhi Berishës, Rafi Halilit e Tahir Mehës, viteve të 80-ta të shekullit të kaluar, e të gjitha këto krisma për t`u kororizuara me luftën epope të UÇK-së në vitin 1998-1999. Gjithë këto veprimtarë ilegal, ku për veprimtarinë e tyre atdhetare u dënuan me vite të gjata burgu si nacionalistë e irredentistë, ishin balli i luftës për çlirim e njëri nga ata, padyshim se ishte edhe dëshmori Gafurr Loku i cili në altarin e lirisë jo vetëm që u flijua edhe vet, por u flijua bashkë me të birin e tij Dritonin.
Brenda këtij libri do të gjeni shkrime autentike, të mbështetura në burime arkivore, në dosjen politike të tij, por jam i bindur se Gafurr Lokut i mungon edhe një dosje tjetër, ajo e Kosovës, e cila me kalimin e kohës do të zbulohet edhe ajo. Libri, krahas dokumenteve arkivore, është i mbështetur edhe në kujtimet e shokëve dhe familjes së tij, si dhe nga shumë fotografi të cilat u ruajtën fshehurazi në arkivin nëntokësor.
Në anën tjetër, falënderojmë veprimtarin Elmaz Ademin, i cili në zbërthimin e aktivitetit të organizatës politike kombëtare ,,Kushtrimi i lirisë''po zbërthen edhe veprën e dëshmorit Gafurr Loku dhe bashkëveprimtarëve të tjerë dhe i urojmë suksese në vazhdimësi.

Autori i Monografisë

Nuri Bushi (1966-1999)

Kushtron Nuri Bushi
Gjoksin posi mal
Rroftë Kosova jonë
Përpara luftëtarë!

Shtigjeve të lirisë dhe çlirimit kombëtar, një kontribut madhor për liri dha edhe familja Bushi, e cila nga fshati Puset e Nikës për në Han të Elezit ishte shpërngulur në vitin 1963.

Babai Ganiu dhe nëna Azemine në jetën e tyre martesore kishin shtatë fëmijë, gjashtë djem e një vajzë. Dëshmori Nuri Bushi ishte fëmiu i katërt nga xherdani i fëmijëve të baba Ganiut, i cili përveç që ishte një punëtor i mirë, ishte edhe një zejtar i dalluar. Në rropatjet e jetës, e përballë kësaj edhe pushtimi serb, që mbi popullin shqiptarë po bënte njëmijë e një të zezat, në sofrën e kësaj familje të ndershme të kombit s`kishte si të mos bisedohej për situatën që mbretëronte atyre viteve të mbijetesës kombëtare të popullit shqiptarë. Një rol tejet të veçantë në këtë familje kishte nëna Azemine, e cila brumoste me atdhedashuri bijtë e saj sepse e kishte kuptuar thellë se pa liri jeta nuk ka kuptimin e saj. Kjo nënë qëndresë haptazi dhe pa kurfarë frike kërkonte luftimin e pushtuesit i cili për çdo ditë e më shumë bëhej i padurueshëm. Në rrjedhë të këtyre

ngjarjeve, njëri nga ata që jetoi me vuajtjet e popullit dhe që përjetoi thellë dëbimin, torturat dhe mizorit që pushtuesi zbatonte mbi popullin e robëruar, ishte edhe flakadani i lirisë, dëshmori Nuri Bushi.

Nuri Bushi është lindur më 22.9.1966 në Han të Elezit. Shkollën fillore e kreu në Han të Elezit, ndërsa të mesmën në Kaçanik.

Në vitin 1981, burgosin xhaxhain e tij Mehmet Bushin, ekonomistin e parë në trevën e Hanit të Elezit. Burgosja e tij nga pushteti sllavo komunist bëhet pas ngjarjeve të vitit 1981 me pretekst të qartë për shkatërrimin e ekonomisë kosovare, ku Mehmet Bushi në atë kohë udhëhiqte Agrokosovën,e cila kishte arritur të ndërlidhte kontrata ekonomike me ndërmarrje dhe shtete të ndryshme pothuajse e pavarur nga ekonomia centraliste jugosllave. Mehmeti dënohet si ,, kundërrevolucionar'' me 14 vite burg prej të cilëve i vuan shtatë vite. Mirëpo kur në nëntorin e vitit 1994, UDB-a sllave mbyti në torturë kusheririn e tij Ismail Rakën[25] nga Kaçaniku, veprimtar i dalluar i çështjes kombëtare, në shpirtin e Nuriut gufoi një revoltë e madhe ku siç thoshte dëshmori, duhet gjithsesi të shpërthej në një luftë çlirimtare dhe një herë e përgjithmonë Kosova të çlirohej prej pushtuesit serb dhe populli shqiptar të gëzonte lirinë.

Dëshmori Nuri Bushi, nga viti 1992 e deri në vitin 1997 punoi në Itali dhe sa ishte atje, ishte aktivist i dalluar i shoqatës ,,Iliria'' , e cila me kontributet e saj ndihmonte mbijetesën kombëtare në Kosovë. Dëshmori Nuri Bushi në vitin 1995 martohet me Zejdijen nga fshati Paldenicë dhe nga kjo jetë e shkurtër martesore lindën dy vajza.

Rënia e Jasharajve në Prekazin historik, kishte ngritur në këmbë tërë popullin shqiptarë e në rrjedhë të kësaj Nuri Bushi ishte pjesëmarrës i

[25] Ismail Raka mbytet në torturë nga UDB-a serbe më 29 nëntor 1994 në Ferizaj. Ishte ndër të parët që Kaçanikun me rrethinë e furnizoi me armatim që nga viti 1990.Gjatë vitit 1991- 1992 me Ismail Rakën dhe Naser Kukën lidhjet për furnizim me armë për trevën e Hanit të Elezit i ka mbajtur ish i burgosuri politik Bajram Dernjani nga fshati Paldenicë.Krahas kësaj, Bajram Dernjani bashkë me grupin e të burgosurve politik nga Hani i Elezit, ishte edhe organizator i mbledhjes së të hollave për blerjen e armëve në vitin 1991-1992 dhe arriti t`i tuboj 75 mijë marka gjermane dhe për shkaqe objektive ky aksion nuk u realizua.Pasi policia serbe bie në gjurmët e tij, Bajrami në vitin 1993 detyrohet të largohet nga Kosova dhe shkon në Belgjikë.Gjatë luftës së UÇK-së së vitit 1998/1999 ishte organizator i Fondit ,,Vendlindja thërret'' në Belgjikë dhe ka ndihmuar luftën në Puset e Nikës.
Ismail Raka në vitin 1979 shërbimin ushtarak e ka kryer me ikonën e ,,Kushtrimit të lirisë" Rafi Halilin nga Tetova dhe Ismaili ka qenë i malltretuar nga KOS-i ushtarak jugosllav për kontaktet që ai mbante hapur me Rafi Halilin.

të gjtha protestave kundër dhunës, dhe shtypjes serbe që organizoheshin në Han të Elezit gjatë vitit 1998.

Se kjo familje kishte bashkëndjerë thellë vuajtjen e popullit shqiptarë, flet edhe fakti tjetër kur vëllau i dëshmorit Remziu, i cili punonte në Itali, sot pjesëtar i FSK-së, radhëve të UÇK-së iu bashkangjit që nga gushti i vitit 1998 në Puset e Nikës. Me Remzi Bushin, thotë Mehmet Ballazhi, në luftë jemi ardhur, unë nga Gjermania ku punoja, ndërsa Remziu nga Italia. Bashkë me ne ishte edhe Mustafë Berisha nga Gurana dhe pasi erdhëm në Shqipëri qëndrojmë dy javë dhe bashkohemi me grupin e disa të rinjëve të fshatrave të Kaçanikut në Tropojë të cilët kishin ardhur për armatim. Pastaj jemi nisur përmes një fshati të Hasit në Shqipëri dhe përmes Pashtrikut kemi kaluar në Kabash të Prizrenit, ku më pastaj kalojmë në Zonën Operative të Nerodimes.Ky marshim me armatim në shpinë, kujton Mehmet Ballazhi, ka zgjatur rreth dy javë dhe arrijmë në Jezerc ku edhe takojmë luftëtarë të tjerë nga Hani i Elezit si Jahi Shkretën, Avni Hasallarin, Nexhmedin Fidën, Emrush Sumën e Rashid Bardhin, prej kah kthehemi në Puset e Nikës.

Vëllau tjetër i dëshmorit, Jakup Bushi, radhëve të UÇK-së iu bashkangjitet në Pashtrik i cili nga 4 prilli 1999 bashkë me shokët Sali Curri, Adem Kalisi e Lulzim Bushi, lëshojnë punën ku ishin duke punuar në Itali dhe futen në Shqipëri, ku pas trajnimeve të domosdoshme i bashkangjiten Brigadës së UÇK-së të cilën e komandonte Bilall Syla dhe merr pjesë në të gjitha betejat e kësaj Brigade, në veçanti në operacionin ,,Shigjeta" luftë kjo për të shkatërruar kufirin shqiptaro-shqiptarë.

26 shkurti i vitit 1999, shënon edhe shpërthimin e luftës në komunën e Hanit të Elezit. Forcat serbe që në orët e hershme të mëngjesit tentojnë të depërtojnë në zonën luftarake të UÇK-së nëpërmjet pikës luftarake ,,Te antena''por hasin në forcat e UÇK-së të kryesuara nga Emrush Suma, i njohur si komandant Hoxha dhe depërtimi i tyre në brendësi të zonës ishte i pamundur.

Tentimet e serbëve për të depërtuar në zonën e UÇK-së kishte edhe ditëve të tjera si nga Antena e gjithashtu edhe nga Kodra e Faslisë dhe këto tentime, suksesshëm i përballoi, krahas shokëve të tjerë, edhe vetë Nuri Bushi, rrëfejnë bashkëluftëtarët e tij Ekrem Ballazhi, Nesim Curri, Xhelal Bushi, Gazmend Çuni, Ahmet Berisha, Irfan Regjallari etj.

Njëri nga bashkëluftëtarët e Nuriut, Gazmend Çuni, kujton se Nuriun e kam njohur edhe më parë, por në luftë e njoha edhe më shumë. Kur shkonim në roje nëpër pika, kisha dëshirë që gjithnjë te jem me Nuriun sepse ai kishte guxim dhe ideal të madh. Duke vërejtur forcat serbe

se zona luftarake e Puseve të Nikës po mbrohej suksesshëm nga luftëtarët e UÇK-së, ata me 2 mars 1999 ndërmorën në shkallë të gjërë një ofenzivë të madhe dhe nga granatimet e shumta dukej sikur po copëtohej kodra.

Se si u zhvilluan luftimet atë ditë një rrëfim të përgjithshëm na e sjellë Murat Loku, invalid i UÇK-së i plagosur rëndë në ofenzive armike të 2 marsit 1999.

,, U dha alarm nga komanda për t`i përforcuar pikat pasiqë raketat ndriçuese serbe filluan të shkrepnin mbi zonën e luftës. Jam pozicionuar në pikën te Guri i Rezhancës dhe në krahun e djathtë kisha Bajram Selmanin nga fshati Doganaj i ardhur nga Belgjika. Për rreth kisha edhe ushtarët e tjerë. Ishte një rrethim në shkallë të gjërë.Të gjitha pikat tona sulmoheshin, ndërsa granata-hedhësit nga të gjitha drejtimet sulmonin Kodrën e Bajrakut. Një ushtar armik ishte afruar afër vendit ku ishim ne. Me tre, katër plumba në kokë, përfundoi misioni i tij. Në një moment kur ngritem që t`i hedh bombat, një breshëri automatiku më godet në bark dhe mi nxori zorrët jashtë.Në afërsi plagosen edhe dy luftëtarë tjerë.Pas plagosjes u tërhoqa nga shokët më të afërm: Selajdin Kalisi dhe Rrahim Suma të cilët më përcollën te mjeku Fatmir Vila ku dhe mora ndihmën e parë. Meqë granatimet nuk pushonin mbi Kodrën e Bajrakut, shokët më transferuan në spitalin e improvizuar në fshatin e Ivajës ku Dr.Imeri bëri intervenimin kirurgjik duke mi futur zorrët brenda pa anestezion.

Për të përballuar këtë sulm të rëndë dhe në shkallë të gjërë, ushtarët i shpërndamë në shumë pika, sepse forcat serbe kishin rrethuar tërë Kodrën e Puseve të Nikës dhe tentonin të futeshin në të gjitha drejtimet, ndërsa nga shumë anë ne sulmoheshim me minahedhës, kujton komandanti Rufki Suma, duke shtuar se Nuri Bushi me ushtarë të tjerë ka qenë në mbrojtje të pozicioneve te Kodra e Faslisë dhe në hierakinë ushtarake të UÇK-së ishte komandant togu.

Isha me Nuriun kur nga Kodra e Faslisë vërjetëm se te Hunelët e Rezhancës u ndal kolona e kamionëve serb, të cilët ecnin me drita të fikura, por kur frenuan nga treguesit e e dritës së makinës, kuptuam se forcat serbe zbarkuan. Atyre çasteve Nuri Bushi tha: Ju po vini, por s`kanë për t`u kthyer më të gjallë dhe me këto fjalë sikur donte të na jepte zemër neve të tjerëve, kujton Gazmend Çuni.

Orëve të hershme të mëngjesit, të datës 2 mars 1999, Kodra e Puseve të Nikës u përfshi e tëra në luftë. Në njërën anë ishin rreth 70 ushtarë lirie të frymëzuar me idealin e çlirimit të atdheut, ndërsa në anën tjetër një ushtri e tërë dhe e armatosur rëndë. Në këtë betejë të lavdishme, ku numri i forcave armike ishte pakrahasimisht më i madh, në mbrojtje të

atdheut, pikërisht në Kodër të Faslisë bie për të mos rënë kurrë dëshmori Nuri Bushi.

Gjatë kësaj beteje, shkruan Rufki Suma në ditarin e tij,u plagosën Murat Loku dhe Mehmet Bilalli nga Lubishta e Vitisë, kurse, u vra Nuri Bushi, kufomën e të cilit e gjetëm pas një muaji, si dhe zihet rob 17 vjeçari Suad Brava i cili më 22 maj 1999 pushkatohet në burgun e Dubravës.

Siç rrëfen ushtari Nuhi Berisha nga Runjeva e Kaçanikut, me 1 prillit 1999 isha në vijën vëzhgimore bashkë me luftëtarin Minir Çupi. Kur tentuam që edhe më thellë të kalonim Kodrën e Faslisë, për t`i vëzhguar forcat serbe që ishin të pozicionuar te Hunelët dhe rreth Guranës, në afërsi të një pishe pamë një kufomë. I thash ndihmësit tim që me shpejtësi të lajmëron Shtabin dhe kur erdhën shokët nga shtabi e identifikuan se kufoma ishte e ushtarit Nuri Bushi vrarë më 2 mars 1999.

Kufomën e Nuriut e gjetën Nuhi Berisha dhe Minir Çupi dhe menjëherë lajmëruan në Shtab, kujton Mevlud Brava, duke shtuar se Nuriu nga plagët që kishte marrë e që mendoj se është gjuajtur me ,,pragë'' kishte tentuar t`ia jap vetës ndihmën e parë dhe kjo dëshmohet nga fashat në trup dha kufomën pas tërheqjes e kemi vendosur në shtëpinë e Vebi Bravës dhe me nderime ushtarake e fetare kemi varrosur të nesërmen në varrezat e fshatit. Fjalimin e rastit gjat varrimit e mbajti Mehmet Ballazhi, ndërsa faljen e xhenazës e bëri bashkëluftëtari ynë hoxhë Mahi Lusnjani.

Në Ditarin e tij, Mehmet Ballazhi, zv.komandant i Brigadës 164, shënon: Gjetëm kufomën e Nuri Bushit. Në dorën e djathtë kishte një fashë të lidhur, ndërsa në këmbën e majtë, mbi gjunjë, e kishte kapur plumbi i kalibrit 20 mm dhe i kishte dalur në kërdhokël, ndërsa pushkën e kishte mbuluar me trupin e tij[26].

[26] Mehmet Ballazhi,,Nën flamurin e UÇK-së'' fq 45

Foto: Kjo është fashoja e dëshmorit Nuri Bushi në Kodër të Faslisë me të cilën Nuriu ka lidhur plagën, njëkohësisht vendi ku ka ndërruar jetë dëshmori

Nuriun e varrosëm me 2 prill 1999, rrëfen Mehmet Ballazhi zv.komandant i Brigadës, duke shtuar se në varrim morën pjesë të gjithë ushtarët e në mesin e tyre edhe vëllau i dëshmorit, Remzi Bushi dhe për veprimtarinë e dëshmorit, mbajta një fjalim rasti. E varrosëm në varrezat e lagjes Brava për ta rivarrosur me 29 gusht 1999 në varrezat e dëshmorëve në Puset e Nikës.

Xhemsedin Suma dhe Nuri Bushi ishin të një gjenerate, pos kësaj, ata edhe ishin shokë të pandashëm. Bashkarisht iu bashkangjitën Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe bashkarisht në istikame, për të mbrojtur qenien shqiptare, e dhanë edhe më të shtrenjtën, jetën. Nuri Bushi vritet me 2 mars, ndërsa Xhemsedini ditën e nesërme me 3 mars 1999.

Sa ishte gjallë nëna e dëshmorit Nuri Bushi, duke kujtuar birin e saj rrëfente se: Nuriu ishte i përgatitur për luftë. Ai kishte krijuar një urrejtje të vazhdueshme për pushtuesin. Kur doli në mal e kam ditur se më nuk do të kthehet. Kështu dëshmonte zemra e nënës. Jam mërzitur derisa ia kemi gjetur kufomën. Pas vete ka lënë dy vajza, të cilat po rriten ashtu siç po rritet liria e Kosovës, kujton kjo nënë qëndresë, e cila me qëndrimin e saj

burrëror po ju jep gjallëri jo vetëm nënave dhe familjeve të dëshmorëve, por gjithë trevës së Hanit të Elezit.

Dëshmori Nuri Bushi ishte i martuar dhe në jetën e shkurtër martesore me Zejdijen kishte dy fëmijë: Elvanën dhe Nurijen dhe kjo e fundit ka lindur pas vrasjes së dëshmorit dhe ka trashëguar me pietet emrin e babait dëshmor.

Për kontributin e tij, Qeveria e Përkohshme e Kosovës, SHP i UÇK-së, Zona e VI e TMK-së,Kuvendi komunal dhe Batalioni 36 i xhenios, dëshmorin Nuri Bushi e nderuan me mirënjohje, ndërsa një rrugë në Han të Elezit mban emrin e tij. Me vendim presidencial është shpallur Hero i Kosovës.

Fotografia e dëshmorit e ripunuar nga rapsodi Milaim Mezini në kohën kur po inqizohej kënga „Dy shqiponja në Puse të Nikës’’këngë e cila u përurua në 20 vjetorin e dëshmorëve Nuri Bushi e Xhemsedin Suma

Lutje nënash për bijtë e tyre dëshmorë: Nga e majta, nëna e dëshmorit Veli Ballazhi dhe nëna e dëshmorit Nuri Bushi, tanimë e ndjerë.

Përurimi i pllakës së dëshmorit në Kodrën e Faslisë, 2019

Pllakë e ngritur në vendin e rënies në 20 vjetorin e rënies së dëshmorit

Momente gjatë përurimit të pllakës përkujtimore në sheshin e komunës në vitin 2019, ku në njërën anë u skalitën dëshmorët, ndërsa në pjesën tjetër viktimat civile të luftës

Një fotografi e datës 5 mars 2021 me pjestarë të familjeve të dëshmorëve pranë pllakës përkujtimore në Han të Elezit

Xhemsedin Suma (1966-1999)

Për liri t'atdheut
Pushka bëhet top
Lufton Xhemsedini
Burra te vdesim sot.

Dëshmori Xhemsedin Suma u lind në vitin 1966 në fshatin Dimcë. Babai Ibrahimi dhe nëna Atmane në jetën e tyre martesore kishin gjashtë fëmijë, katër djem e dy vajza. Dëshmori Xhemsedin Suma ishte fëmiu i tretë i kësaj familje. Shkollën fillore e kreu në qytetëzën e Hanit të Elezit, ndërsa të mesmen në Kaçanik, në drejtimin teknik për axhustator.

Si gjithë të tjerët edhe Xhemsedin Suma përjetoi rëndë pushtimin e Kosovës. Ai nga viti 1991 e deri në vitin 1995 punoi në Itali bashkë me vëllezërit e tij Huseinin dhe Fadilin si dhe shokun e tij të pandashëm Nuri Bushin. Pas kthimit nga Italia, Xhemsedin Suma martohet me Mejremen në vitin 1995, ndërsa në vitin 1997 lindi vajza e vetme Mevlidja.

Xhemsedin Suma mori pjesë në të gjitha protestat që organizoheshin në Han të Elezit kundër dhunës dhe shtypjes serbe, por kur më 28 nëntor 1997, në Llaushë doli hapur Ushtria Çlirimtare e Kosovës, në shpirtin e Xhemsedinit agoi edhe shpresa e çlirimit.

Meqë vëllau i tij Rufki Suma, nëpërmjet gjeneral Shaban Shalës (tani i ndjerë) , në prillin e vitit 1998, depërtoi te luftëtarët e lirisë në Drenicë, ai në hollësi do t`ia shpjegoj Xhemsedinit të gjitha përshtypjet nga tabloja e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, e cila pas vrasjes heroike të

Komandantit legjendar Adem Jashari, po i ngjitej një organizimi edhe më të madh. Ky organizim ushtarak nën emblemën e UÇK-së ndodhi edhe në trevën e Hanit të Elezit ku nga prilli i vitit 1998, filluan blerjen dhe bartjën e armëve të cilat arritën t`i fusin fshehurazi nga Maqedonia në Han të Elezit. Për këtë aktivitet ishte i informuar edhe Xhemsedin Suma dhe me këtë veprim po hidheshin themelet e çlirimit të kësaj treve nga pushtuesi serb. Më 16 qershor 1998, zbulohet aktiviteti i grupit dhe një pjesë e veprimtarëve arrestohen e në anën tjetër policia serbe ndërmerr një fushatë të egër për arrestimin edhe të anëtarëve të tjerë të grupit dhe me këtë rast bastisen shtëpitë e të kërkuarve[27] e në mesin e tyre edhe shtëpia e Rufki Sumës. Por, meqë Rufkiu tanimë me shokë kishte shkelur malet e Puseve të Nikës, policia serbe arreston babain e Rufkiut, Ibrahimin dhe vëllaun e tij Hyseinin, të cilët për disa ditë me radhë i keqtrajtojnë rëndë në stacionin policor të Ferizajt.

Vëllau i dëshmorit, Husein Suma gjatë atyre ditëve të rënda kujton se ,, Në stacionin policor në Han te Elezit na kanë rrahur më tepër se dy orë deri në alivanosje, pastaj na gjuanin ujë me kovë, pas këtij keqtrajtimi na kanë lidhur këmbë e duar dyve bashkë dhe përsëri na kanë hipur në automjetin picgauer. Gjatë tërë rrugës na kanë rrahur me shufra hekuri dhe shkopinj bejsbolli. Gjatë rrugës për në Ferizaj, në vendin e quajtur Ura e Krivarekës, e ngadalësuan automjetin dhe na kapen nga katër policë, dy në duar dhe dy në këmbë dhe na ngritën lartë duke na kercënuar me hudhje nga ura nëse nuk tregojmë se ku gjendet vëllau Rufkiu dhe armët e UÇK-së… ‘’

Pas kësaj situate tejet të rëndë në familje, Xhemsedin Suma kaloi në ilegalitet duke qëndruar nëpër shtëpitë e farefisit të tij, ndërsa familja largohen për në Shkup.

Tekniku medicinal Fatmir Vila, bashkëluftëtarë me Xhemsedin Sumën, kujton se një natë kisha një intervenim mjekësor në Lagjen e Ujit të Thartë, më saktë të motra e martuar e Xhemsedinit dhe sapo u futa në oborrin e kësaj shtëpie, papritmas përpara më doli Xhemsedini për të cilin e dija se jeton fshehur dhe përnjëherë nga gëzimi që e takova i thashë: Xhemë, ku e ke kallashin? Ai pa asnjë ngurrim dhe duke buzëqeshur më

[27] Bastisen shtëpitë e Rufki Sumës, Nesim Currit, Zekirija Shkretës, Arif Currit, Shefket Topojanit, Valon Berishës, Sherif Berishës, Rexhep Shkretës, Zenun Berishës, Hamit Berishës, Fadil Berishës, Afet Kryeziut, Bislim Kaloshit. Në fshatin Seqishtë gjatë bastisjes ka pasur edhe të shtëna me armë ku gjuhet në drejtim të Zekirija Shkretës e Nesim Currit dhe nga terrori i pushtuesit familjet detyrohen që nga 21 qershori 1998 të shpërngulen në Shkup.

afroi te dhoma ku strehohej, dhe më tha: Ja ku e kam. Pas ndihmës që i dham pacientes, me Xhemën biseduam shumë dhe më tregoi shumëçka për organizimin e luftës që bëhej në Puset e Nikës dhe nga frymëzimi i Xhemsedin Sumës edhe unë iu bashkangjita radhëve të UÇK-së. Në Puset e Nikës dola nëpërmjet lidhjes së Shaban Ballazhit dhe atje gjeta shokun dhe frymëzuesin tim Xhemsedinin. Me Xhemën, bënim roje nëpër pikat e zonës luftarake dhe gjatë atyre netëve të acarta, Xhema më shpjegonte për armatimin, llojin e tij si dhe më informoi se shumë shokë i kemi në Shqipëri të cilët kanë shkuar për të marrë armatim dhe së shpejti do të kthehen. Xhemsedin Suma ishte i etur për liri, nuk dinte se ç`është frika dhe mezi priste të ballafaqohej me forcat serbe dhe më tingëllojnë edhe sot fjalët e tij kur na thoshte se,, këta janë bisha të egra dhe se këta, pra serbët, vetëm me pushkë ndalen". Qëndrimi i tij, vërtetë ishte moral për gjithë ushtarët sepse në radhët tona kishim ushtarë shumë të rinjë. Një natë para se të na sulmonin serbët, e ku i pranishëm ishte edhe dëshmori tjetër Nuri Bushi, përndryshe shokë të një gjenerate, Xhema, tha:

,, O shokë, me fat na qoftë lufta! Duhet të jemi të kënaqur që erdhi koha që pushtuesit t`ia kthejmë pushkën" dhe vërtetë ashtu ndodhi, ai që në betejat e para u tregua trim, guximtar dhe i etur për çlirimin e atdheut, kujton Fatmir Vila nga Hani i Elezit.

Pas vrasjes së Gafurr Lokut, një ekip i OSBE-së kërkon që nëpërmjet pikës luftarake të Puseve të Nikës të kalon në fshatin Kotlinë, Xhemdsedin Suma pasiqë ishte në pikën e rojes, nuk lejoi një gjë të tillë, duke i thënë ekipit të OSBE-së se për Kotlinë ka edhe rrugë të tjera sepse Xhemsedini nuk donte që do të zbuloheshin pozicionet e UÇK-së.

Më 26 shkurt 1999, forcat serbe tentuan që fshehurazi të depërtojnë në zonën të cilën e kontrollonin pjesëtarët e UÇK-së që nga 19 qershori i vitit 1998. Ky tentim, zbulohet nga ushatarët e UÇK-së dhe depërtimi i forcave armike ishte i pamundur pas pushkëve që shkrepën liridashësit e Kosovës.

Në Ditarin e tij, Rufki Suma, komandanti i njësitit e më vonë i Brigadës 164 të UÇK-së rreth kësaj date shkruan:

Në orët e hershme të mëngjesit, ushtria dhe policia serbe tentoi që nga Antena t`i rrethojë pozicionet e UÇK-së, por hasi në rezistencën e luftëtarëve të lirisë të prirë nga Emrush Suma[28] . Lufta u zhvillua në afërsi.

[28] Në momentin kur serbët sulmojnë forcat e UÇK-së në Puset e Nikës, komandanti Rufki Suma gjendej në mbledhje të Shtabit në fshatin Nikaj,të cilën mbledhje e drejtonte komandanti i Zonës Operative të Nerodimes, Shukri Buja. Më gjerësisht shih Mr.sc.Hajrush Kurtaj ,,Lufta e UÇK-së në ZON"

U vranë të paktën një polic serb, ndërsa u plagosën shumë të tjerë. Në këtë vendluftim u gjetën edhe plumba nitroglicerin të përdorura nga policia dhe ushtria serbe të cilët duke mos pasur mundësi të thyejnë këtë pikë, tentojnë të futen në anën tjetër, nga Kodra e Faslisë, por edhe nga kjo anë depërtimi i tyre ishte i pamundur, kështu që forcat serbe kthehen për t`u mobilizuar përsëri, ndërsa nga ana e ushtarëve tanë, në pikën „Te Antena" u plagos ushtari Servet Shkreta, të cilin e mjekuam në ambulancën e improvizuar në fshatin Kotlinë''

Pasi morëm lajmin nga vëzhguesit tanë se një tog serb ishte zbarkuar mbi fshatin Meliç dhe se po vazhdonte në drejtim të pozicioneve tona, alarmova të gjithe shokët për mbrojtje, kujton Emrush Suma, duke vazhduar se, një grup që ishte më i përgatitur, e në mesin e këtij grupi edhe Xhemsedin Suma, i urdhërova të vishen me uniforma të bardha dhe u nisëm në drejtim të Antenës. Aty u ndeshëm me armikun në një afërsi prej 15 metra. Deshti Zoti që ne i vërejtëm të parët dhe hapa zjarr i pari në dy ushtarët serb që e udhëhiqnin togun[29].

Pas dështimit të forcave serbe për të marrë hapsirën që e kontrollonte UÇK-ja , ku një kontribut madhor gjatë kësaj beteje dha edhe Xhemsedin Suma, në mbrëmje bashkëluftëtarit të tij Fatmir Vilës i thotë: A po e sheh Fatmir, kjo bishë e egër din edhe të frikohet dhe se nuk guxon të ballafaqohet pushkë me pushkë, duke më thanë se nesër do të shkojmë t`i sulmojmë serbët në pikat e tyre[30].

Shërbimi për informim i Zonës Operative të Nerodimes[31], rreth betejës së 26 shkurtit 1999 njofton se ,,Sot paradite nga Kazerma e ushtrisë serbe në Han të Elezit, u sulmua fshati Pustenik (Puset e Nikës v.j.)...Po kështu, sulme të provokuara në drejtim të pozicioneve të UÇK-së, u kryen edhe nga pozicionet ushtarako-policore serbe në fshatin Meliç,..., me ç`rast u plagos një pjesëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, duke vazhduar njoftimin se nga 23 shkurti (1999 v.j) forca të mëdha të policisë dhe ushtrisë serbe, filluan të koncentrohen përgjatë kufirit Kosovë-Maqedoni, me ç`rast filloi edhe kërcnimi i hapur mbi popullatën civile...ku Serbia synon largimin e popullsisë në një distancë prej 5 kilometrave'' thuhej ndër të tjera në informatën nga Shërbimi për informim i Zonës Operative të Nerodimes rreth betejës së kësaj dite.

---

[29] Emrush Dernjani ,,Hani i Elezit me rrethinë'' , Prishtinë 2001, fq.176

[30] Informatë e Fatmir Vilës dhënë Shoqatës së Familjeve të Dëshmorëve - Dega në Han të Elezit

[31] Ruzhdi Jashari ,,Zëri i lirisë'', Prishtinë, 2009, fq.92

Tentime të tilla, për ndërhyrje në pozicionet e UÇK-së në Puset e Nikës, kishte në vazhdimësi dhe pas dy ditësh në vendin e quajtur ,,Arat e Rogaqit'' plagoset ushtari tjetër i UÇK-së, Ibrahim Brava.

Pushtuesi serb, krahas sulmit mbi forcat e UÇK-së në Puset e Nikës, më 28 shkurt 1999 tentojnë të hyjnë në fshatin Gajre, por këta forca ranë në pritën e Togut të UÇK-së të Brigadës 162 ,,Agim Bajrami'' i udhëhequr nga dëshmori Hetem Hasaj dhe në këtë betejë vritet komandanti i policisë serbe në Kaçanik i ashtuquajturi ,,Bogi" kurse nga teknika u shkatërrua një autoblindë, pizgauer dhe një automjet i markës ,,Niva"[32]. Kjo betejë, ngriti moralin luftarak të tërë njësive të UÇK-së në Grykën e lavdishme të Kaçanikut, ndërsa në anën tjetër e egërsoi edhe më shumë pushtuesin.

Hartë luftarake e UÇK-së[33] për betejën e 26 shkurtit 1999 në Puset e Nikës

Forcat pushtuese serbe, duke e vërejtur se pozicionet e UÇK-së nuk po mund të merren me njësi të vogla, me 2 mars të vitit 1999, ndaj pikës luftarake të Puseve të Nikës, ndërmori ofenzivën më të madhe dhe treva e Hanit të Elezit, përkatësisht Puset e Nikës, rrethohen në shkallë të gjërë. Kjo ofenzivë u ndërmor që nga orët e hershme të mëngjesit ku ushtria dhe policia serbe ishin të mbështetura edhe nga tankset dhe minahedhësit dhe kjo pikë luftarake sulmohet 12 orë të plota. Kjo ngjarje është shumë e freskët për popullatën e kësaj ane sepse në këtë kohë, ende kanë qenë në shtëpitë e tyre dhe duke u mbështetur në sulmet që iu bënë kësaj pike luftarake, të mbushej mendja se asnjë ushtarë i UÇK-së s`do të mbetej i gjallë. Në këtë betejë të madhe e të përgjakshme, mori pjesë dhe i përballoi

[32] Mr.sc.Hajrush Kurtaj ,,Lufta e UÇK-së në ZON" fq.65
[33] Mr.sc.Hajrush Kurtaj,,Lufta e UÇK-së në ZON", Prishtinë 2012,fq.63

suksesshëm edhe ushtari i lirisë Xhemsedin Suma, ndërsa në Kodrën e Faslisë bie heroikisht, në mbrojtje të pozicioneve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, dëshmori Nuri Bushi.

Ofenzivën armike të 2 marsit, rrëfen komandanti Rufki Suma, njësiti ynë e përballoi me sukses. Këmbësoria serbe nuk mundi të depërtoj në pozicionet tona dhe të asgjësoj pikën tonë luftarake. Përkundër armatimit të paktë që kishim, ushtarët tanë dhanë maksimumin e tyre. Gjatë kësaj beteje, ra për t`mos vdekur kurr, dëshmori Nuri Bushi, ndërsa u plagosën Murat Loku dhe Mehmet Bilalli nga Lubishta e Vitisë, ndërsa zihet rob ushtari Suad Brava dhe se përpjekjet për asgjësimin e kësaj pike luftarake, nuk do të pushojnë as ditëve, javëve dhe muajëve të tjerë.

Në një raport zyrtar dërguar komandës së Brigadës 162 ,,Agim Bajrami'' , komandanti i Batalionit të tretë, Rufki Suma, njoftonte se deri më datën 8.11.1998, kishte në disponim këtë lloj armatimi: 30 pushkë automatike, tri pushkë njëzetëshe, dy pushkë gjysmëautomtike, një pushkomitraloz të lehtë, katër manzere, 4200 fishekë për pushkë automatike, një mortaj 500 me katër predha, 15 copë eksploziv, 27 uniforma,një gjoksore, 62 bomba dore, dy dëlbi dhe një telefon mobil.

Se lufta në Puset e Nikës ishte e madhe, ndërsa qëndresa për liri kishte marrë dimenzionin historik, shprehet edhe nga ana mediale, ku Shërbimi për informim i Zonës Operative të Nerodimes, për opinionin publik, rreth betejës së 2 marsit të vitit 1999 njofton se ,,Me zjarr artilerie dhe me armë të tjera u sulmuan fshatrat: Rezhancë, Gorancë, Pustenik, Kotlinë, Gajre, etj'' [34].

Në orën 4 të mëngjesit, rrëfen Nuri Brava, ushtria serbe ka hedhur raketa ndriçuese dhe menjëherë filluan sulmet e armikut kundër pozicioneve tona në vendin e quajtur ,,Te Qarrat'. Sulmet filluan nga të gjitha drejtimet, edhe në pikën ku isha unë te ,,Kodra e vorreve'', kujton Nuri Brava duke shtuar se serbët krahas armëve tjera të rënda gjuanin edhe me armë snajperike, ndërsa unë kisha një pushkë M-48 mm të prodhimit gjerman dhe se gjatë tërë ditës së 2 marsit kam shkëmbyer zjarr me forcat serbe, ashtu siç mbronin pikën tjetër të luftës te ,,Kodra e Dacëve'' njësiti i UÇK-së nga fshati Bob[35] i udhëhequr nga Muzafer Çaka.

Xhemsedin Sumën e njoha në istikamet e qëndresës në Puset e Nikës, rrëfen Sadik Rushit Dema, bashkëluftëtar i dëshmorit nga fshati Bob i Kaçanikut. Gjatë bisedës, ai me tregoi se ishte vëllau i komandant Rufit. Pos automatikut dhe bombave, Xhemsedini kishte edhe radiolidhjen

[34] Po aty fq.94
[35] Po aty fq 193

me të cilën komunikonte me komandën, pasiqë Xhemsedini ishte komandant togu. Ishte shok i dashur, ishte trim e luftëtar i pa lodhshëm. Në këto beteja qe shquar për shkathtësi, trimëri dhe ishte njohës i mirë i terenit. Në betejën e 2 marsit 1999 nuk besoj se kemi qenë më shumë se 78 ushtarë të UÇK-së dhe lufta me pushtuesin nga lagja e Dacëve e deri te Qarrat është zhvilluar në afërsi prej 150-200 metra. Sulmoheshim nga të gjitha anët dhe me të gjitha llojet e armëve, ndërsa këmbësoria ishte futur në të gjitha drejtimet.Herë pas here Xhemsedini thoshte të ndrrojmë shpesh pozicionin dhe të qëndrojmë larg njëri tjetrit 7 deri në 10 metra dhe të ruhemi nga gjuajtjet e snajperistëve serb. Madje më kujtohet një rast kur luftonim në vendin e quajtur ,,Te qarrat'' ku Xhemsedini me shpejtësi kërceu nga një shkëmb prej të cilit vëzhgonte forcat serbe. Ne menduam se e mori plumbi, por ai tha se e qëlluan me pushkë snajperike. Në këtë pikë ishim 13 ushtarë e meqë nuk kishim pushkë të mjaftueshme, katër ushtarë kanë qenë të pa armatosur. Morali i ushtarëve të UÇK-së ishte i madh sepse luftonim për vendin tonë, për popullin tonë, për lirinë që se kishim shijuar kurrë. Përkundër ofenzivës së madhe, në betejën e 2 marsit, UÇK-ja korri një fitore të pa kontestueshme, armiku nuk mundi t`i pushton pozicionet. Gjatë kësaj dite në luftë me forcat armike u vra Nuri Bushi, ndërsa u plagosën dy të tjerë. Rreth orës 1 të natës, të datës 3 mars 1999, arritëm në fshatin Kotlinë dhe një pjesë e ushtarëve me Xhemsedinin u futën në një shtëpi, ndërsa në shtëpinë tjetër ishim ne ushtarët e fshatit Bob ku familjet kotlinase na shtruan bukë. Kah ora katër e mëngjesit jemi ndarë. Ne shkuam për në vijat e luftës në fshatin Ivajë, ndërsa Xhemsedini në drejtim të Puseve të Nikës. Ky ishte edhe takimi im i fundit me dëshmorin e lirisë Xhemsedin Suma, kujton Sadik Dema, pjesëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Në një rast kur forcat serbe tentuan të futen nga Uji i Thartë për në Puset e Nikës, meqë me Xhemsedinin ishim në pozicione te Pika e Dacëve, me të shpejtë u zurëm pritë te kthesa për në lagjen e Bushëve të Poshtëm dhe pasi serbët na vërejnë tërhiqen, kujton bashkëluftëtari i Xhemsedinit, Remzi E.Dema nga fshati Bob i Kaçanikut,zv.kom. i Kompanisë të fshatit Bob,duke shtuar se, Xhemsedin Suma ishte djalë trim, guximtarë i pashoq dhe këmbëngulës për të fituar lirinë[36].

Dita e 3 marsit, Puset e Nikës përsëri do t`i gjej në flakët e luftës dhe për të mbrojtur pikën,,Te Antena" të cilën edhe e kishin minuar serbët, krahas ushtarëve të tjerë ishte edhe vëllau im Xhemsedini. Në këtë vend,

[36] Informatë e Remzi E. Demës dhënë Shoqatës së Familjeve të Dëshmorëve

vazhdon Rufkiu, zhvillohet një betejë e befasishme mes forcave serbe dhe ushtarëve tanë. Bekim Suma, tani pjesëtar i Policisë së Kosovës, dëshmitar i afërt i vrasjes së Xhemsedinit rrëfen se,, Kur iu afruam Antenës në afërsi prej 5-10 metra, forcat serbe hapën zjarr të pandërprerë dhe në këto momente Xhemsedini bie në altarin e lirisë, por nuk patëm mundësi ta tërheqim kufomën prej plumbave serb''

Pas caktimit të detyrave, rrëfen Emrush Suma, bashkë dhe Agim Shitin, u nisëm që të vëzhgojmë edhe pikën e fundit te Antena. Ishte ora 6 e mëngjesit kur arrita te kjo pikë, hasëm në një rezistencë të ushtarëve serbë. Pas një përleshje të gjatë, ku vramë një epror dhe i plagosëm disa ushtarë të tjerë, u tërhoqëm në drejtim të bazës, por gjatë tërheqjes sonë, me t`i dëgjuar krismat, në anën tjetër ishte nisur për t`na dalur në ndihmë Xhemsedini bashkë me Bekim Sumën, por bien në pritën serbe ku edhe vritet Xhemsedin Suma[37].

Shërbimi për informim i Zonës Operative të Nerodimes për betejën e kësaj dite njofton se ,,Situata në rajonin e komunës së Kaçanikut është mjaftë e rëndë. Edhe sot nga policia serbe pati të shtëna të vazhdueshme në drejtim të fshatrave që shtrihen në anën e djathtë të magjistrales Kaçanik – Shkup, duke vazhduar në njoftimin e mëtejmë, se gjendja humanitare e të zhvendosurve është në kufijtë e një krize humanitare''[38].

Lajmi për vrasjen e Xhemsedin Sumës u prit rëndë nga bashkëluftëtarët e tij, por njëkohësisht u shtua edhe më shumë urrejtja ndaj pushtuesit serb. Edhe më i dhimbshëm ishte fakti se trupin e pajetë të dëshmorit kishin arritur që ta marrin serbët për të bërë identifikimin e tij dhe për disa ditë me radhë qëndron në kazermën e ushtrisë serbe në Han të Elezit.

Në Ditarin e luftës, komandanti Rufki Suma, shkruan se ,, Më 14.3.1999 u bë identifikimi i kufomës së Xhemsedin Sumës, i vrarë më 3.3.1999. Nga spitali i Prishtinës kufomën e nxori daja im Rasim Loku dhe kufomën e dërguan në xhaminë e Ferizajt pasiqë në Han të Elezit nuk kishte rrethana varrimi. Varrimi i Xhemsedinit u bë në varrezat e Ferizajt më 15.3.1999, në orën 13,00 në prani të mijëra qytetarëve nga rrethi i Hanit të Elezit, Kaçanikut, Ferizajt. U vendosën shumë kurora lulesh. Në këtë varrim merrte pjesë edhe OSBE. Kontribut të pamohueshëm në gjetjen dhe nxjerrjen e kufomës dha Fatmir Gashi nga Ferizaj[39].

---

[37] Po aty,fq.177

[38] Ruzhdi Jashari ,,Zëri i lirisë'',Prishtinë 2009,fq.95

[39] Rufki Suma ,,Ushtria Çlirimtare e Kosovës në trevën e Hanit të Elezit'', 2001, fq 29,30

Pas lufte, bëhet zhvarrimi i dëshmorit dhe me nderime kombëtare rivarroset në varrezat e dëshmorëve në Puset e Nikës më 29 gusht 1999. Dëshmori Xhemsedin Suma jetoi 33 vite dhe ishte i martuar. Pas vetes ka lënë vajzën Mevliden e lindur në vitin 1997, e cila me suksesin e saj të shkëlqyeshëm po i ngjitet horizonteve të diturisë.

Qeveria e Përkohshme e Kosovës, SHP i UÇK-së, Zona e VI-të e TMK-së, Kuvendi komunal dhe nga Batalioni 36 i xhenios, veprimtarinë e dëshmorit e ka nderuar me mirënjohje, ndërsa një rrugë në Han të Elezit mbanë emrin e tij. Me vendim presidencial është shpallur Hero i Kosovës.

Pjesëtarët e UÇK-së gjatë krismave nderuese në rivarrimin e dëshmorëve më 29 gusht 1999, Puset e Nikës

Dëshmori Xhemsedin Suma

Vazhdojnë luftimet në Pustenik

(RKL): Gjatë tërë parasitës së sotme, që nga orët e hershme të mëngjesit (4.40), forcat serbe që po sulmojnë fshatin Pustenik, afër Hanit të Elezit. Përveç granatimeve, ka luftime shumë të ashpra edhe në afërsi të drejtpërdrejtë. Deri tash njoftohet për 3 ushtarë të plagosur të UÇK-së, kurse për humbjet në radhët e forcave serbe nuk ka njoftime.

Radio Kosova e Lirë, njofton opinionin publik për luftën në Puset e Nikës, 2 mars 1999[40]

Edhe sot u sulmua Pusteniku, një epror serb i vrarë

(RKL): Sot, forcat serbe kanë sulmuar përsëri fshatin Pustenik, afër Hanit të Elezit. Në kundërpërgjigje, forcat e UÇK-së në lagjën e Bushëve kanë vrarë një epror të ushtrisë serbe. Forcat serbe u de-

[40] Radio Kosova e lirë, Arkivi II, Prishtinë 2009

Njoftimet e Radios Kosova e Lirë për luftën e UÇK-së në Puset e Nikës,3 mars 1999

Në kazermën serbe në Han të Elezit gjendet kufoma e një personi të paidentifikuar

(RKL): Hani i Elezit. Sot rreth orës 13.30, një konvoj i trupave të ushtrisë serbe ka defiluar nga Kaçaniku në drejtim të Hanit të Elezit. Gjendja në këtë qytet është tepër e rëndë. Vazhdojnë legjitimimet, keqtrajtimet dhe arrestimet e qytetarëve. Brenda 24 orëve, janë rrahur tre civilë, ndërsa dy të tjerë janë arrestuar. Që nga ofensiva, në kazermën ushtarake serbe në Han të Elezit gjendet një kufomë e paidentifikuar.

Dy të zhdukur në Han të Elezit

Para më se një jave, pas sulmeve serbe në fshatrat e Hanit të Elezit, janë zhdukur dy shqiptarë: Xhemsedin Suma (33) e Nuri Bushi (33).

Ndërkaq, njoftohet se në kazermën e ushtrisë serbe gjendet një kufomë e një shqiptari të paidentifikuar.

Radio Kosova e Lirë njofton opinionin e gjërë për zhdukjen (vrasjen)e dëshmorëve Xhemsedin Suma e Nuri Bushi

Forca serbe në drejtim të Kaçanikut

(RKL): Gjatë tërë natës dhe ditës së sotme, në drejtim të Kaçanikut, Gllobočicës e Hanit të Elezit, shkuan shumë konvoje me makineri të shumta luftarake. Rreth orës 5.30, filluan sulmet e para kundër fshatrave shqiptare dhe pozicioneve të UÇK-së. Me granatime e mitralime nga tanket, autoblindat etj., si dhe me këmbësori, u sulmuan Shtraza, Kotlina, Ivaja e Pusteniku. Njësitet e UÇK-së, sulmeve iu përgjigjen në mënyrë adekuate, duke u shkaktuar forcave armike humbje të mëdha. Ndërkaq, nga granatat u vra një ushtar i UÇK-së dhe katër të tjerë u plagosën.

Pozicionet e UÇK-së po mbrohen me vetëmohim e heroizëm të paparë. Luftimet më të ashpra janë bërë te livadhet e Shtrazës, kurse forcat armike, nga larg, përveç pozicioneve të UÇK-së, kanë bombarduar edhe fshatin Shtrazë. Ky fshat, në mëngjesin e ditës së sotme ishte i mbuluar nga tymi.

Nga njoftimet e Radios Kosova e Lirë për luftën dhe qëndresën e UÇK-së në Grykën e Kaçanikut më 8 mars 1999



Konfrontime ushtarake në fshatrat e Kaçanikut

(RKL): Kaçanik. Në orën 5.30, në fshatin Pustenik, afër Hanit të Elezit të komunës së Kaçanikut, kanë filluar konfrontime të armatosura midis forcave ushtarake serbe dhe njësiteve të UÇK-së.

Në orën 6.00, forcat serbe kanë filluar të gjuajnë në drejtim të Pustenikut edhe nga ana e Gorancës. Këto gjuajtje kanë pushuar për pak kohë, por pastaj kanë rifilluar. Njësitet e UÇK-së po kundërpërgjigjen në vetëmbrojtje.

Në drejtim të Kaçanikut, Hanit të Elezit e Glloboçicës, sot herët, kanë shkuar konvoje të mëdha të forcave serbe. Një konvoj i tillë, i përbërë nga 20 automjete të rënda ushtarake, tanke, autoblinda e kamionë, rreth orës 3.30, ka shkuar nëpër Dubravë për në Glloboçicë për në fshatin Gorancë, kanë shkuar katër tanke dhe armatime të tjera.

Një konvoj tjetër prej katër tankesh dhe dy autoblindash të tjera ka shkuar në drejtim të Hanit të Elezit. Duke kaluar nëpër Kaçanik, forcat serbe kanë shtënë me armë të rënda, në drejtime të ndryshme. Një konvoj tjetër prej 20 kamionësh, autoblindash e pjesëgauerësh, rreth orës 7.10, sërish ka shkuar në drejtim të Hanit të Elezit.

Këtë rrethim ushtarak të fshatrave të Kaçanikut dhe sulmet kundër tyre, regjimi serb, sikurse ka paralajmëruar, i ka ndërmarrë nën firmën e të ashtuquajturave ushtrime ushtarake.

Nga njoftimet e Radios Kosova e Lirë më 8 mars 1999

Përurimi i pllakës përkujtimore të dëshmorit Xhemsedin Suma, 2019

Shpalimi i pllakës përkujtimore të dëshmorit Xhemsedin Suma në vendin e rënies, në mes të tjerëve edhe nëna e dëshmorit në vitin 2019

Në nderim të dëshmorëve, 2019 në Puset e Nikës

Institucioni komunal në nderim te vendi i rënies së dëshmorit Xhemsedin Suma, 2022

Shaban Çupi: Fjalim për dëshmorët Nuri Bushi e Xhemsedin Suma në 20 vjetorin e rënies, 2019

Të nderuar pjesëmarrës të kësaj Akademie!

Sot po shënojmë 20 vjetorin e rënies së dëshmorëve Nuri Bushi e Xhemsedin Suma, të cilët ranë në luftë për liri, ranë pikërisht para 20 viteve, andaj nderi e lavdia për jetë e mot iu takon atyre, që për lirinë dhe çlirimin e Kosovës dhanë më të shtrenjtën, jetën.

Rënia e dëshmorëve Nuri Bushi e Xhemsedin Suma, që të dy me vendbanim në Han të Elezit, na ndërlidhin me ngjarje të mëdhaja lufte, na ndërlidhin me sakrifica sublime për liri, na lidhin me Zjarret e Marsit, na lidhin me stinën e bukur të pranverës si sinonim i lirisë.

Beteja e 2 e 3 marsit 1999, ishte rrjedhë e betejave paraprake të cekura edhe më lartë, ku Nuri Bushi e Xhemsedin Suma, ishin pjesëmarrës aktiv dhe në front lufte kundër pushtuesit serb, dhe kjo betejë ishte një betejë autoktone e luftës për liri e çlirim. Nuk ishte një luftë e sponzorizuar nga të tjerët e as luftë legjionarësh, por thjeshtë ishte një luftë çlirimtare për të çliruar Kosovën e robëruar dhe të vetmën gjë që e donin çlirimtarët, ishte liria dhe çlirimi i popullit shqiptar dhe në luftë merrnin pjesë vullnetarisht.

Në anën tjetër, në Kosovë vetëm pushtuesi ishte i huaj, dhe nëpër vite e dekada kishte bërë 1001 të zezat mbi këtë popull; që nga ndjekjet,

burgosjet, torturat e dëbimet e dhunëshme dhe me synim të qartë zhdukjen e popullit shqiptarë. Andaj, beteja e 2 e 3 marsit të vitit 1999, radhitet ndër betejat më të rëndësishme në historinë e kësaj treve. Jo që betejat tjera ishin më pak të rëndësishme, por në këto beteja armiku synonte zhdukjen e plotë të zjarrit të lirisë dhe të çlirimit i cili u përflak nga komandant Adem Jashari që në marsin e vitit 1998 në Prekazin e lavdisë.

Më 2 e 3 mars 1999, Kodra e Puseve të Nikës u përplasë me forca të mëdhaja luftarake. Në njërën anë ishin luftëtarët e lirisë me afërsisht 70 ushtarë, ku merrnin pjesë edhe ushtarë nga Brigada 162,,Agim Bajrami'' nga Kaçaniku, më konkretisht njësitë nga fshati Bob, ndërsa në anën tjetër ishte pushtuesi i cili kishte angazhuar rreth 7000 forca policoro-ushtarake dhe me arsenal të madh armësh. Arma më e fuqishme e UÇK-së ishte gulinovi 12.7 mm dhe mortja 500 si dhe manzeret e ruajtura brez pas brezi, ndërsa forcat armike përdorën që nga minahedhësi 82 mm, automatikë, snajper, autoblinda e deri te tankset dhe që në shkallë të gjërë i kishin rrethuar Puset e Nikës. Pra, beteja 2 e 3 marsit shikuar nga raporti i forcave, ishin të pamatëshme.

Pika e fortë e UÇK-së ishte se ata bënin luftë çlirimtare dhe jo pushtuese, ushtarët njihnin terenin sepse ishin në tokë të tyre e në anën tjetër, Kodra e Puseve të Nikës ishte një vend strategjik dhe këmbësoria armike e kishte vështirë të depërtonte në thellësi të zonës, siç provuan më 26 shkurt të vitit 1999. Një anë tjetër e fortë e kësaj lufte, ishte se, lufta e UÇK-së mbështetej nga rrethet e gjëra të popullit, ku edhe ata që s`mundën të merrnin pjesë fizikisht, fryma dhe shpirti i tyre popullor ishte në mesin e ushtarëve.

Beteja e 2 e 3 marsit të vitit 1999, na ka mësuar se armiku të ka në dorë vetëm aq sa e lejon ti vet dhe çdo populli që synon lirinë, herët a vonë ai edhe e arrinë atë. Megjithatë për të arritur deri te liria, duhet kaluar rrugëve të rrëpirta, rrugëve të gjakosura me gjakun e bijëve më të mirë dhe në këtë betejë të madhe, ballë për ballë me armikun, ranë për t`mos vdekur kurrë Nuri Bushi e Xhemsedin Suma.

Nuri Bushi e Xhemsedin Suma ranë në lulen e rinisë, ranë (siç thot populli) në më të mirën kohë, ranë në moshën 33 vjeçare. Por edhe rënia e tyre kishte një mesazh ringritës, kishte një mesazh mobilizues. Pas rënies së tyre, Nuri Bushi u varros me nderime ushtarake në Puset e Nikës, në pjesëmarrje të shokëve të tij bashkëluftëtarë dhe fjalën lamtumirëse për dëshmorin e rënë e mbajti zv.komandanti i Brigadës Mehmet Ballazhi, ndërsa Xhemsedin Suma, pasi serbët ia morën edhe trupin e tij të pajetë,

varroset në Ferizaj, dhe në varrimin e dëshmorit Xhemsedin Sumës morën pjesë me mijëra vetë, jo vetëm të Ferizajt, por edhe të anëve të tjera.

Po cilat ishin pikat e përbashkëta të dëshmorëve Nuri Bushi e Xhemsedin Suma?

Që të dy ishin nga treva e Hanit të Elezit, ishin të një moshe, ishin të një gjenerate shkollore, që të dy kishin kryer shkollën e mesme. Pas vitit 1990 që të dy punonin në Itali dhe ishin aktivistë të dalluar të Shoqatës ,,Iliria'' e cila me kontributet e saja ndihmonte mbijetesën në Kosovë. Që të dy rrjedhnin nga familje kombëtare, Nuri Bushi ishte kusheriri i heroit të Kosovës Ismail Raka i cili u mbyt në torturë nga policia serbe më 29 nëntor 1994, ndërsa Xhemsedin Suma ishte i vëllau i Rufki Sumës, i cili ishte komandant i Brigadës 164,,Gafurr Loku'' të UÇK-së. Që të dy në hierarkinë ushtarake ishin komandant togu dhe me sukses udhëhiqnin ushtarët në betejë, që të dy ishin të martuar dhe kishin fëmijë dhe ndërmjet dashurisë familjare dhe lirisë së Kosovës, ata zgjodhën këtë të dytën, pra lirinë e Kosovës. Në luftë për liri ranë brenda pak orëve; Nuriu me 2 mars , ndërsa Xhema me 3 mars, që të dy ranë nën emblemën e UÇK-së dhe nën kushtrimin liridashës: Marsi sjell pranverën, ndërsa pushka sjell lirinë.
Beteja e 2 e 3 marsit, 20 vite më vonë, kujtohet si një ngjarje e madhe me vlera të rralla historike dhe te gjeneratat e reja ruhet si një trashëgimi e brezave për liri. Sa herë që do të vie marsi dhe saherë që do të përmenden këto data, do të na kujtohen dëshmorët Xhemsedin Suma e Nuri Bushi dhe me këto vlera do të mbesin në kujtesën tonë popullore dhe si të tillë do t`ia përcjellim edhe historisë. Po në këtë datë, krahas rënies së Nuri Bushit e Xhemsedin Sumës, kemi edhe ushtarë të tjerë të plagosur rëndë, si Murat Lokun e Mehmet Lubishtanin si dhe zënien rab të ushtarit më të ri të Brigadës, Suad Brava, i cili do të pushkatohet në burgun e Dubravës më 22 maj 1999.
Vendet se ku ranë Xhemsedin Suma e Nuri Bushi, tanimë janë shndërruar në vende altari, i pari ra ,,Te antena'' sikur Hektori që mbronte Trojen e tij të dashur, ndërsa i dyti, Nuriu, ra në Kodër të Faslisë dhe vendi i rënies së tij na e kujton shqiponjën dhe luftën e saj me gjarpërinjë.
Emrat e dëshmorëve Nuri Bushi e Xhemsedin Suma, tanimë janë trashëguar në familjet e tyre. Vajza e Nuri Bushit (Nurija) e mori emrin e babait të saj, pasiqë kur i ra babai dëshmorë, ajo ende nuk ishte e lindur.
Rënia e dëshmorëve Nuri Bushi dhe Xhemsedin Suma, përkundër dhembjes së madhe, tek ushtarët e UÇK-së, solli mobilizim të ri, solli një

moral edhe më të madhë, solli një organizim edhe më të fuqishëm. Në Kodrën e Puseve të Nikës u hapën istikame të thella e të gjata dhe u ndërtuan shumë bunker nëntokësor, me të vetmin qëllim, jo vetëm për t`i bërë ballë luftës, por edhe për ta fituar atë. Numri i ushtarëve u rrit në masë Brigade dhe një pjesë e Brigadës veproi edhe në anën tjetër të lumit, pra në fshatin Gjergjedell me komandant Emrush Sumën duke korrur suksese ushtarake edhe andej lumit.
Betejat tjera që u zhvilluan nga Brigada 164,, Gafurr Loku'' e UÇK-së deri më 11 qershor 1999, të gjitha ishin të suksesshme dhe secila ka rëndësinë e saj historike, por kësaj radhe shkëputëm për trajtim vetëm betejën e 2 e 3 marsit, pasiqë na ndërlidhin me rënien heroike të Xhemës dhe Nurisë.
Marrë në tërësi, lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në trevën e Hanit të Elezit ishte plotësisht e suksesshme dhe rruga e sajë e lavdisë, solli edhe çlirimin e kësaj komune më 11 qershor 1999, ndërsa dëshmorët e kësaj komune, përgjithmonë mbetën floriri ynë kombëtarë.
I përjetshëm qoftë kujtimi për dëshmorët Nuri Bushi e Xhemsedin Suma!
Lavdi dëshmorëve të kombit!

Imer Vila (1958 – 1999)

Imeri në Drenushë,
Tokën bëri kuq
Mos e ndalni rrugën
Të nderuar krushq.
Pushkën shtizë flamuri,

Shqiponjën n' fluturim
S'ka si Kosova,
S'ka si atdheu im.

Dëshmori Imer Vila u lind më 7 prill 1958 në fshatin Paldenicë të komunës së Hanit të Elezit. U lind në Lagjen e Demzenëve të këtij fshati, por tri vite pas lindjes së tij, familja e Imerit shpërngulen në Shkup dhe jetojnë deri në vitin 1963. Në të njejtin vit nga Shkupi, përsëri shpërngulen në Han të Elezit dhe jetojnë për 18 vite me radhë në një shtëpi afër hyrjes kryesore të fabrikës së çimentos. Në vitin 1975 përsëri kalojnë në një truall të ri, përkatësisht në Lagjen e Ujit të Thartë të Hanit të Elezit ku edhe sot e kësaj dite jetojnë familja e tij.

Babai Fasliu dhe nëna Miradie, në jetën e tyre martesore patën pesë fëmijë: Arifin, Rexhepin, Hanifen, Imerin dhe Kadiren. Imeri ishte fëmiu i katërt i familjes dhe shkollën fillore e kreu në Han të Elezit, ndërsa të mesmen, drejtimin teknik, në Kaçanik dhe gjatë jetës së tij nuk arriti të punësohet kurrë.

Duke pasur për bazë fizikun dhe talentin për sportin, sidomos ate të futbollit, dëshmori Imer Vila jep kontributin e tij pranë Klubit Futbollistik „Sharri'' në Han të Elezit, klub i cili garonte në ligën përkatëse të Kosovës. Imer Vila nën dresat e K.F.„Sharri'' garon nga viti 1985, deri në vitin 1987 dhe ishte lojtar i dalluar.

Duke evokuar për aktivitetin sportiv të dëshmorit pranë këtij klubi, trajneri Faruk Daci thotë se „Imeri ishte një sportist i dalluar, gjithmonë detyrat e dhëna i kryente me pedantëri, kishte një angazhim të pashoq në klub, ndërsa specifika e lojës së tij ka qenë vrapimi me top dhe pa top si dhe ka pasur një qendrueshmëri të pashterrshme. Respektonte trajnerin, referët dhe rregullat e futbollit. Ai në klubin „Sharri'' ka luajtur mbi dy vite''.

Si shumica dërmuese e shqiptarëve edhe dëshmori Imer Vila rrjedhte nga një familje e varfër, por me tradita të bujarisë shqiptare dhe kryedëshira e tij ishte që populli shqiptarë të jetoj i i lirë në trojet e tij etnike. Në rrjedhë të këtyre bindjeve dëshmori Imer Vila mori pjesë pothuajse në të gjitha protestat popullore kundër dhunës serbe, të cilat gjatë vitit 1998 organizoheshin edhe në Han të Elezit.

Vrasja e Gafurr Lokut më 21 shkurt të vitit 1999 në fshatin Paldenicë, nga një atentat i organizuar nga pushtuesi serb, indinjoi thellë popullin shqiptarë të kësaj treve dhe shihej qartë që edhe kësaj ane lufta do të fillonte, gjë e cila ndodhi më 26 shkurt 1999. Vrasja e Gafurr Lokut dhe djalit të tij Dritonit si dhe krismat e para çlirimtare në Puset e Nikës e në

anën tjetër koncentrimi i madh i forcave serbe në Han të Elezit dhe përgjatë vijës kufitare dhe gjatë aksit rrugor në drejtim të Grykës së Kaçanikut, bënë që Imer Vila bashkë me familjen e tij të ngushtë të lëshon shtëpinë në Lagjen e Ujit të Thartë të Hanit të Elezit dhe të vendoset në Kaçanik të Vjetër ku atje edhe kishte miqtë e tij. Ai vendoset te Milazim e Bejtullah Krasniqi të cilët që më herët ishin të rreshtuar në radhët e UÇK-së pranë Brigadës 162 „Agim Bajrami''.Gjatë kësaj kohe Imeri jep një angazhim të veçantë në ndihmë popullatës civile, ku në këtë fshat kishin ardhur nga anët e ndryshme e në anën tjetër përqëndrimi i forcave policoro-ushtarake serbe në fshatrat për rreth si dhe aktet gjenocidale të „Dorës së Zezë'' serbe, e cila në këtë fshat kishte edhe një nga bazat e saja, bënë që Komanda e Brigadës 162, në Kaçanik të Vjetër të vendos ushtarët e Batalionit të II – të, përkatësisht Kompaninë e Parë me të vetëmin qëllim mbrojtjen e popullatës civile. Në këto zhvillime dramatike dëshmori Imer Vila i bashkangjitet radhëve të UÇK-së ku edhe merr detyra konkrete pranë Skuadrës së parë, të cilës i printe eprori Naim Topojani. Gjatë kësaj faze Imer Vila bashkëpunon me ushtarët Besim Ilazi, Milazim Krasniqi, Bejtulla Krasniqi, Kemajl Krasniqi, Driton Krasniqi, Qazim Topojani, Bajram Bajselmanaj, etj.dhe çdo detyrë që merrte nga eprorët e tij e kryente me përgjegjësi.Gjatë kësaj kohe skuadrat mbrojtëse të kësaj Kompanie në mbrojtjen e popullatës civile ka funksionuar 24 orë ku edhe kanë ekzistuar pikat statike, dëshmon bashkëluftëtari i Imerit, Milazim Krasniqi.

Brigada 164 „Gafurr Loku'' e UÇK-së në Han të Elezit kishte arritur një mobilizim të theksuar dhe ushtarët e kësaj Brigade kishin arritur të shtriheshin në dy anët e lumit Lepenc; në Puset e Nikës dhe në fshatin Gjurgjedell. Në këto rrjedha, dëshmori Imer Vila shprehu dëshirën që të kalon në zonën luftarake të Gjurgjedellit pasiqë terrenin e fushëbetejave të këtyre anëve e njihte më mirë. Ai nga Kaçaniku i Vjetër tenton të kaloj në Gjurgjedell dhe derisa kalonte malet e Drenushës, papritmas has në një njësi plicoro-ushtarake serbe dhe pas një rezistence të fuqishme të Imerit, ai vritet më 8 prill 1999 në moshën 41 vjeçare.

Se në çfarë shkalle forcat serbe kishin rrethuar forcat e UÇK-së, përkatësisht pjesën juogore të Kaçanikut, atë ditë kur u vra Imer Vila, më së miri flet një informacion zyrtar nga Komandanti i Brigadës 162„Agim Bajrami'' për Shtabin e Përgjithshëm të UÇK-së.

„ Në Han të Elezit gjendet komanda e forcave të armikut, ku edhe bëjnë vëzhgimin në relacionin Dimcë – Neçavc –Dërmjak - Bilak i Vogël deri në Kërbliq. Në Dërmjak, janë afro 100 policë serbë. Mbi Beljanët e

Gjurgjedellit janë afro 100 forca serbe dhe tri tanke. Për rreth magjistrales Hani i Elezit - Kaçanik, duke filluar nga Uji i Thartë deri në Kashan janë njësitë tankiste në përbërje prej 23 tankseve dhe mbi 100 policë. Në Kërbliq te shkolla e fshatit janë pozicionuar 20 tankse dhe 200 policë e ushtarë, ndërsa baza e logjistikës për forcat serbe gjendet në Kashan [41], thuhej ndër të tjera në informacionin e Komandantit të Brigadës 162.

Ndërsa Shërbimi për informim i Zonës Operative të Nerodimes rreth luftimeve të këtyre ditëve në Kaçanik me rrethinë njofton se ,, Sukseset e UÇK-së në Zonën Operative të Nerodimes janë të parreshtura.Vetëm gjatë këtyre ditëve të fundit, armikut iu shkaktuan humbje të mëdha. Në Kaçanik, armikut i është shkatërruar një ,,Pizgauer'' me plotë ushtarë…[42]

Familja jonë, rrëfente vëllau i dëshmorit, Arifi, në fillim të marsit të atij viti u dëbua me dhunë për në Shkup dhe derisa isha atje nga Agjencia e Lajmeve ,,Kosovapress'' dëgjova se në Drenushë të Kaçanikut është vrarë, përkatësisht masakruar Rexhep Teneqja dhe një ushtar tjetër tani për tani i panjohur. Kur e dëgjova këtë lajm më theri zemra, sikur ta dija se i panjohuri do të ishte vëllau im Imeri. Gjatë kohës sa qëndruam në Shkup përkundër informatave të ndryshme, nuk arritëm që me saktësi të kuptonim për vrasjen e Imerit. Betejat që zhvilloheshin nëpër frontet e luftës në Kosovë nuk na e mundësuan një gjë të tillë, kujton ai.

Me përfundimin e luftës dhe me kthimin e familjes së Imerit në Han të Elezit, kuptojnë me saktësi vrasjen e dëshmorit dhe me ndihmën e ushtarëve të Brigadës 162,,Agim Bajrami'' të UÇK-së, në Qafë të Drenushës e gjejnë kufomën e dëshmorit Imer Vila ku sipas dëshmisë së vëllaut të tij Arifit, Imeri përpos vrasjes ka qenë edhe i masakruar, nuk i ka pasur dy krahët e tij, ndërsa Rexhep Teneqës i ishte prerë koka,ndërsa trupat e tyre kanë pasur edhe shenja të djegies.Trupin e pajetë të dëshmorit Imer Vila e varrosëm në vendin e vrasjes, pra në Qafë të Drenushës më 22 qershor 1999 e më pas me kërkesën tonë pranë

Brigadës 162,,Agim Bajrami'' në Kaçanik, bënë zhvarrimin e tij dhe e rivarrosëm me nderime ushtarake më 29 gusht 1999 në varrezat e dëshmorëve në Puset e Nikës, thotë Arif Vila, duke shtuar se pas vete Imeri ka lënë gruan Fikrijen me fëmijët Nurhanin, Burhanin, Sametin dhe Severgjanin, ndërsa në shenjë nderimi për kontributin kombëtar, Qeveria e Përkohshme e Kosovës, SHP i UÇK-së dhe Zona e VI e TMK-së, Kuvendi

[41] Hajrush Kurtaj ,,Shungullon Gryka e Kaçanikut" fq.286
[42] Ruzhdi Jashari ,,Zëri i lirisë'' fq.121

komunal dëshmorin Imer Vila e ka nderuar me mirënjohje. Një rrugë në Han të Elezit mban emrin e tij. Me vendim presidencial është shpallur Hero i Kosovës.
Në 20 vjetorin e rënies u mbajt një Akademi e përbashkët për dëshmorët: Imer Vila, Imri Curri, Abush Loku, Zekirija Dardhishta. Akademia u mbajt në Han të Elezit.

Faksimile nga shkrimet e autorit Shaban Çupi në të përditshmet kosovare për dëshmorët dhe luftën epope të UÇK-së

Familjet e dëshmorëve ne Ditën e më të dashurve të tyre.
Fotografi e vitit 2006

Imri Curri (1971 – 1999)

Pushkët për Koshare
Liridonët gjerdan
O sot, o kurrë
Së bashku për vatan.
Të copëtojmë kufirin
Që e gurëzoi i huaji
Kosova e Shqipëria
Si buka, si uji.

Treva e Hanit të Elezit, luftës për çlirimin e Kosovës ju është përgjigjur në mënyrë aktive, madje kësaj lufte të rëndë e të lavdishme iu përgjigj me Brigadën 164 të UÇK-së e cila nëpër flakët e luftës mori emrin e dëshmorit dhe veprimtarit të paepur të etnikut shqiptar Gafurr Loku. Kjo Brigadë, jo vetëm që veproi dhe dha dëshmorë në Puset e Nikës, por ushtarët e kësaj Brigade morën pjesë edhe në luftime të tjera si në Jezerc, Bllacë të Therandës, Malishevë e Rahovec për të dhënë dëshmorë edhe në Pashtrik e Koshare.

Dëshmori Imri Curri u lind në vitin 1971 në Han të Elezit. Shkollën fillore e kreu në qytetin e lindjes , ndërsa të mesmen në Kaçanik. Pas përfundimit të shkollës së mesme, ai do të punoj në NT,,Besa'' në Han të Elezit duke i ndihmuar familjes së tij, por krismat e pushkëve të lirisë në Drenicë e gjetkë, kishin ngacmuar edhe shpirtin e Imriut çlirimtar i cili ëndërronte uniformën e shenjtë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ushtri e

cila kishte marrë guximin që me armë t`i përgjigjej pushtuesit shumëfish më të madh dhe pakrahasimisht më i sofistikuar.

Dhuna e vazhdueshme që ushtrohej mbi popullin shqiptar nga pushtuesi serb, betejat e zhvilluara të UÇK-së gjatë vitit 1998 dhe pritja e pranverës së përgjakshme e vitit 1999, bënë që Imri Curri fillimisht të kontaktoj me pronarin e N.T,,Besa'', të cilit ia shfaqë qëndrimin e tij se ai do të kyçet në radhët e UÇK-së, por me një kërkesë ndaj pronarit, që në vendin e tij të punës t`ia punësoj vëllaun Ylberin pasiqë askend nuk kishte në marrëdhënie pune. Pronari i ,,Besës'' ia plotësoi dëshirën Imriut, duke i mbetur besnik deri në vdekjen e Ylberit nga kanceri në vitin 2011.

Ne, thotë Bafti Hasallari, bashkëluftëtar me Imriun, dëshironim që t`i bashkangjiteshim UÇK-së, andaj me 18 janar 1999, bashkë me Imri Currin, Nazmi Kalisin e Halit Lurin kalojmë ilegalisht kufirin dhe dalim në Maqedoni ku me ndihmën e veprimtarëve bardhjan kalojmë në Shkup për të kaluar të nesërmen në Dibër ku edhe arrijmë të futemi në Shqipëri. Në Tiranë, vazhdon Baftiu, takohemi me Jahush Shkretën i cili na kontaktoi me Mehmet Ballazhin zv.komandant i Brigadës 164, përgjegjës për stërvitjen dhe mobilizimin e luftëtarëve të kësaj treve si dhe Zekirija Shkretën, Mendu Bravën, Xhemil Bravën e disa të tjerë. Të nesërmen u nisem për në Vlanë, ku atje takohemi me ushtarë të tjerë nga treva jonë si Mehmedali Ballazhin, Avni Shitin, Vebi Micin, dhe siç rrëfen më tej ai, atje i gjetëm të mërzitur për rënien e shokëve me 14 dhjetor në Pashtrik e në mesin e tyre dëshmori Veli Ballazhi po nga Hani i Elezit.

Rreth datës 22 janar, Imri Curri rreshtohet në radhët e UÇK-së, duke u pajisur me uniformën e shumëdëshiruar. Fillimisht si ushtar i ri bënte roje, duke zbatuar në përpikmëri urdhërat e eprorëve, ku pas pak ditësh në këtë qendër stërvitore numri i ushtarëve të Hanit të Elezit arrin në 50, ndërsa në anën tjetër në pikën luftarake të Puseve të Nikës radhët shtoheshin çdo ditë e sidomos gjatë kësaj periudhe rëndësi më të madhe iu dha furnizimit me armë dhe municion luftarak.

Një grup ushtarësh nga Hani i Elezit si Burim Vila, Ramadan S.Vila, Sead Vila, Omer Dernjani e Ramush Curri deklarojnë se radhëve të UÇK-së u bashkangjitemi që atë ditë kur varrosëm dëshmorin Gafurr Loku me djalin e tij. Menjëherë kaluam në Shkup ku takuam Xhezair Shaqirin (komandant Hoxha) dhe disa të tjerë për të marrë informacione për lidhje me vijat e luftës. Në Tiranë na priti Harun Aliu (komandant Kushtrimi)[43]dhe pas dy dite takohemi edhe me Zekri Dardhishtën,

[43] Harun Aliu nga fshati Harqinë i Shkupit i ekzekutuar nga forcat speciale maqedonase ,,Alfa" në fshatin Radushë të Shkupit më 12 maj 2010

gjithashtu dëshmorë rënë në Koshare, ndërsa më datën 2.3.1999 jemi nisur nga Tirana për në Vlanë. Në shtabin e UÇK-së në Vlanë, ku stërviteshin ushtarët e rinj, takuam komandant Bacin (Mehmet Ballazhin) me ushtarë të tjerë nga treva e Hanit të Elezit. Pas një stërvitje ushtarake një javore, më 9.3.1999 na transferojnë në Kalimash ku takohem edhe me ushtarë të tjerë nga Hani i Elezit të cilëve u printe Zekirija Shkreta e në mesin e këtyre ushtarëve gjetëm dëshmorin Imri Currin. Nga 9 marsi deri më 30 mars 1999 jemi stërvitur nga oficerët e Shqipërisë dhe në atë repart kishte edhe luftëtarë nga të gjitha trevat shqiptare. Pas ushtrimeve tri javore na kanë dërguar afër kufirit me Kosovën, pikërisht në Babinë dhe Papaj. Në Papaj mësuam se do të nisemi për në Koshare gjë e cila edhe ndodhi më 9 prill 1999. Sulmi i parë është bërë me artileri, pikërisht me top 75 mm në drejtim të kazermës ku ishin forcat serbe dhe gjatë 36 orëve luftime të pandërprera arritëm që ta marrim nën kontroll kazermën dhe nga ana e armikut kishte humbje të mëdha. Gjatë këtyre luftimeve të pandërprera, vritet Abush Loku nga fshati Kotlinë. Më 11.4.1999 vritet komandanti dhe strategu i UÇK-së Agim Ramadani dhe pas rënies, Brigada 138 mori emrin e tij, kujtojnë grupi i ushtarëve nga Hani i Elezit.

Imri Curri e dinte se vendlindja e tij mbrohej edhe në Koshare, sepse kur të theheshin forcat serbe në kufi, vetvetiu do të shpartalloheshin edhe në Han të Elezit, Kaçanik e gjetiu. Ai nuk do të kursej asgjë nga mundi i tij që ky kufi i padrejtë, që pushtuesi vendosi në mes të shqiptarëve, të shkatërrohej. Nëpër këto beteja, pjesëtarët e UÇK-së arrijnë që të marrin karakollin ushtarak serb te Rrasa e Zogut dhe për 7 ditë me radhë arrijnë që edhe më tepër të zgjerojnë ate. Forcat serbe për të rikthyer territorin e humbur, më 17 prill 1999, ndërmarrin një ofenzivë të fuqishme dhe në këto luftime ballë për ballë me armikun vritet, për të mbetur i pavdekshëm edhe dëshmori Imri Curri.

Ne, thotë Zekirija Shkreta, ishim të vendosur në thyerjen e kufirit, andaj në këtë pjesë të luftës, krahas luftimeve që bëheshin në Puset e Nikës, në Koshare merrnim pjesë shumë ushtarë nga treva e Hanit të Elezit dhe me 9 prill 1999 në thyemje të kufirit në Koshare bie heroikisht Abush Loku[44] nga fshati Kotlinë i Kaçanikut ku edhe pse i plagosur, luftën e ka

[44] Jashar Kalisi nga fshatin Seqishtë, bashkëluftëtarë me Abush Lokun, deklaron se me Abushin është takuar në luftën e Koshares dhe se ai ishte një luftëtar shumë guximtar.Ka kryer kursin për tenkist dhe ka qenë një njësitin këmbësorik të eprorit Isen Berisha. Me 9 prill 1999 ishte tejet aktiv në thyerjen e kufirit në Koshare dhe gjithnjë kërkonte hakmarrje për maskrën në fshatin e tij të lindjes të 24 marsit 1999. Gjatë luftimeve me

vazhduar me tërë fuqinë e tij, derisa vritet nga snajperistët serb. Me 17 prill, vazhdon më tej Zekirija Shkreta, forcat serbe tentojnë të ripushtojnë territoret që i çliruam, andaj ne ushtarët nga Hani i Elezit dhe të viseve tjera kishim për detyrë të mbronim kazermën në Rrasën e Zogut, andaj në këtë luftë të lavdishme bien dëshmorë Imri Curri nga Hani i Elezit dhe Zekri Dardhishta nga Kërbliqi i Kaçanikut, me vendbanim të përhershëm në Shkup. Krahas vrasjes së dëshmorit Imri Curri, Abush Lokut dhe Zekri Dardhishtës, në këtë betejë plagoset rëndë edhe Bafti Hasallari, tani invalid lufte, si dhe Sadik Brava, të cilët fillimisht dërgohen në spitalin e qytetit të Bajram Currit për t`i përcjellur mëpastaj në ate të Tiranës.

Pas marrjes së Rrasës së Zogut, kujton Sadik Brava, bashkëluftëtarë i Imri Currit, duhej që ta mbronim me çdo kusht, por në anën tjetër edhe forcat serbe tentuan që ta rimarrin përsëri. Togut tonë në përbërje të Zekirija Shkretës, Sadik Bravës, Imri Currit, Bafti Hasallarit, Zekri Dardhishtës, Nexhmedin Fidës, Burim Vilës, Sead Vilës, etj na urdhërohet që t`i dalim në ndihmë togut tjetër që ruante Rrasën e Zogut pasiqë po sulmoheshin prej serbëve. Ne, vazhdon Sadik Brava, kemi tentuar që nga ana e majtë t`iu depërtojmë forcave serbe në brendi, përkatësisht pas shpine dhe këtu zhvillohet një betejë e përgjakshme. Që në sulmin e parë plagoset rëndë Bafti Hasallari, të cilin duke e tërhequr për ndihmë edhe vet plagosem në këmbën e majtë. Në të njejtën kohë me një plumb në ballë bie dëshmor Zekri Dardhishta dhe Zekirijau nga Prishtina, ndërsa në anën tjetër nga Burim Vila lajmërohem se u vra Imri Curri. Më poshtë gjetëm të plagosur komandantin Skender Hasangjekën të cilin e tërheqim në një vend më të sigurtë dhe lajmërojmë kamandën për ndihmë të mëtejme, kujton ushtari Sadik Brava duke shtuar se në ndihmë njësisë për të mbrojtur Rrasën e Zogut vijnë edhe luftëtarë të tjerë nga njësiti i Shtimes në krye me komandant Luanin dhe përkundër të rënëve dhe të plagosurve që patëm, forcat serbe nuk mundën që ta rimarrin Rrasën e Zogut të cilën e kishim çliruar me 9 prill 1999.

Mua, thotë Bafti Hasallari, më kanë tërhequr Sead Vila nga Hani i Elezit dhe Selajdini nga Shtimja dhe më kanë bartur për katër orë rresht të plagosur deri në bazën tonë në Shqipëri. Për rënien e Imriut dhe shokëve kam kuptuar në spital, gjatë vizitës që më bënë bashkëluftëtarët nga Hani i Elezit, Nexhmedin Fida, Zekiria Shkreta e Hiriman Kuka[45].

---

serbët Abushi luftonte me pushkomitralez. Pas shumë orë luftime, vritet me 9 prill 1999 në Koshare.

[45] Emrush Dernjani ,,Hani i Elezit me rrethinë" fq.197

Sead Vila nga Hani i Elezit, duke kujtuar veprën e dëshmorit Imri Curri thotë se: Për Imriun kam kujtime mbreslënëse. Kam momente dhe çaste që i kujtoj dhe do t`i kujtoj gjatë tërë jetës sime. Prej momentit të parë që jemi takuar në Kalimash si ushtarë të UÇK-së e deri në momentin e fundit të jetës së tij që bie heroikisht tek Rrasa e Zogut në Koshare, Imri Currin e karakterizonin ngrohtësia shoqërore, karakteri, sjellja, morali i fortë dhe gjithmonë na motivonte për qëndresë,thotë ai.

Lajmin për rënien e Imriut në Koshare, familja e tij e mori në lagjen Dyzhon të Shkupit. Në këtë lagje, familja e tij hapi të pamen për dëshmorin, kujton Jetullah Curri, kusheri i dëshmorit duke shtuar se për të ngushëlluar familjen, vinin kolona të gjata njerëzish dhe dhembja ishte gjithkombëtare. Para të pranishmëve, vëllau i dëshmorit, Hazbiu edhe pse i mërzitur, me plot krenari u thoshte të pranishmëve se,, Imriu ra heroikisht në mbrojtje të atdheut, e ku ka më lumturi kur njeriu vdes për atdhe“

Pas përfundimit të luftës, varrin e dëshmorit Imri Currit, e kërkuam në varrezat e qytetit të Bajram Currit, thotë Zekirija Shkreta, por ai kishte qenë në varrezat e vjetra të këtij qyteti dhe zhvarrimin e tij e ka bërë komanda e Brigadës së Pashtrikut.

Rivarrimi i dëshmorit Imri Curri bëhet me nderime ushtarake dhe varroset, krahas dëshmorëve të tjerë, në varrezat e dëshmorëve në Puset e Nikës të Hanit të Elezit më 29 gusht 1999, ku popullata e kësaj ane më pas ngriti një lapidar të mrekullueshëm si dëshmi për histori.

Dëshmori Imri Curri gjatë jetës së tij të shkurtër nuk arriti që të martohet. Ai u martua me lirinë e atdheut dhe si askund tjetër, përshtatshmëria e këngës së moçme e të përvuajtshme shqiptare zë vendin këtu:

Në vetë nana gja për mue,
thujni nanës se jam martue,
e në vet nana ç`nuse mori ,
dy plumba në mes krahrorit

Pas lufte, për dëshmorin Imri Curri , Qeveria e Përkohshme e Kosovës dhe SHP i UÇK-së ka ndarë mirënjohje. Mirënjohjet për kontributin e tij kombëtar nuk kanë munguar as nga Zona e VI TMK-së as nga Kuvendi komunal si dhe nga Batalioni 36 i xhenios i cili pas lufte ka vepruar në kazermën ,,Gafurr Loku‘‘ të TMK-së.. Në përvjetorin e rënies së tij, në shtypin ditor ka pasur shkrime për jetën dhe veprën kombëtare të dëshmorit, ndërsa nga rapsodët e kësaj treve janë thurur këngë. Më 20 korrik të vitit 2010, Kuvendi Komunal mori vendim që shtëpia e kulturës në Han të Elezit të bartë emrin e tij, ndërsa për familjen e dëshmorit,

Kuvendi komunal në bashkëpunim me komunitetin ngritën një shtëpi. Me vendim presidencial është shpallur Hero i Kosovës.

Djathas: Dëshmori Imri Curri, Koshare

Rreshti i parë nga e djathta; i pari dëshmori Imri Curri me bashkëluftëtarët nga Hani i Elezit në Kalimash.

Komandanti i Brigadës 164,,Gafurr Loku'' të UÇK-së, Rufki Suma dhe kryetari i Shoqatës së Familjeve të Dëshmorëve Xhavit Jashari, gjatë momentit të përurimit të emërtimit të Shtëpisë së Kulturës me emrin e dëshmorit Imri Curri

Në nderim të dëshmorit në 20 vjetorin e rënies, 2019

Në njëzet vjetorin e rënies së dëshmorëve, pra në vitin 2019, krahas nderimit që iu bë me manifestime të veçanta, u organizuan edhe

manifestime të përbashkëta ndërmjet komunës së Kaçanikut dhe Hanit të Elezit. Në shtëpinë e kulturës në Han të Elezit u mbajtën dy akademi të tilla.

Në Akademinë e parë u nderuan dëshmorët: Imer Vila, Imri Curri, Abush Loku dhe Zekirija Dardhishta

Ndërsa në Akademinë e dytë u nderuan dëshmorët që ranë në burgun e Dubravës në majin e vitit 1999:

Suad Brava, Gafurr Luma, Mejdi Dalloshi, Tefik Raka e Danush Kurtaj

---

Fjalë rasti nga Mehmet Ballazhi më 8 prill 2019, në 20 vjetorin e rënies së dëshmorëve: Imer Vila, Abush Loku, Imri Curri e Zekri Dardhishta!

Eprorë dhe vateranë të UÇK-së!

Pjesëmarrës të nderuar!

Duke u bazuar në muajtë se kur ranë dëshmorët për liri, dhjetori i takon dëshmorit Veli Ballazhi, muaji shkurti Gafurr e Driton Lokut. Marsi I pranverës u takon Xhemsedin Sumës e Nuri Bushit, kurse muaji prill u takon dëshmorëve Imri Curri, Imer vila, Abush Loku e Zekri Dardhishtës, andaj nderimi dhe respekti u takon këtyre trimave që ranë për lirinë dhe çlirimin e Kosovës.

Duke u bazuar në datat se kur ranë dëshmorët, nga të katër dëshmorët të cilët jemi mbledhur t`i nderojmë ne sot, i pari është Imer Vila nga Lagjja e Ujit të Thartë nga Hani i Elezit, i cili ka rënë në fushëbetejë në Drenushë të Kaçanikut më 8 prill 1999.

I dyti nga radha është dëshmori Abush Loku, nga fshati Kotlinë i Kaçanikut dhe ka rënë dëshmor në Koshare më 9 prill 1999.

I treti është Zekri Dardhishta, me prej ardhje nga Kërbliqi i Kaçanikut, por me vendbanim në Shkup dhe dëshmor ka rënë në Koshare më 16 prill 1999

I katërti është Imri Curri nga Hani i Elezit dhe ka rënë dëshmor në Koshare më 17 prill 1999.

Pra nga katër dëshmorët që po i nderojmë sot, vetëm Imer Vila ka ra në rrethinën tonë, ndërsa tre të tjerët në thyerjen e kufirit në Koshare, kufi i cili kishte ndarë më së keqi hapsirën shqiptare, një kufi i kobshëm dhe i

padrejtë i cili kishte lënë plagë të mëdha për 100 vite me radhë.Dhe dëshmorët e dinin se ky kufi, si i padrejtë që ishte, duhej të thehej.

Operacioni ,,Shigjeta'' i hartuar nga Shtabi i Përgjthshëm i UÇK-së ishte një ndër operacionet më të rëndësishme të luftës. Ky operacion luftarak ishte i paraparë për thyerjen e kufirit shqiptaro-shqiptar dhe ishte tejet i domosdoshëm të bëhej thyerja e këtij kufiri dhe të fillonte dorëzimi i forcave ushtarake dhe paramilitare serbe.

Dëshmorët për t`iu bashkangjithur luftës së Kosovës, për në Koshare u nisën nga drejtime të ndryshme dhe pasi arrijnë në Tiranë, nisen për në vendet stërvitore në afërsi të kufirit. Pas disa javë të ushtrimeve, ushtarët nën komandën e Brigadës 163,,Agim Ramadani'' nisen në drejtim të luftës dhe nga sulmet e rrëfeshme të UÇK-së më 9 prill bie karakolli serb në Rrasë të Zogut. Këtu fillojnë edhe ato betejat e përgjakshme ndërmjet UÇK-së dhe forcave pushtuese serbe ku edhe zgjasin deri në përfundim të luftës dhe në altarin e lirisë nga kjo Brigadë ranë 114 dëshmorë, e në mesin e tyre kush më herët e kush më vonë edhe dëshmorët që jemi mbledhur për t`I nderuar sot në këtë Akademi përkujtimore.

Në anën tjetër, këtu në trevën tone, zhvillohej luftë e rëndë. E gjithë treva nga komuna e Kaçanikut duke përfshirë edhe Hanin e Elezit ishin në flake luftë, ndërsa popullata civile që ende kishte mbetur Brenda zonave inënshrohej një terrori gjenocidal. Këto valë lufte dëshmorin Imer Vila e bartin edhe në Kaçanik të Vjetër, atje ku ishin edhe miqtë e tij dhe atje i bashkëngjitet edhe radhëve të luftës Çlirimtare.

Pavarësisht se prej nga vinin dëshmorët tanë, ata kishin një synim, ata kishin një qëllim e qëllimi i tyre ishte Liria e cila iu kishte munguar gjatë.Kjo liri më së tepërmi i duhej Kosovës të cilën vitet 1998-1999 e kishin djegur me top e tanks. Nga kjo dhunë serbë po pësonin pleq e plaka, vajza e djem, invalidë e fëmijë. Kjo gjendje ishte tepër e rëndë dhe këtë nuk mundën ta duronin dëshmorët tanë, të cilët po i kujtojmë e nderojmë ne sot.

Brez pas brezi, dëshmorët tanë kishin mësuar për hjekat e këtij populli, ku për taksiratë kishin fqinjë të ligë e gjakatarë, saqë në çdo kohë kishin gjuajtur në shpirtin e shqiptarit.Masakrat e shumta që bënë në në këtë popull janë dëshmi e kësaj që po e themi dhe kur zullumi po këputej prej së trashi, atëherë populli gjeti shtigje, forces po I përgjigjej me force, u formua UÇK-ja.

Me formimin e UÇK-së lindi një ditë e re, lindi një shpresë e re, lindi një ideal i ri. Dhe ky ideal ishte Çlirimi. Dëshmorët tanë e kishin kuptuar thellë se liria rrënjët në gjak i ka, andaj i lan fëmijët e tyre,i lan familjet e tyre dhe u ngjizën me çlirimin e Kosovës, u ngjizën me pushkën e lirisë.

E madhe ishte ajo ditë kur Imeri, Imriu, Abushi e Zekriu veshën unifromën e UÇK-së, e madhe dhe e shenjtë ishte ajo ditë kur në sup hodhën armët e lirisë, sepse e dinin se po luftonin për tokën e tyre, për popullin e tyre, për lirinë dhe Kosovën e dashur.

Nga të gjithë shokët bashkëluftëtarë të dëshmorëve na bëhet e ditur se dëshmorët e rënë, në vazhdimësi kanë pasur një moral të lartë lufte, një qëndresë e sakrificë sublime dhe që të gjithë plumbat e pushtuesit i kishin në gjokse, sepse ata nuk dinin se çka është frika, këtë na e thonë edhe bashkëluftëtarët nga ana jonë që në këtë betejë u plagosën rëndë, si: Bafti Hasallari, Samet Dernjani e Sadik Brava.

Sot kur po i kujtojmë e nderojmë dëshmorët tanë, Kosova është në një gjendje krejtësisht tjetër,është pa pushtuesin serb. Ajo po zhvillohet në lirinë e saj, në lirinë e vet dëshmorëve tanë, mu ashtu siq ka thënë shkrimtari i madh francez Viktor Hygo,,Kur të kthehet liria, do të kthehem edhe unë ’pra do të kthehen edhe vetë dëshmorët.

Dëshmorët janë sinonim i lirisë, janë sinonim i çlirimit, ata janë themeli i shtetit, janë tharmi i bukës, janë floriri ynë. Ato janë kudo në mes nesh; Ato janë në sheshet tona, janë në lapidarët tanë, janë ne penën e shkrimtarit, janë në poezinë e studentit, janë në këngën e rapsodit, janë në rrugët e atdheut.

Nëse s’mund të fluturosh, vrapo, nëse s’mund të vraposh, ec, nëse nuk ecën, kacavjerru, por si do që të jetë, vazhdo të ecësh përpara ka thënë Martin Luter Kingu, andaj brenda kornizave të kësaj thënie lëvizëse jemi edhe ne, nëse nuk ecim, na shkelin, prandaj ne jemi të dënuar të shkojmë vetëm përpara. Në këtë ecje e kacavjerrje historike brenda një shekulli, me vështirësi jo të vogla, ne krijuam dy shtete, atë Shqipërisë dhe atë të Kosovës e dalngadal do të bëhemi një, sepse janë ligje të natyrës këto.

Kryetari i komunës z.Mehmet Ballazhi në fjalë rasti për nder të 11 qershorit- Ditës së çlirimit të komunës së Hanit të Elezit

Më 11 qershor 2022 ishte manifestimi i parë në sallën e re e cila tanimë quhet Qendra Kulturore,,Imri Curri''

Qendra Kulturore „Imri Curri'' në Han të Elezit

Suad Brava (1982 – 1999)

Dëshmori Suad Isen Brava u lind më 11 mars 1982 në Puset e Nikës të Hanit të Elezit. Babai Iseni dhe nëna Xhedije në jetën e tyre martesore kishin katër fëmijë: Emrushin, Rukijen, Suadin dhe Suaden . Dëshmori i kombit Suad Brava, ishte i treti fëmijë nga radha e fëmijëve dhe shkollën fillore e kreu në Han të Elezit, më pas regjistrohet në shkollën e mesme,,Dardania'' - drejtimi automekanik dhe arrin të përfundoj vitin e parë.

Duke kujtuar fëmijërinë e tij, nëna e dëshmorit rrëfen se Suadit si fëmijë ia patëm blerë një çifteli të cilës i biente për mrekulli dhe ende më duket se i dëgjoj tingujt e sajë, duke shtuar se para se të dilte në luftë ai qëndisi një shqiponjë, këte që po e shihni të varur në mur, dhe në pëlhurën e flamurit shkroi *Suad Brava UÇK 17 vjet* sikur ta dinte se nuk do të jetonte më shumë, kujton nëna Xhedije. Ndërsa babai i Suadit, Iseni thotë se Suadi ishte një fëmijë dinamik, ishte një djalë me trup të fuqishëm, luante futboll shumë dhe kishte një shpirt luftarak.

Me fillimin e luftës në Puset e Nikës, Suadi ishte në vitin e dytë të shkollës së mesme, por ai ndërpreu mësimet dhe iu bashkangjitë njësitit të UÇK-së në Puset e Nikës prej kah edhe rrjedhte familja e tij.

Familja e tij Brava, të gjitha shtëpitë që kishin i shndërruan në kazerma të UÇK-së, ndërsa në shërbim të luftës çlirimtare ishin gjithë anëtarët e këtyre familjeve. Familja Brava, me dhunën e pushtuesit ishte përballur që nga viti 1946, përkatësisht 1948 ku nga OZNA jugosllave u

arrestuan dhe u dënuan me dënime kapitale Islam Brava, Nazmi Brava e Rufat Brava si anëtarë të NDSH-së.

Shtëpitë- kazerma të UÇK-së në Puset e Nikës

Dëshmori Suad Brava ishte pjesëmarrës i betejës së datës 26 shkurt 1999, ku edhe shkrepën pushkët e para çlirimtare në komunën e Hanit të Elezit. Krahas kësaj beteje, Suad Brava mori pjesë edhe në betejën e datës 2 mars 1999 sepse siç deklaron nëna e dëshmorit, Suadi edhe pse i ri me shumë vullnet iu bashkangjit luftës. Gjatë kësaj ofenzive armike, njësitë e UÇK-së arrijnë t`i bëjnë ballë ushtrisë dhe policisë serbe, por gjatë kësaj ofenzive, diku ndërmjet Puseve të Nikës dhe fshatin Kotlinë, zihet rob ushtari më i ri i kësaj ane Suad Brava.

Dëshmitari i vetëm i cili kishte arritur të shihte atë ditë Suadin, pra me 2 mars 1999, është plaku Zejadin Bushi (1938) nga Puset e Nikës, i cili në një intervistë dhënë Akif Shkretës në vitin 2007 thotë se në mbrëmje derisa unë Zejadin Bushi, Sadik Bushi dhe Refik Bushi ishim duke shkuar në Puse të Nikës, përkatësisht në mahallën e Bushëve, në afërsi të shkollës fillore të fshatit, dëgjuam një zhurmë dhe ne menduam se ishin forcat e UÇK-së, por dolën se ishin forcat serbe dhe që të treve na arrestuan. Një grup tjetër i policisë dhe ushtrisë serbe vinin nga Livadhet e Dacëve dhe me sytë tanë e vërejtëm se në mesin e tyre i lidhur në këmbë e duar ishte tanimë dëshmori Suad Brava, i cili kishte qenë i gjakosur në fytyrë dhe i dërmuar në trup nga torturat që iu kishin bërë në vendin ku e kishin arrestuar si dhe gjatë rrugës.Të gjithëve na dërguan në stacionin policor të Ferizajt, shton plaku Zejadin Bushi duke vazhduar më tej në rrëfimin e tij se në SUP-in e Ferizajt, dy polic serb, Suadin e mbanin për krahësh sepse

shihej se ai ishte i torturuar shumë.Të nesërmen ne të tjerët u liruam nga arresti, ndërsa Suadi mbeti në stacionin policor të Ferizajt dhe më nuk e kemi parë, kujton dëshmitari i rastit Zejadin Bushi.

Krahas kësaj dëshmie, një detaj të rëndësishëm për dëshmorin Suad Brava, pas arrestimit të tij, e jep znj. Nekibe Kelmendi, ish Ministre e Drejtësisë,tani e ndjerë,në gazetën ditore „ Zëri ’’ të datës 22 nëntor 2006 në pyetjen e gazetarit se Bajrami kishte vendosur ta mbronte një 17 vjeçar, me datën 9 mars 1999...

Zonja Nekibe Kelmendi përgjigjet :

„Ishte luftëtarë i UÇK-së. Quhej Suad Brava nga një fshat i Hanit të Elezit. Ishte i plagosur në luftë dhe si i arrestuar qëndronte në spital. Më 19 mars e lëshuan nga spitali dhe e dërguan drejt në burg. Ishte vetëm në pizhame. Vjen Bajrami në zyret e LDK-së dhe më kërkoi para për t`i blerë veshje Suadit... i propozova të merrte rroba të Kushtrimit. Nusja e Kastriotit, Vjollca, pat përgatitur një çantë me të gjitha gjërat që i nevojiteshin Suadit dhe Bajrami diku rreth orës 13:30 ia dërgoi ato...’’

Këte që e rrëfen zonja Nekibe Kelmendi, përputhet edhe me rrëfimin e babait të Suadit i cili thotë se pas arrestimit, ne patëm angazhuar për mbrojtës të Suadit, avokat Bajram Kelmendin i cili pas disa ditëve ka ardhur edhe në Han të Elezit përkatësisht në zyrën e ofiqarisë për të marrë një çertifikatë të lindjes për Suadin i cili për nga mosha ishte i mitur, ndërsa serbët në burg ia kishin rritur vitet, por këtë nuk mundi ta realizoj Bajrami pasiqë zyra e ofiqarisë atë kohë ishte e mbyllur, ndërsa ne familjet që ishin nga anën e Puseve të Nikës, ku po zhvilloheshin luftimet, patëm lëshuar shtëpitë dhe pas pak ditësh serbët na dëbuan edhe nga qyteza, përkatësisht Kosova. E vetmja shpresë për të kontaktuar me avokatin Bajram Kelmendin mbetën lidhjet nga Shkupi, por gjithçka mori fund me 24 mars 1999 ku vritet edhe vet Bajrami me të bijtë e tij atëherë çdo lidhje për fatin e Suadit u shkëput, kujton Isen Brava, tanimë i ndjerë.

Më 28 mars 1999, pasdarke, raketat e NATO-s sulmuan çerdhen e operativës serbe, SPB-në e Prishtinës ku burgu është i lidhur në formë patkoi me muret e kësaj ndërtese famëkeqe. Gjendesha në çelinë nr.4 të këtij burgu, kujton autori i monografisë ish i burgosuri politik Shaban Çupi, duke vazhduar më tej se të nesërmen në orët e hershme të mëngjesit, përshkak të rrethanave të pasigurta në këtë burg, na kanë nxjerrur gjithë të burgosurit nga burgu i Prishtinës dhe na kanë transferuar në burgun kampin) e Lypjanit e në mesin e këtyre të burgosurve ishte edhe Suad Brava. Në kronologjinë e ngjarjeve të asaj kohe kujtoj se,pas qëndrimit një mujor në burgun e Lypjanit, ditën e 30 prillit 1999, që në orët e hershme të

mëngjesit, policia serbe na nxori nga dhomat e burgut (ferrit) të Lypjanit dhe na detyruan që të qëndrojmë në oborr me kokë për muri. Na u dha urdhëri që atij që ia përmendin emrin të deklarohet. Derisa policët thërrisnin emrat e të burgosurve një nga një, dëgjova edhe emrin e Suad Bravës për të cilin e dija se është arrestuar me 2 mars 1999, por nuk munda ta shoh, sepse nuk guxonim të kthenim kokën, por e dija se kahdo që do të na transferojnë, Suadin e kisha me vete. Ate arrita ta kontaktoj fizikisht në burgun e Dubravës, përkatësisht në pavijonin ,,B'' krahu i majtë, kati i dytë, ku para se të na fusnin në pavijone, kishim pësuar tortura të rënda në aneksin e burgut, rrëfen Shaban Çupi.

Suad Brava me të burgosurit tjerë të Hanit të Elezit si Shefket Topojanin, Sherif Berishën, Valon Berishën, Sabedin Hasallarin, Shefket Beqën, Isa Bushin, Ismail Hysën e Qamil Abazin, bashkohet me 19 maj, pasiqë të burgosurit kishin arritur të thyejnë dyertë e pavijoneve dhe të dalin në oborrin e burgut ku të gjithë të burgosurit do të përballen me sulmet e raketave të NATO-s, ku njëherit pësojnë edhe 23 të burgosur, por meqë autoritetet serbe vërejtën se NATO-ja nuk do të gjuante më mbi të burgosurit, shpalosën skenarin tjetër. Me 22 maj 1999, në orët e hershme të mëngjesit i grumbullojnë të burgosurit në Fushën e Sportit me arsyetim se do t`i transferojnë në burgun e Nishit dhe në këtë kurthë serbe, ata sulmohen me të gjitha mjetet, duke i lënë të vdekur rreth 163 të burgosur e mbi 200 të tjerë me plagë të rënda. Një nga ata që në majin e atij viti gjakosi tokën e ëmbël të Kosovës ishte edhe Suad Brava të cilin plumbi e goditi në veshkën e djathtë për të përshkruar tej e më tej trupin e tij të njomë, përkatësisht në anën e djathtë të kërthizës. Krahas gjuajtjeve të pandërprera që bëheshin nga karakollat e burgut, Suad Brava i plagosur rëndë tërhiqet nga shokët e tij dhe arrijnë të barikadohen në bodrumin e menzës së burgut. Suadin, thotë përjetuesi tjetër i kësaj masakre Sherif Berisha, e vendosëm mbi thasë të patateve, sepse bodrumi kishte ujë dhe në atë bodrum kishte edhe të plagosur të tjerë, madje edhe nga Shqipëria, kujton përjetuesi tjetër Shefket Topojani.

Suad Brava edhe pse i ri, ishte shumë i durueshëm nga plagët e marrura kujton Valon Berisha, duke shtuar se Suadi kishte gjakderdhje të brendëshme dhe plaga ishte e madhe.

Trupi i njomë, por i fortë i Suadit, vdekjes do t`i bëjë ballë deri në orët e hershme të mëngjesit të datës 23 maj 1999 ku edhe vdes në bodrumin e kuzhinës së burgut mbi thasët e patateve, kujton përjetuesi tjetër i kësaj masakre Sabedin Hasallari duke shtuar se pas vdekjes arritëm

që në xhepin e pantallonave të Suadit të fusim një letër me adresën e tij me të vetmin qëllim që të mos i humbet kufoma.

Dëshmori Suad Brava ishte pjesëtar i UÇK-së i Brigadës 164 „Gafurr Loku'' në Han të Elezit. Ishte anëtari më i ri i Brigadës, por njëkohësisht ishte edhe më i ri nga të gjithë të burgosurit e vrarë në tmerrin Dubrava. Gjenocidalët serb shkelën çdo konventë ndërkombëtare, duke i pushkatuar pa gjyq edhe të burgosurit që për nga mosha ishin të mitur. Kjo masakër, për ironi të kohës, nuk arriti të depërtoj as në Tribunalin e Hagës edhe pse pas lufte përjetuesit e kësaj masakre arritën që të identifikojnë një numër të konsiderueshëm të kriminelëve.

Trupi i pajetë i dëshmorit Suad Brava zhvarroset paslufte nga varrezat masive të Rakoshit dhe me nderime ushtarake rivarroset me 29 gusht 1999 në varrezat e dëshmorëve në Puset e Nikës.

Për kontributin e tij, Qeveria e Përkohshme e Kosovës, SHP i UÇK-së, Zona e VI e TMK-së, Kuvendi komunal, Batalioni 36 xhenios i TMK-së, dëshmorin Suad Brava e nderuan me mirënjohje, ndërsa stadiumi i qytetit në Han të Elezit mban emrin e tij. Me vendim presidencial është shpallur Hero i Kosovës.

Varreza masive në Rakosh, ku të burgosurit shqiptar u varrosën pas vrasjeve në burgun e Dubravës. Këtu ka qëndruar edhe trupi i pajetë i dëshmorit Suad Brava.

Në bodrumin e kuzhinës së burgut të Dubravës, mbet trupi i pajetë i dëshmorit Suad Brava.
Fotografi e datës 22 maj 2022, Dubravë

Në nderim të dëshmorit Suad Brava dhe gjithë dëshmorëve të tjerë, Burgu i Dubravës më 22.5.2022. Nga e majta Kolonel Hajrush Kurtaj, vëllau i dëshmorëve Xheladin Kurtaj e Danush Kurtaj, veterani i UÇK-së Muhamet Kuka dhe autori i monografisë.

Në nderim të jetës dhe veprës së dëshmorit Suad Brava, 22 maj 2022, Dubravë

Përjetuesit e masakrës së Dubravës dhe njëherit bashkëvuajtësit e dëshmorit Suad Brava në Memorialin e ngritur për dëshmorët në burgun e Dubravës. Nga e majta: Sabedin Hasallari, Sherif Berisha, Shefket Topojani, Valon Berisha dhe Shaban Çupi, fotografi e vitit 2021

Në vitin 2019 u bë edhe përurimi i stadiumit të qytetit i cili bart emrin e dëshmorit Suad Brava

Të mbijetuarit e masakrës së Dubravës dhe një moment i përbashkët me nënën e dëshmorit Suad Brava në Puset e Nikës në vitin 2019

Suad Brava ishte i arrestuar nga policia dhe ushtria serbe me 2 mars 1999 në zonën e luftës në Puset e Nikës. Nga Ferizaj e transferojnë në Prishtinë e nga Prishtina në Lypjan e nga Lypjani në Dubravë ku edhe vritet pa gjyq. Suadi ishte i mitur, u vra me armë të shtetit dhe brenda hapsirës së burgut. Krimi ishte i organizuar nga shteti serb dhe kishte vijën komanduese. Në këtë burg u shkelën të gjitha Konventat Ndërkombëtare të cilat shteti serb vetë i kishte nënshkruar

Elham Curri (1981-2001)

Shpati i flet shpatit
Eja ndihmom pak
Ngritet Elham Curri
Për ty jetën jap.

Dëshmori Elham Curri u lind më 2.4.1981 në fshatin Dërmjak të Hanit të Elezit. Babai Ismaili dhe nëna Hamdije në jetën e tyre martesore kishin tre fëmijë dhe Elhami ishte fëmiu i parë nga radha e fëmijëve të Ismail Currit.

U lind në fshatin Dërmjak i cili shtrihet në pjesën lindore të komunës së Hanit të Elezit, fshat i cili në vitin 1912 u masakrua nga forcat pushtuese serbe, një muaj para se Ismail Qemajli të shpallte Pavarësinë e Shqipërisë. Krahas kësaj, ky fshat në nëntorin e vitit 1944 u bë strehë e popullatës së fshatit Bllacë të Shkupit e cila e përjetoi tmerrshëm dhunën dhe gjenocidin serbo - komunist të atij viti ku vetëm për një ditë u vranë 111 kryefamiljarë.

Elham Curri shkollën fillore e kreu në Han të Elezit, kurse të mesmen, drejtimin automekanik në Shkollën e Mesme ,,Dardania''.Si i ri e përjetoi rëndë dëbimin e popullit shqiptarë nga trojet e tyre. Meqenëse familja e tij ishte rreshtuar në radhët e UÇK-së, edhe gjatë luftës së Kosovës nuk do të mungoj kontributi i Elhamit si në ndihmë popullatës civile e gjithashtu edhe në bartjen e armëve. Familja e tij,gjatë luftës çlirimtare të Kosovës ishte aktive jo vetëm në pritjen dhe përcjelljen e ushtarëve që vinin nga zonat e ndryshme, por krahas kësaj ata ishin edhe ushtarë aktiv si, Shaban Curri, Ramadan Curri, Sali Curri, Rrahim Curri, Sami Curri, Sinan Curri si dhe Hajrullah Curri si furnizues, madje jo vetëm në Gjurgjedell ku vepronte Batalioni i tretë i Brigadës 164 të UÇK-së, por edhe në Koshare.

Përkundër moshës së tij të re, ai kishte mësuar se trojet shqiptare që nga Kongresi i Berlinit ishin coptuar rëndë dhe në rrjedhë të kësaj, kishte arritur të kuptonte thellë se pushtuesi sllavë për kundër pushtimit të popullit shqiptarë ai kishte arritur t`i regjionalizoj ata si; shqiptarët në Preshevë, Mal të Zi e Maqedoni dhe kishte krijuar një vetëdije të çiltër kombëtare se kudo ku krisin pushkët për çlirimin e këtyre trojeve, ai do të merrte pjesë në luftë dhe këtë betim shpirtëror dëshmori Elham Curri po e jetësonte në moshën e tij 20 vjeçare .

Pas shpërthimit të luftës në Maqedoni, Elham Curri rreshtohet pranë luftëtarëve të UÇ-Kombëtare. Nga Hani i Elezit, së bashku me Florim Shkretën, niset më 15 mars 2001. Në fushëbetejat e luftës, ai nga Hani i Elezit kalon në Viti përkatësisht në restoranin ,, Drenica “ ku edhe takohen me luftëtarin e njohur të tri luftërave çlirimtare, Xhavit Hasanin dhe bashkë me disa bashkëluftëtarë tjerë të anëve të Drenicës, Kaçanikut e Gjakovës, udhëtojmë për Lubishtë, në një bazë tjetër të UÇK-së. Po atë natë futen në Tanushën kreshnike ku në shkurtin e atij viti kishin

shpërthyer pushkët çlirimtare. Përkundër arritjes në Tanushë, Elhami me bashkëluftëtarët e tij nuk mundën të qëndrojnë në këtë fshat sepse luftimet kishin filluar në Malinë dhe Shtabi i luftës ishte atje,deklaron Florim Shkreta. Në Malinë, Elham Curri arrinë kah ora 1 e 30 e natës ku edhe mirëpritet nga udhëheqësit e luftës si komandant Struga, Maliq Ndreca, Fadil Limani, etj. Ende pa pushuar nga udhëtimi i gjatë, mëngjesi i ditës së 16 marsit 2001 luftëtarin Elham Currin e gjenë përballë një ofenzive të madhe që forcat sllavomaqedonase kishin ndërmarrë kundër UÇK-së po atë ditë në Malinë. Këtë ofenzivë armike, krahas bashkë-luftëtarëve të tjerë po e përballonte guximshëm dhe plot vrull edhe dëshmori Elham Curri. Ai gjendet në pozicionet e luftës të cilat sulmoheshin me të gjitha mjetet dhe nga të gjitha anët, por depërtimi i forcave maqedonase në istikamet e UÇK-së ishte i pamundur. Kjo beteje e madhe e filluar që nga orët e hershme të mëngjesit për dëshmorin ishte dita e parë dhe njëkohësisht dita e fundit e luftës. Rreth orës 16:00 të datës 16 mars, në frontin e luftës bie heroikisht dëshmori Elham Curri[46]. Përkundër përpjekjes së bashkëluftëtarëve të tij që Elhamin e plagosur rëndë ta përcjellin për shërim të mëtejmë në Kosovë , plagët e rënda që i kishte marrë nga minahedhësit sllav, bënë që ai të ndërrroj jetë në Malinë duke mbetur i pavdekshëm në analet e historisë sonë kombëtare.

Përgjegjësi për logjistikën e UÇK-së të Brigadës 113 ,,Ismet Jashari-Kumanova'', Haxhi Qerimi nga fshati Lubishtë, dëshmon se trupin e pajetë të dëshmorit Elham Curri nga Malina e ka sjellur luftëtari i UÇK-së nga Drenica, Hajzer Çitaku. Pas njoftimit për vrasjen e dëshmorit, ne kemi dalur që ta marrim ate në mes kufirit të Maqedonisë dhe Kosovës dhe trupi i pajetë i dëshmorit ishte i ngarkuar mbi një kalë, duke shtuar se atë natë trupi i dëshmorit Elham Curri ka qëndruar në shtëpinë e Muhamrrem Isakut në Lubishtë, ndërsa unë kam ardhur në Han të Elezit dhe kam njoftuar familjen e tij.Të nesërmen, dëshmorin Elham Currin e kemi sjellur me makinën e ndihmës së shpejtë të QMF të komunës së Vitisë, kujton pjesëtari i UÇK-së Haxhi Qerimi duke shtuar edhe një detaj se me Hanin e Elezit më lidhin shumë Elham Curri dhe Nehat Curri.

Elham Curri varroset në varrezat e dëshmorëve në Puset e Nikës në prani të mijëra qytetarëvet ku prezantuesi i këtij varrimi, ish i burgosuri politik Shaban Çupi në fjalën e rastit, ndër të tjera tha se Elham Curri u lind më 2 prill 1981, atë ditë kur në Prishtinën heroike po zhvilloheshin demonstratat popullore për Republikën e Kosovës, atë ditë kur rinia jonë

[46] Informatë nga pjesëtari i UÇK-së Florim Shkreta nga fshati Seqishtë, dhënë Shoqatës së Familjeve të Dëshmorëve - Dega në Han të Elezit.

studentore ndeshej ballë për ballë me forcat pushtuese, duke shtuar se forcat sllavomaqedonase ia morën jetën dëshmorit Elham Curri, por kurrë s`mund ta shuajnë idealin e shqiptarëve për liri.

Krahas kësaj, në varrim u lexua edhe një telegram ngushëllimi që vinte nga Shtabi i Përgjithshëm i UÇ-Kombëtare, ku ndër të tjera thuhej se ju shprehim ngushëllime më të sinqerta për vrasjen e birit tuaj Elham Curri i cili u vra më 16 mars 2001 në fushëbetejat e Malinës si ushtar i Brigadës 113 Ismet Jashari - Kumanova. Pushka e tij u bashkua me pushkën e vëllezërve të Maqedonisë të cilët me pushkë kanë vendosur t`i fitojnë të drejtat e tyre, thuhet ndër të tjera në telegramin ngushëllues.

Për dëshmorin Elham Currin janë shkruar artikuj në të përditshmet kosovare, nga nxënësit janë thurur poezi, ndërsa rapsodët këndojnë këngë. Për kontributin e tij kombëtar, insitucionet përkatëse, dëshmorin Elham Currin e kanë nderuar me mirënjohje dhe një rrugë në komunën e Hanit të Elezit mban emrin e tij.

Rufki Suma në fjalë rasti për dëshmorin në 20 vjetorin e rënies

Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Hanit të Elezit, Florim Shkreta, njëherit bashkëluftëtar i dëshmorit, bashkë me stafin komunal në vendin e rënies së dëshmorit në Malinë. Fotografi e vitit 2022

Ilaz Thaçi (1969-2001)

Nëpër të gjitha betejat e atdheut për liri, mësuesit shqiptar jo vetëm që dhanë kontributin e tyre në arsimimin e popullit, por ata u bënë edhe mobilizues dhe frymëzues të luftës për liri. Njëri nga ata që me pushkë e

penë dha kontribut komëbëtar për çlirim ishte edhe dëshmori Ilaz Thaçi. U lind më 11 shkurt të vitit 1969 në fshatin Kryenik të Hanit te Elezit. U lind nga babai Hamdiu dhe nëna Sabrije, të cilët në jetën e tyre martesore kishin pesë fëmijë. Ilazi ishte fëmija i dytë nga radha e fëmijëve të babë Hamdiut. Fëmijërinë e kaloi maleve dhe fushave të vendlindjes, ku krahas këmbanave të shumta të bagëtive, këngët e zogjëve e bënin edhe më të dashur jetën, sikur e bënin edhe më të shtrenjt atdheun të cilën darat serbosllave e kishin mbërthyer më së keqi.

Ilaz Thaçi, katër vitet e fillores i kreu në fshatin Kryenik, ndërsa pjesën tjetër në fshatin Guranë, përkatësisht në shkollën fillore „Tefik Çanga“ ndërsa të mesmën në gjimnazin „Skënderbeu“ në Kaçanik.

Pas përfundimit të shkollës së mesme, Ilaz Thaçi regjistrohet në shkollën e Lartë Pedagogjike në Gjakovë në drejtimin Biologji - Kimi, por kushtet e rënda ekonomike që kishte, ende pa e përfunduar shkollën përkatëse, punësohet në shkollën fillore të fshatit.

Punën me nxënës e filloi nga shtatori i vitit 1992 dhe nevoja per mësues në atë kohë ishte e madhe. Pushtuesi shkatërroi sistemin arsimor dhe si i tillë, kushtet për mësimdhënie ishin tejet të rënda. Në kërkesën e tij për punë, drejtuar organeve përkatëse e cila mban datën 9 shtator 1992, shkruan:

„….Pranoj që edhe unë të punoj me ato kushte që punoni ju dhe se do të jem i palodhshëm në arsimimin e gjenaratës së re ….“

Dhe vërtet Ilaz Thaçi ishte i palodhshëm në veprimtarinë e tij, thotë vëllau i tij Naseri, duke shtuar se Ilazi thoshte se ky zullum do të këputet prej së trashi dhe mirë që u këput, kujton sot ai.

Pas vrasjes së komandantit legjendar Adem Jashari, në tërë Kosovën shpërthejnë demonstrata kundër dhunës serbe. Demonstrata të tilla mbahen edhe në Han të Elezit dhe dëshmori Ilaz Thaçi ishte pjesëmarrës i tyre dhe në një demonstratë të radhës arrestohet nga policia serbe dhe keqtrajtohet në stacionin policor në Han të Elezit.

Krahas kësaj, Ilaz Thaçi ishe përjetues i torturave që pushtuesi bënte mbi banorët e fshatit Kryenik. Kur në marsin e vitit 1999, banorët e këtij fshati detyrohen të shpërngulen në Maqedoni, Ilaz Thaçi përjeton një dëshprim të veçantë, sepse përpos që po dëboheshin banorët e këtij fshati ku jetuan gjysh pas gjyshi, për Maqedoni po dëboheshin edhe nxënësit e tij dhe për pasojë shkolla u mbyll dhe fshati u pushtua prej forcave policore-ushtarake serbe.

Ilaz Thaçi me shumë bashkëvendas nga Maqedonia, nëpërmjet fshatit Radushë kalojnë në pikën luftarake në Puset e Nikës dhe i

bashkangjiten radhëve të UÇK-së . E shtrejtë ishte dita kur Ilazi iu bashkangjit radhëve të lirisë, atij xherdani fisnik i cili me pushkë në dorë po e luftonte pushtimin shekullor serb. Ilaz Thaçi, si ushtar i UÇK-së pranë Brigadës 164 „Gafurr Loku“ dha kontributin maksimal ashtu si bashkëluftëtarët e kësaj Brigade dhe zbatonte të gjitha urdhërat që vinin nga komanda e sajë.

Me përfundimin e luftës, për në Kosovën e lirë ktheheshin popullata e shpërngulur me dhunë. Një kthim biblik po e bënin edhe banorët e fshatit Kryenik e bashkë me ato po ktheheshin edhe nxënësit e këtij fshati. Shkolla hapet përsëri dhe mësuesi Ilaz vazhdon misionin e tij fisnik në arsimimin e gjeneratave të reja.

Shkurti i vitit 2001, shënon vitin e shpërthimit të luftës në viset shqiptare në Maqedoni. Kjo luftë filloi në Tanushën kreshnike për t'u shpërndarë si një flakë e rrëmbyeshme në të gjitha viset shqiptare në Maqedoni Kjo luftë, krahas Karadakut epik, po zhvillohej edhe buzë fshatit Kryenik, si në Greqan, Radushë, Vorcë e Rrafsh të Pollogut. Ilaz Thaçi përsëri angazhohet në radhët e UÇK-së dhe ishte vija furnizuese me armë, ushqim dhe uniforma me një fjalë ishte arterja furnizues e luftës për liri anës së Hanit të Elezit.

Ilaz Thaçi, kujton Fejzullah Krasniqi, ishte ushtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe gjatë kësaj lufte ai dha një kontribut të madh kombëtar. Por, me shpërthimin e luftës në Maqedoni dhe me formimin e Shtabit të UÇ-Kombëtare më 17 mars 2001 për Greqan, dëshmori Ilaz Thaçi ishte logjistika më domethënëse e vijës së luftës: Kryenik-Greqan dhe këtë rrugëtim ai e bënte natë e ditë, pa kursyer mundin, djersën dhe shëndetin.

Më 29 Mars 2001, njësitë zbuluese të Armatës Maqedonase, indentifikojnë vijën furnizuese të UÇK-së për Greqan dhe nga orët e paraditës fillojnë të sulmojnë me granatahedhës 120mm. fshatin Kryenik në brendësi të Kosovës. Meqenëse granantat binin në „zemër“ të fshatit ku edhe gjendej shkolla, vetën pak minuta para se të vritej mësuesi Ilaz arriti t`i nxjerr nxënësit e tij dhe me t`u kthyer në oborrin e shkollës një granatë ishte fatale për jetën e mësuesit Ilaz Thaçi, e krahas tij nga kjo granatë vriten edhe Baki Krasniqi, Raif Thaçi, gazetari i APTN-së Kerem Laëton, ndërsa plagosen Nuri Krasniqi, Sadik Krasniqi, Mendu Thaçi, Usref Thaçi, Besim Brava, Aqif Berisha, Besrim Krasniqi. Granatohen shtëpitë e Asllan Thaçit, Zelqif Thaçi, Vebi Thaçit, shkolla, xhamia,.....

Rreth këtij sulmi, njëri nga dëshmitarët e asaj dite Fejzulla Krasniqi rrëfen se: Granata e parë ra te Shkozat, tjetra në Lamë të Spahisë e treta në

Ograde të Seferit e katërta te shtëpia e Brahim Qajanit e pesta në shtëpinë e Vebi Thaçit ku i dëmtohen dy vetura dhe dy makina për lyerjen e shtëpive,e gjashta ra në oborrin e shkollës ku mori jetën e katër njerzëve dhe plagosi shumë të tjere. Granatat tjera, rreth 12 sosh kanë rënë nëpër fshat. Kur ra granata e parë, unë me motoçikletën time u nisa në drejtim te fshatit Guranë për t`i njoftuar ushtarët amerikan dhe u ktheva se bashku me ata. Me kerrin tim ne drejtim ne Han te Elezit kam bartur vëllain tim të plagosur, Sadik Krasniqin dhe Baki Krasniqin, por kur arrita te fabrika e Sallonitit, Bakiu vdiq. Shaban Thaçi në makinën e tij e ka pasur gazetarin anglez dhe Raif Thaçin. Para se të arrijë në Bondstill vdiq gazetari Kerem Laëton, ndërsa plaku Raif Thaçi vdes pas disa ditëve në spital. Ishte një ditë e tmerrshme. Sllavomaqedonasit me gjakftohtësi granatonin fshatin tonë“ kujton ai.

Dëshmori Ilaz Thaçi u vra më 29 mars 2001, në moshën 32 vjeçare dhe ishte i fejuar. Varrimi i këtij dhe i dëshmorit tjetër të këtij fshati Baki Krasniqi bëhet me datën 1 prill 2001. Krahas një moti shumë të ftohtë, në varrim morën pjesë mijëra vetë. Në varrim pos popullatës së rrethit, morën pjesë edhe personalitete të shquara të viseve shqiptare . Në shenjë nderimi për kontributin kombëtarë të dëshmorit Ilaz Thaçi, kolektivi i shkollës fillore,,Tefik Çanga’’, anëtar i së cilës ishte vet Ilaz Thaçi, vendosi që shkolla fillore të bartë emrin e tij, ndërsa 29 marsi u caktua Dita e kësaj shkolle.

Për dëshmorin Ilaz Thaçi, në të përditshmet kosovare janë shkruar artikuj, ndërsa nga rapsodët janë thurur këngë. Veprimtaria e tij kombëtare nga institucionet përkatëse është nderuar me mirënjohje.

Ilaz Thaçi

Thënie nga dëshmori Ilaz Thaçi:
Atdheun duhet ta mbrojmë edhe me penë, edhe me pushkë!

Arsimtarët dhe stafi i komunës në krye me kryetarin Mehmet Ballazhi në nderim të mësuesit dëshmor në Kryenik, mars 2022

Kryetari i komunës, Mehmet Ballazhi në nderim të të rënëve në Kryenik, fotografi e vitit 2022

Shkolla Muze në Kryenik e përuruar në vitin 2021

Në mësonjëtoren e mësuesit Ilaz Thaçi, tanimë klasë muzeale

Baki Krasniqi (1980 – 2001)

Baki Krasniqi u lind më 1.12.1980 në fshatin Kryenik të komunës së Hanit të Elezit. Babai Nuriu dhe nëna Nurije në jetën e tyre martesore patën tetë fëmijë: Kadrin, Rizain, Bakiun, Isniun ; motrat Lumnijen, Xhemilen, Zirafetin dhe Meleken. Në xherdanin e kësaj familje, Bakiu ishte fëmiu i tretë nga radha e fëmijëve të babë Nuriut.

Baki Krasniqi shkollën fillore e kreu në fshatin e lindjes dhe përshkak të kushteve të vështira ekonomike nuk kishte mundësi të mëtejmë shkollimi.

Me shpërthimin e luftës në trojet shqiptare në Maqedoni, shtëpia e Bakiut ishte shndërruar në çerdhe shqiponjash - luftëtarë të kauzës kombëtare për lirinë e trojeve shqiptare, të cilët po luftonin me forcat sllavomaqedonase në Greçan, Radushë e gjetkë.

Me armët, bukën dhe ujin që sillte Bakiu për luftëtarët e lirisë, kujtonte Miqail Krasniqi (tani i ndjerë) , forcohej edhe më tepër fronti i lirisë, përkatësisht forcohet dhe kalitej edhe vetë Ushtria Çlirimtare Kombëtare dhe krahas Bakiut, këtë detyrë me përkushtim të lartë kombëtarë e kryente edhe dëshmori tjetër Ilaz Thaçi.

Që nga varrimi i dëshmorit Elham Curri, më 17 mars 2001, dhe formimi i njësisë së UÇ-Kombëtare në Greqan, veprimtaria e Ilaz Thaçit dhe Baki Krasniqit ishte e gjithanëshme dhe e fuqishme, rrëfen Fejzullah Krasniqi, veteran i UÇK-së. Shtëpitë e Ilazit dhe të Bakiut ishin qendra grumbulluese prej kah vinin ushtarë prej viseve të ndryshme dhe nëprmjet

Bakiut dhe Ilazit depërtonin në vijat e luftës. Ata, natë e ditë ishin në furnizim të ushtarëve në Greqan dhe në çdo kohë i gjeje në krye të detyrës, madje Ilaz Thaçi ditën e mbante mësimin edhe me nxënës. Ilaz Thaçi e Baki Krasniqi ishin tejet aktiv edhe në tërheqjen e të plagosurve nga Greqani, si Islam Muçën, Adem Kalisin, Emin Bushin dhe ushtarin tjetër nga Vorca, por duke mos harruar kontributin e pakontestueshëm të mjekut Metali Lusnjani nga Gurana, tani i ndjerë, veteran i UÇK-së, kujton Fejzullah Krasniqi.

Në vazhdën e kësaj detyre të shenjtë të logjistikës, Baki Krasniqi vritet nga forcat sllavomaqedonase në fshatin Kryenik në brendësi të Kosovës. Vritet atë ditë kur granatat sllavomaqedonase granatuan fshatin e tij. Baki Krasniqi u vra më 29 mars 2001, në moshën 20 vjeçare dhe ishte i pamartuar. Në momentin e vrasjes së Bakiut, në oborrin e shkollës fillore të fshatit plagoset rëndë edhe babai i tij Nuriu i lindur në vitin 1940. Nuriu plagoset në këmbë e krah dhe për disa ditë qëndron në spitalin e KFOR-it në Bondstill ku edhe operohet. Të nesërmen kuptoi për vrasjen e djalit të tij Bakiut. Për Bakiun janë shkruar artikuj në të përditshmet kosovare si dhe janë thurur këngë, ndërsa Insitucionet përkatëse veprimtarinë e dëshmorit e kanë nderuar me mirënjohje.

Ç`deklaruan dëshmitarët për sulmin në fshatin Kryenik më 29 mars të vitit 2001

Më 29 mars 2001 u sulmua fshati Kryenik nga forcat policor-ushtarake të IRJ të Maqedonisë dhe si pasojë mbetën të vrarë katër civilë të pafajshëm: mësuesi i fshatit Ilaz Hamdi Thaçi, Baki Nuri Krasniqi , gazetari i Asoshieted Presit, Kerem Lejton dhe plaku 71 vjeçar Raif Thaçi. Sulmi me granata u bë me 29 mars, ditën e enjte në oborrin e shkollës fillore të fshatit, ndërsa granatat tjera kanë rënë nëpër shtëpitë e tjera të fshatit. Përpos katër të vrarëve, në fshatin Kryenik u plagosën edhe Sadik Krasniqi, Mendu Thaçi, Usref Thaçi, Besim Brava, Aqif Berisha e Besrim Krasniqi. U granatuan shtëpitë e Asllan Thaçit, Zelqif Thaçit, Vebi Thaçit, shkolla, xhamia,…

Sapo u kuptua për këtë sulm, shumë qytetarë me makina u drejtuan kah fshati Kryenik për t`i sjellur të vrarët, të plagosurit, gratë shtatëzëna, fëmijë të lemeritur, pleqtë me shpirt të këputur. Ndihma e parë, të plagosurve iu dha në shtëpinë e shëndetit në Han të Elezit, prej kah u përcollën për në Ferizaj, Prishtinë dhe në spitalin ushtarak të KFOR-it në Bondstell. Në spitalin e Prishtinës, pas dhjetë dite, nga plagët e marra më 9 mars, vdiq edhe Raif Thaçi, varrimi i të cilit u bë po në fshatin Kryenik me datën 10 prill 2001.

Se si dhe çka ndodhi atë ditë në fshatin Kryenik të komunës së Hanit të Elezit, ju sjellim rrëfimet e dëshmitarëve, qoftë të banorëve të fshatit, qoftë ekipe mjekësore të cilët bënë përpjekje maksimale që të plagosurve t`ua shpëtojnë jetën.

Rrëfime e dëshmi

Menduh Thaçi, i plagosur

Është i lindur më 10.7.1967 në fshatin Kryenik. Me 29 mars 2001 plagoset nga granatat maqedonase në oborrin e shkollës fillore. Rreth kësaj ngjarje deklaron:

,,Meqë në fshat kishim një rast vdekje, ishim duke pritur njerëz që vinin për të shprehur ngushullime.Granatat e para kanë rënë që në orët e hershme të paraditës, por kur granatat ranë në një afërsi prej 100 metrave në afërsi të fshatit, atëherë jemi mbledhur në oborrin e shkollës rreth 20 persona.Ndërkohë në fshat erdhën dy gazetarë dhe menjëherë i njoftuam për granatimet dhe ju thamë që të marrin ndonjë masë. Derisa po i njoftonim, ra granata tjetër në mesin tonë. Nga fuqia e saj jemi rrëzuar të gjithë. Kur u ngrita e vërejta se jam i plagosur. Jam tërhequr në drejtim të shtëpisë. Ndihmën e parë ma dha mysafiri nga fshati Gorancë, Haqif Berisha dhe djali i axhës, i cili më dërgoi në Han të Elezit, prej kah më përcollën për në Ferizaj dhe atje qëndrova dy ditë. Pas dy ditësh më kanë dërguar në spitalin e Prishtinës.Kam tri plagë: Një në qafë, një në shpinë dhe një në krah. Copat e granatës ende nuk m`i kanë hequr.Ende jam në terapi, pas kësaj do të operohem. Sa isha në spitalin e Ferizajt, ndihma e shpejtë e solli Haqif Berishën, i cili pak më parë më kishte dhënë ndihmën e parë. Ai më njoftoi se ka pasur edhe granatime tjera dhe se një copë granate më ka plagosur në krahë.Gjatë kohës së granatimeve dy helikopter të KFOR-it kanë vëzhguar në drejtim të fshatit Greçan të Shkupit.''

Usref Thaçi, i plagosur

Është i lindur në vitin 1975 në fshatin Kryenik. Më 29 mars 2001 plagoset nga granatat sllavomaqedonase. Rreth kësaj ngjarjeje deklaron:,, Jam plagosur në oborrin e shkollës së fshatit. Një copë granate më plagosi në shpinë. Ndihma e parë më është dhënë në ambulancën e Hanit të Elezit. Më pas më përcollën për në Ferizaj. Copa e granatës ende nuk më është hequr.''

Bashkëbisedë me të plagosurin Nuri Krasniqi më 4 prill 2001, njëherit babai i dëshmorit Baki Krasniqi

Në rend të parë ju shprehim ngushëllime për djalin tuaj të vrarë, Baki Krasniqin, ndërsa juve ju urojmë shërim më të shpejtë. Jemi të vetëdijshëm për ngarkesën tuaj, por meqë jemi të interesuar për një bashkëbisedë, ju lutemi për një rrëfim paksa më të zgjeruar rreth granatimit sllavomaqedonas në fshatin tuaj.

Quhem Nuri Krasniqi. Jam i lindur më 16 dhjetor 1940 në fshatin Kryenik. Granatat e para kanë rënë rreth orës 9 në vendin e quajtur ,,Shkoza'', tjetra ka rënë në ,,Lamë të spahisë'' në afërsi të shkollës dhe shumë të tjera nëpër fshat.Në këtë kohë ne ishim duke pritur njerëz, sepse kishim një rast vdekje në fshat. Nga shtëpia ku pritnim, me mua doli edhe kushëriri im Sadik Krasniqi. Neve na u duk se granatat ranë mbi shtëpitë tona. Kur dolëm në oborr të shkollës gjetëm edhe fshatarë të tjerë të shqetësuar. Në ato çaste erdhën dy gazetarë dhe ne u treguam për granatimet. Kur u treguam se një granatë ka rënë në ,,Lamë të spahisë'' njëri nga gazetarët (Sylejman Kllokoqi, v.j.) shkoi në vendin se ku kishte rënë granata. Pas pak kohe kthehet gazetari tek ne në oborr të shkollës. Nuk vonoi as një minutë dhe në mesin tonë shpërtheu granata tjetër.Të gjithë kemi rënë në tokë. Jo që kemi ditur të biem në tokë, por shpërthimi ishte aq i fuqishëm, saqë fuqia e granatës na kishte hedhur përtokë.

E dimë se ka qenë vështirë të ,,mblidhet'' mendja atyre çasteve, sepse edhe vetë ju keni qenë i plagosur, por mund të na thoni ç`vërejtët kur u ngritët nga toka?

Vërejta një tmerr. Në afërsi e vërejta mësuesin Ilaz Thaçi kur gjaku i rrjedhi nga goja, vdiq. Afër Ilazit vërejta birin tim që përpëlitej me jetën dhe shumë të tjerë të plagosur.

Ju kujtohet kush ua dha ndihmën e parë?

Po. Ndihmën ma dha KFOR-i amerikan, i cili atyre çasteve erdhi nga fshati Guranë. Më hipën në autoblindat e tyre dhe me të shpejtë u nisëm në drejtim të fshatit Seqishtë.

Thatë se ndihmën ua dhanë amerikanët. Dëshirojmë të dimë se ku ishte KFOR-i polak, kur dihet fakti se një javë para se të granatohet Kryeniku ata ishin vendosur te ,,Shkozat''?

Polakët janë larguar në drejtim të Hanit të Elezit që kur ranë granatat e para. Mos të harroj ta them se nga fshati ishin larguar edhe amerikanët, por ata në drejtim të Guranës. Këta që ma dhanë ndihmën ishte grupa tjetër që erdhi nga fshati Guranë.

Deklaruat se KFOR-i amerikan ju përcolli deri në fshatin Seqishtë. Ç`ndodhi pastaj?

Po. Amerikanët më dërguan deri te ,,Mullijt'' e Seqishtës. Aty rruga kishte qenë e bllokuar, kishin dalur shumë qytetarë me makina nga Hani i Elezit. Aty më zbritën. Në skaj të rrugës e vërejta djalin e vëllait tim, Mensur Krasniqin, të cilin nuk di se kush e kishte sjellur deri aty. Ai ende është në spital. Ka të thyer këmbën, krahun dhe është bërë operacion në bark. Atë e morën me një ,,kombi '' dhe e përcollën për spital, ndërsa unë në atë vend mbeta edhe gjysmë ore. Ndërkohë erdhi një automjet i KFOR-it dhe më dërgoi deri te dogana në Han të Elezit. Edhe aty më nxorën nga automjeti, dridhesha nga ethet. Më vonuan shumë. Prej andej me helikopter më dërguan në Bondstill ku edhe më operuan në krahun e djathtë. Plagën tjetër e kam në këmbë.

Kur kuptuat se ju ka vdekur djali i juaj, Bakiu?

Për djalin tim Bakiun, kuptova të nesërmen. Natyrisht se ishte një lajm i rëndë. Ai ishte i ri. Ishte i lindur në vitin 1981. Kishte të kryer vetëm shkollën fillore. Ishte punëtor dhe i sjellshëm. Meqë isha i shtrirë në spital, nuk munda të marr pjesë në varrimin e djalit tim.

Ndoshta e dini se KFOR-i dhe qeveria maqedonase janë duke bërë ekspertizën për ngjarjen e 29 marsit në fshatin tuaj. Si do ta komentonit këtë?

Ekspertizë mund të bëjnë dhe duhet të bëjnë. KFOR-i e ka lehtë këtë punë, kur dihet fakti se helikopterët gjatë granatimit kanë vëzhguar në afërsi të vendluftimeve. Se fshatin Kryenik e kanë granatuar forcat ushtarake maqedonase, këte e dinë tokë e qiell. Një ditë më parë granatat maqedone kanë rënë edhe në afërsi të fshatit Seqishtë dhe për këte janë njoftuar me kohë forcat e KFOR-it, por nuk ndërmorën masa.

U ndamë nga plaku Nuri Krasniqi me një dhembje të thellë. Djalin 20 vjeçar, Bakiun, ia vranë pa i pasur hak askujt. Vet i plagosur në krah e këmbë. Djali i vëllait Besrimi, ende në spital. Familjarët të pamen e kanë hapur në një shtëpi të përbashkët. Kolona e njerëzve që vijnë për t`i ngushëlluar është e gjatë, sepse dhembja është e thellë.

Nga shtypi ditor i Kosovës

Ç`deklaruan dëshmitarët e ngjarjes në fshatin Kryenik për gazetën ,,ZËRI'' të Prishtinës më 29 mars 2001, të cilat deklarata u botuan në numrin e 30 marsit:

Kameramani i APTN-së, shoqëruesi i gazetarit Kerem Lejton, **Sylejman Kllokoqi,** deklaron:

,,Diku kah ora 11.15 u nisëm për të shkuar në Kryenik.

Rrugës për në fshat i pamë xhipat e amerikanëve dhe polakëve duke u larguar. Kur hymë në fshat, u afruan banorët dhe filluan të na thonë se ikën të gjithë, na kanë lënë vetëm. Janë duke rënë predha, ndërsa neve askush nuk po na ndihmon. Në atë moment, diku rreth 100 metra, i kam parë disa amerikanë dhe një fshatar duke zbritur kodrës për të parë vendin ku kanë rënë predhat. Helikopterët tërë kohën ishin në vëzhgim.

Unë e mora kamerën për të shkuar për të xhiruar një vend ku kishin rënë granatat. Keremi mbeti për ta larguar veturën. Pesë hapa i bëra nga aty, kur ra granata. E pashë se u bë tym përreth. E mora kamerën dhe u largova pak. Të them nja 30 sekonda jam fshehur në një vend, me dy të rinj të fshatit. Pas pak vrapova poshtë. Çka të shoh, njerëz të shtrirë nëpër tokë, të përgjakur. Shikova kah vetura dhe e pashë Keremin. Ishte i përgjakur, në komë. Kishte plagë në gjithë anën e djathtë të trupit.

Me ndihmën e një fshatari e dërguam tek KFOR-i që ia dha ndihmën e parë dhe pastaj e morën për t`i ndihmuar, por ai vdiq rrugës për në „Bondstill''.

Kerem Lejton ishte në Kosovë tash një vit. Ai është nga Anglia. Është i martuar. Ka lënë bashkëshorten në muajin e shtatë të shtatzënësisë ''

Maliq Krasniqi: „Granatimet në Graçan kanë filluar në orën 7.15. Dëgjoheshin gjëmimet. Në orët e paraditës granatat filluan të bien edhe në Kryenik. Sa kam mundur të numëroj unë, në fshatin tonë kanë rënë 18 granata. Ishim në shtëpi kur ranë granatat e para dhe të gjithë dolëm të shohim çfarë po ndodhte. Filloi paniku, sidomos te gratë dhe fëmijët. Ndërkohë doli një gazetar i huaj dhe në atë moment kemi dalë edhe ne për të parë vendet ku kanë rënë granatat.Pas pak kanë rënë granatat e reja, vala e tretë e granatave. Ishim shumë njerëz në një vend dhe aty ranë granatat…''

Dr.Menduh Kaloshi,(tani i ndjerë) ish përgjegjës i Shtëpisë së Shëndetit në Han të Elezit:

„Të plagosurit kanë nisur të arrijnë rreth orës 12, ndërsa të gjitha rastet përgjithësisht kanë qenë të rënda. Megjithatë, fillimi i ofrimit të ndihmës ka qenë shumë dëshpërues, pasi i arrituri i parë, i riu Baki N. Krasniqi u soll i vdekur dhe nuk ka pasur mundësi t`i ofrohet ndihmë.''

Dr.Besim Hoxha thekson se „Tre prej tyre janë lehtë të plagosur, ndërsa dy prej tyre janë në një gjendje më të rëndë. Njëri i është nënshtruar operacionit, dhe tjetri pret të hyjë në sallë''

Dr.Sylejman Metushi, drejtor i Qendrës Spitalore në Ferizaj: Personalisht Kerem Lejtonin e kam përcjellë deri në kampin Bondstill, por ai para se të arrinte aty, edhe pse përpjekjet tona ishin maksimale, ndërroi jetë.

Kumtesë e Shoqatës së Gazetarëve të Kosovës

Shoqata e Gazetarëve të Kosovës është e indinjuar thellë me rastin tragjik që ndodhi në fshatin Kryenik, ku pësuan civilë të pafajshëm e në mesin e tyre edhe gazetari Kerem Laëton. Edhe pse kanë kaluar gati dy vjet nga dhuna e tmerrshme që ndodhi në Kosovë, ky rast tregon se gazetarët jetën e tyre e kanë ende të pasigurtë. Për të qenë ironia edhe më e madhe, kësaj radhe gazetarët, të cilët punojnë në Kosovë, mund të vriten edhe nga Maqedonia. Një rast i tillë tragjik indinjon të gjithë gazetarët e Kosovës dhe ata që punojnë në Kosovë. SHGK do të mbajë në mend Kerem Laëton-in si një gazetar të zellshëm. Vrasja e kolegut tonë, Laëton, është përgjegjësi e qeverisë maqedonase nga i cili territor është kryer krimi në territorin tjetër. Kohëve të fundit jemi dëshmitarë se forcat e qeverisë maqedonase janë duke e përcjellur shembullin e tmerrit të forcave serbe që e ushtruan në Kosovë. SHGK kërkon nga KFOR-i që të ofrojë siguri më të madhe për të gjithë qytetarët,veçanërisht për gazetarët dhe që të gjendet sa më shpejtë vrasësi dhe ndaj tij të shqiptohet dënimi. Vrasja e Kerem Laëton-it ka sjellë pikëllim të madh në komunitetin e gazetarëve të Kosovës. Në emër të të gjithë gazetarëve, SHGK i shpreh ngushllim familjes Laëton në Britani të Madhe dhe në Kosovë.[47]

Varrimi i Ilaz Thaçit dhe Baki Krasniqit,mars 2001

[47] ,,Epoka e Re'' 31 mars 2001

Nehat Curri (1978-2001)

Këngën e atdheut
E mësoi dhe Nehati
Rrugës për liri,
Pushkën fort përqafi

Nehat Curri u lind më 17. 2. 1978 në lagjen Dizhon të Shkupit. Familja e tij rrjedh nga fshati Dërmjak i Hanit të Elezit e cila në vitin 1959 shpërngulet në Shkup. Babai Rushani dhe nëna Xhemile kishin tetë fëmijë: Mergjanin, Mevludin, Hakimin, Fevziun, Nehatin , Elmijën, Habiben dhe Mahmudijen.

Si gjithë bashkëkombasit e tij edhe Nehat Curri, rritej si qytetarë i rendit të dytë dhe padrejtësitë shoqërore ndaj shqiptarëve në Jugosllavinë socialiste ishin të mëdhaja dhe të planifikuara. Thellë në kokën e Nehatit ishte ngulitur shpërngulja e shqiptarëve nga trojet e tyre për në vendet tjera e sidomos në Turqi dhe gjatë jetës së tij të shkurtër mësoi edhe gjëra të tjera që shtypi, libri, por as shkolla ku mësonte as nuk i shkruanin e as i flisnin. Netëve të gjata të dimrit në Dizhon, ku acari mbërthente gjithçka, nuk mungonin as historitë që i rrëfente babai i tij Rushani, sidomos për masakrën serbe të vitit 1912 në Dërmjak, ndërsa nëna e tij Xhemilja, si bijë kërbliqi që ishte, fliste për masakra të tjera qoftë të Serbisë së Parë apo të Bugarit të Dytë që kishin ndodhur në fshatrat shqiptare në Karadak të Shkupit.

Nehat Curri si fëmijë, kur i kishte vetëm 10 vjet, përjetoi rëndë rrënimet e shtëpive të shqiptarëve të varfër të lagjes së Dizhonit në të cilën lagje jetonte edhe ai. Ky rrënim shtëpish bëhej nën velon e ,,urbanizimit'' por qëllimi ishte gjetkë, terrorizimi praktik dhe psikologjik i shqiptarëve, për të cilën shkrimtari Fadil Curri, djalë axhe i dëshmorit, shkruan se ,,Kjo lagje në Shkup njihej si kopsht ku lindën sythat e parë të së vërtetës së hidhur shqiptare që e sajonte pushteti maqedonas"[48]. Revoltat e shqiptarëve të sfilitur që protestonin duke thirrë ,, S*e më mirë ti vrasin e të mos ua rrënojnë shtëpitë* " ,,*Duam kulm mbi kokë* '' ,,*Pse u rrënohen shtëpitë veç shqiptarëve* " e klithje të tjera, lanë gjurmë të thella dhe të pashlyeshme në shpirtin e Nehatit të ri.

Pasa kryerjes së shkollës fillore pranë shkollës ,,Nikolla Vapcarov" në Shkup, dhe ate të mesme pranë shkollës ,,Zef Lush Marku", Nehat Curri regjistrohet në studime të mëtejme dhe të gjithë e njihnin për një nxënës të zellshëm. Ai regjistrohet në Fakultetin Juridik të Tetovës dhe përfundon vitin e parë, por meqë kishte një gjendje tejet të rëndë ekonomike, ai detyrohet që krahas studimeve të punoj edhe punë private në një çajtore të Shkupit. Ndërkohë, në tetor të vitit 1997, Nehati ftohet në kryerjen e shërbimit ushtarak të cilin edhe e kryen në korrik të vitit 1998. Shpërthimi i luftës në Kosovë dhe dëbimin e popullatës shqiptare nga trojet e tyre etnike, dëshmori Nehat Curri e përjeton rëndë. Ai do t`u gjendet në çdo lloj ndihme refugjatëve dhe tanimë shtëpia e tij ishte mbushur plot kosovarë të ardhur nga Hani i Elezit dhe vendet tjera. Ndër këto familje ishte edhe familja e dëshmorit Imri Curri.Pas kryerjes së shërbimit ushtarak, Nehati vazhdon studimet pranë Universitetit të Tetovës dhe krahas studimeve fejohet me Bahrijen nga Tanusha, bijë e trakalaqëve, që nga Tanusha ishin vendosur në Vezbeg të Shkupit..

Pas fillimit të luftës së UÇK-së në Maqedoni, armata maqedonase kërkonte mobilizim të rezervistëve për luftë.Kërkesa të tilla u dërgoheshin edhe rezervistëve shqiptarë e ndër këta rezervistë kërkohej edhe Nehat Curri.

Meqenëse Nehat Curri gjatë fëmijërisë e më pas, kishte krijuar një vetëdije të shëndoshë kombëtare dhe e dinte mirë se një kërkesë e tillë do të thotë luftë vëllavrasëse brenda shqiptarëve, ai refuzon t`u pergjigjet insitucioneve maqedonase për mobilizim dhe fillimisht largohet nga shtëpia dhe strehohet te më të afërtit e tij si në Shkup dhe në Han të Elezit dhe në ndërkohë, meqenëse lufta zhvillej me tërë intenzitetin e saj, pjesa

[48] Fadil Curri ,, A(h) fati(h) ynë në peshojë,Shkup,1994,fq.113

më e madhe e familjes së dëshmorit Nehat Curri, shkon si refugjat në Han të Elezit te të afërmit e tyre në familjen Curri të kësaj qytetëze.

Shtëpinë në Dizhon e kisha plot refugjatë nga Haraqina, kujton nëna e dëshmorit Xhemilja, por meqë Nehati u deshtë të shkoj për Kosovë, unë shkova pas tij,ndërsa Rushani mbet në shtëpi.

Maji dhe qershori i ati viti mbi vendbanimet shqiptare kishte sjellur jo behar, por shkrumb e hi. Fshatrat shqiptare sulmoheshin nga aeroplanët ushtarak të marrë nga Ukraina, ndërsa nga toka sulmoheshin me tankse të marrë nga Bullgaria, por qëndresa shqiptare tanimë kishte marrë dimenzionin historik. Luftëtarët e UÇK-së nga Tanusha epike tanimë ishin shtrirë në tërë Karadakun e Shkupit dhe po i afroheshin Haraqinës, ndërsa në anën tjetër të Pollogut, në fshatrat e lavdisë të shpatijeve të Sharrit, gjëmonin armët e lirisë.

Në këto rrethana, pas disa ditësh, Nehat Curri nga Hani i Elezit kalon në qytetin e Vitisë. Vëllau i dëshmorit Hakimi, thotë se Nehati në UÇK ka shkuar edhe me shokë të tjerë dhe për këtë i ka treguar familjes. Nehati për lirinë kishte vizion të qartë, shprehet Hakimi, pa liri, thoshte Nehati, jeta s`ka kuptimin e saj dhe se robërinë e pranojnë vetëm shpritrat e robëruar.

Me Nehat Currin u takova në Kaçanik, rrëfen Bekim Dardhishta, pjesëtar i UÇK-së, si në luftën e Kosovës dhe në ate të Maqedonisë. Pasi më përqafi dhe më uroi që plagët të më shërohen sa më shpejtë, kërkoi nga unë që ta ndërlidh me vijën e luftës. Pas një jave, më lajmëroi komandant Teli dhe më kërkoi që të nisem për Haraqinë dhe mendja menjëherë më shkoi te Nehati. I tregova se të enjten duhet të takohemi te restorant „Drenica" në Viti dhe do të udhëtojmë për Haraqinë se po na fton komandant Teli. Në orën 17 u nisëm për Lubishtë, por pa Nehatin. Kur arrijë në Lubishtë, shokët e furnizimit në Viti, më telefonojnë se ka ardhë Nehat Curri dhe ju kërkon. Kur kolonat e ushtarëve niseshin për fronte lufte, nuk shkonim duke u ndalur rrugës, thotë Bekim Dardhishta, por ky rast ishte më ndryshe, ndoshta shpirtërat kërkonin takimin dhe u thash furnizuesve që niseni menjëherë Nehatin për në Lubishtë. Në shtëpinë ku logjistika kishte caktuar vendstrehimin, ishin rreth 150 ushtarë, të cilëve me plot krenari iu shtua edhe Nehat Curri dhe vija e udhëtimit tonë ishte: Lubishtë-Malinë-Likovë-Haraqinë. E lumnueme ishte ajo ditë kur Nehati veshi uniformën e UÇK-së. Fytyra i shkrepte nga gëzimi. E paisa me një pushkamitralez dhe dy „zola''dhe pasi e urova për suksese, u nisëm rrugës gjarpërore të Malinës.

Ne u patëm mësuar me luftën, thotë nënë Xhemilja.Viti 1999 na pat djegë e përvluar, pasi nga familja jonë, në luftën e Koshares ranë për atdhe

Zekirija Dardhishta dhe Imri Curri. Të parin e kisha djalë vëllau, ndërsa të dytin djalë kunati. Bile kur u vra Imriu në Koshare, familja e tij nga Kosova ishte refugjat te ne në Dizhon të Shkupit. Nuk mund t`i harroj ato ditë kur morëm lajmin e vrasjes së Zekrisë dhe të Imrisë, por çka të bësh, lufta kërkon kurban, thot kjo nënë me besim të thellë në caktimin (kaderin) e Zotit të Madhërishëm. Tani po përgatitnim dëshmorin e tretë, shton ajo.

Para se të arrijmë në Malinë, thotë Bekim Dardhishta, një ushtar nga kolona më lajmëroi se Nehati ka marramendje dhe me shpejtësi iu afrova. Kokën e tij e vendosa pë prehërin tim. Fytyra e tij shëndriste si nurë dhe me dorën e tij ma dha pushkomitralezin dhe ,,zolat'' e bashkë me armët me gojën e tij më la amanetin: Merrmani hakun! Amanetin që ma la Nehat Curri, ia tregova komandant Telit në Haraqinë dhe pas disa orëve me ,,Zolën'' e Nehatit në krah, erdhi te vendi ku isha i plagosur, dhe më tha: Bekim, amanetin e dëshmorit e realizova. I lehtë i qoftë dheu i atdheut!

E premte ishte ajo ditë e 21 qershorit 2001, kur mora lajmin për vdekjen e Nehatit. E dija se atë ditë do të merrja një lajm të rëndë se gjatë natës pash në ëndërr shumë krushq që vinin rreth një mali dhe këtë ia tregova vajzës sime Habibes dhe vërtetë s`shkuan pak orë dhe lajmi nga krushqit e lirisë më erdhi, kujton nëna e dëshmorit, Xhemilja, ndërsa po atë ditë, Haraqina sulmohej prej të gjitha anëve.

Trupin e pajetë të dëshmorit Nehat Curri e kanë marrë pjesëtarët e logjistikës së UÇK-së të Brigadës 113 ,,Ismet Jashari-Kumanova'' në fshatin Lubishtë si Haxhi Qerimi, Lulzim Ferizi e Vebi Xhemshiti të gjithë nga fshati Lubishtë dhe gjatë natës dëshmori Nehat Curri ka qëndruar në shtëpinë e Haxhi Qerimit ku më pastaj Haxhiu sjell lajmin në familjen e dëshmorit në Han të Elezit ku qëndronte familja e Nehat Currit si refugjat.

Xhevdet Isen Dernjani, djalë teze i dëshmorit, thotë se Nehati ka qëndruar në familjen tonë dhe për dëshmorin ruaj kujtime mbresëlënse. Ai ishte adhurues i luftës për liri. Shpesh më thoshte se ka pasur dëshirë të jetë pjesëmarrës edhe në luftën e Kosovës dhe shpesh zinte në gojë dëshmorin Zekri Dardhishta, rënë në Koshare më 17 prill 1999, të cilin e ka dashur shumë sepse e ka pasur edhe djalë daje, kujton ai.

Meqenëse, lufta në Maqedoni vazhdonte me tërë intenzitetin e saj, nga vijat e luftës, nëpërmjet qytetit të Vitisë trupi i pajetë i Nehat Currit arrin në Han të Elezit. Ate e sjellin të afërmit e tij, përkatësisht kusheriri i tij, arsimtari Misim Curri, në shtëpinë e të cilit ishte familja e dëshmorit. Me kërkesën e familjes së tij, më konkretisht të babë Rushanit, dëshmori

Nehat Curri varroset me nderime kombëtare në varrezat e dëshmorëve në Puset e Nikës. Ai jetoi 23 vite dhe ishte i pamartuar. Për kontributin e tij kombëtar, nga insititucionet përkatëse është nderuar me mirënjohje.

Familjarët e dëshmorëve pranë varreve të më të dashurve të tyre në Puset e Nikës

Pllakë përkujtimore për dëshmorin Nehat Curri

Për të pasuruar edhe më shumë biografinë e dëshmorit Nehat Curri, ne po e botojmë (pa ndërhyrje) edhe një shkrim të shkrimtarit Fadil Curri i cili mban titullin:

Nehat Rushan Curri (1978-2001), ra dëshmor rrugës për në Haraçinë për t`iu bashkuar komandant Telit, botuar në vitin 2021

Shkruan: Fadil Curri

Në Kompleksin Memorial të Hanit të Elezit në Puset e Nikës, fole e UÇK-së e këtyre anëve, gjendet edhe varri i Nehat Currit, dëshmorit që gjeti vdekjen në malet e Karadakut të Shkupit rrugës për në Haraçinë për t'iu bashkangjitur njësitit të Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare të Maqedonisë, të prirë nga komandant Teli i lavdishëm. Vdiq me uniformë dhe armë çlirimtare të ushtrisë që e donte, me emblemën që e ëndërronte jetërisht. Kjo e vërtetë del së paku nga rrëfimet e të tjerëve, familjarëve dhe bashkëluftëtarëve të Nehatit, të cilat i përshkruan me dinjitet autorial në librin e tij "Flakadanët e lirisë" biografi i dëshmorëve të kësaj ane, Shaban Çupi.

Figurën e Nehatit nuk e bën interesante vetëm vdekja e tij për popull e atdhe, por historia patriotike familjare, e rrethit dhe biografia e tij. Këtë herë përciptazi do të shënojmë disa.

Nehat Curri u lind në Shkup më 1978 në familjen e prindërve Rushan e Xhemile me prejardhje nga Dërmjaku i Hanit të Elezit dhe Kërbliqi i Kaçanikut. Familjet e prindërve kishin histori dinjitoze të vuajtjes dhe të flijimit për atdhe, si nga nëna, ashtu edhe babai. Nga nëna njihet historia e jesirëve dhe e syrgjynëve gjatë luftës së parë ballkanike deri në Rumani, bile edhe me vdekje rrugëve. Në vitin 1912 familja e Rushan Currit nga Armata III Serbe e gjeneral Bozhidar Jankoviqit iu vra gjyshi Liman Bektesh Curri. Edhe gjatë Luftës II Botërore familja paraardhëse e Nehatit mori pjesë në lufë antifashiste deri në Simitli. Pas masakrës masive në Bllacë familja e Rushan Currit u bë shtëpi e dytë e bllacjanëve për strehim, veshmbathje e ushqim, sa si rrëfente Rushani, ai e vëllezërit e tij flenin mbi magje, ngase të gjitha dhomat ishin mbushur me bllacjanë, ndonëse ishte shtëpia më e madhe në fshat. Pas trazirave të vitit 1981 familja e Nehatit ishte shumë aktive në lëvizjen kombëtare dhe shpesh pikë kontrolli e policisë së atëhershme jugosllave natën e ditën. Edhe gjatë viteve nëntëdhjetë familjarët e tij morën pjesë në krijimin e celulave të para të UÇK-së bashkë me heronjtë e mëvonshëm Hamëz e Adem Jashari, Abdyl Krasniqi, Mentor Kaçi, Fatlik Lila e të tjerë, duke krijuar Frontin e Rezistencës dhe uniformat ushtarake shqiptare. Gjatë luftës së fundit në

Kosovë më 1999 Nehatit iu vranë dy kushërinj të parë në thyerjen e kufirit ndërshqiptar Shqipëri-Kosovë në Koshare, djali i xhaxhait Imri Pajazit Curri dhe djali i dajës Zekerija Musli Dardhishta. Në çdo luftë familja e tij dha ndihmën e mundshme dhe në këtë frymë liridashëse u rrit dëshmori tematik i sotëm, Nehat Curri, e formoi personalitetin e tij patriotik e flijimtar.

Njihej si nxënës i mirë i shkollës fillore të lagjes që sot e mban emrin e Imri Elezit, dëshmorit të Lagjes së Dizhonit të Çairit të Shkupit, e cila lagje ishte shembull se si luftohej për të drejtat e shqiptarëve në Shkup dhe ishte halë në sy për regjimin jugosllav në Maqedoni. Nga ky vendbanim në ushtrinë jugosllave dhe luftërat kombëtare shqiptare ranë shumë trima, si Enver e Imri Elezi, Nehat Curri e të tjerë. Pasi kreu gjimnazin“Zef Lush Marku”në Shkup Nehati regjistroi Fakultetin në Tetovë dhe si jurist i dinte dhe i ndjente katërcipërisht shkeljet e të drejtave të shqiptarëve më mirë se të tjerët. Rrënimin e shtëpive të kësaj lagjeje kur ishte fëmijë më vonë e kuptoi si heroizëm juridik të shqiptarëve të kësaj lagjeje, të cilët për herë të parë në Jugosllavi në Shkup bënë demonstrata publike rrugëve të Shkupit te qeveria e këtushme, akt që shkundi ndërgjegjen jugosllave e botërore, sidomos për republikat perëndimore, se me shqiptarët nuk është në rregull, se nuk u lejohen të drejtat e merituara baraz me popujt tjerë.

Në një poezi të tij shkrimtari i njohur botëror, Shandor Petëfi, shkruan vargjet se për dashuri jap jetën dhe për atdhe e jap dashurinë. Shembull tipik i kësaj porosie poetike ishte i riu 23-vjeçar Nehat Curri. Ky ishte student dhe i fejuar me një vajzë nga Shkupi. Dashurinë me të e ndjente lumturi, por disi të mangët dhe jo të plotë kur nuk ndjente paqen e lumturinë e popullit të tij shqiptar. Ndaj me bashkangjitjen radhëve të UÇK-së, dashurinë rinore e flijoi për mbidashurinë atdhedashuri. Kishte bindjen se pas luftës të drejtat e shqiptarëve do të rriteshin dukshëm dhe se dashuria me atdhedashuri do të plotësohej, ndonëse e dinte se shkuarja në luftë mund të jetë edhe fatprerë për jetën, ashtu si i ndodhi. Sidoqoftë, kishte bindje se ata që do të mbeteshin gjallë, do ta gëzonin lirinë e aspiruar brez pas brezi. Nehati nuk pati fat të martohej nga shkaku i vdekjes, por ëndrra e tij disi u realizua për të gjallët që e përjetuan lirinë që e donte shumë. Pra, Nehati për lirinë e vendit e tokës popullore e flijoi martesën e lumturinë personale.

Prindërit Rushan e Xhemile i kishin 5 djem e 3 vajza, por më shumë e përmendnin sugarin e tyre, Nehatin, mbase pikërisht për flijimet që bëri në jetë për të mirën e kombit dhe fatin e dhimbshëm jetësor. Kur e shikonte

njeriu Nehatin, shquante në të bukurinë e pashoqe prej bardhaveli, shijen e humorit në biseda familjare, por edhe fjalën e peshuar dhe të vendosur të dhënë, që e mbante pa u tundur. Është interesant të përmendet edhe fakti se kur u vranë dëshmorët familjarë Imri Curri e Zekirja Dardhishta, Rushani e Xhemilja ishin tejet durimtarë dhe ngushëllues për prindërit e këtyre dëshmorëve. Kur vdiq Nehati të njëjtin qëndrim durimi e patën, që flet se dëshmorët i konsideronin si të ishin fëmijët e tyre. Kishin falenderime te Zoti që ua kishte falur dhe mund t'ua merrte kur të donte. I gëzoheshin faktit se ua kishte lënë të kënaqeshin aq vite në të gjallë të tyre.

Nesër, e hënë e 21 qershorit do të shënohet e nderohet 20-vjetori i rënies së dëshmorit Nehat Curri. Në vendin e vdekjes në Karadak të Shkupit do të vendoset pllaka përkujtimore dhe në Han të Elezit pasdite do të bëhet akademia për shënimin e nderimin e figurës së tij. E meriton Nehat Curri dhe bashkëluftëtarët e tij, familja, Lagjja e Dizhonit të Shkupit, Hani i Elezit, lëvizja mbarëkombëtare për liri të merituar të shqiptarëve. Zoti i shpërbleftë flijimet e dëshmorëve e heronjve, invalidëve të luftës dhe të gjithë ata që e ndihmuan lirinë e shqiptarëve. Edhe Nehatit iu bëftë dritë në xhenet, kurse të gjallëve e gëzofshin lirinë me qëllim përparimi të mëtejmë, lirinë pa kufi të imponuar, por të natyrshme e të merituar. Logjika e vdekjes për liri e dëshmorëve është e përgjithshme, jo e vetëm një familjeje, e një krahine, e një partie, jo e pjesshme, por për Shqiptari. Kështu na mësojnë veprat e dëshmorëve e heronjve nga anë e besime të ndryshme shqiptare, që falën jetën në vende të ndryshme, Kosovë, Maqedoni, Preshevë, nga një kufi në tjetrin. Kjo filozofi kombëtare e njerëzore ishte si formulë patriotike edhe për Nehatin dhe rininë e brezit të tij për një Zot, gjuhë, flamur e atdhe.

Qemal Thaçi (1975 – 2001)

Shqiponja krahthyer
Me shpejtësi sjell lajmin:
U vra Qemal Thaçi,
Që pushkën kurrë se ndali.
Luftoi në Puse t'Nikës,
Luftoi në Preshevë
U vra në Nerasht,
Flamur për betejë.

Në pjesën jug-perëndimore të komunës së Hanit të Elezit shtrihet fshati Kryenik, fshat i cili në dokumentacione të ndryshme historike daton i lashtë, ashtu siç janë të stërlashta gjitha trojet shqiptare, por fatkeqësisht të ndara e të coptuara që nga Kongresi i Berlinit e këtej. Pozita gjeostrategjike e fshatit Kryenik, ndikon që ky fshat të komunikoj natyrshëm me viset shqiptare në Maqedoni si; Greqan, Sillare e Radushë dhe me gjithë Rrafshin e Pollogut dhe gjatë mbijetesës së tij, Kryeniku është djegur dhe pjekur disa herë nga pushtuesit. Në këtë fshat u lind edhe dëshmori i trojeve etnike shqiptare Qemal Thaçi. U lind më 15 prill të vitit 1975 nga babai Islami dhe nëna Shahadije të cilët në jetën e tyre martesore kishin pesë fëmijë: Qemalin, Xhemshiun, Sadatin, Hirmeten dhe Lemen. Qemali ishte fëmiu i parë i Islamit e si i tillë ishte më i dashuri. Fëmijërinë e kaloi buzë krojeve të katundit me këngët, vallet dhe lojrat popullore të trashëguara nga brezi në brez. Kur i mbushi shtatë vite, regjistrohet në shkollën fillore të fshatit me dëshirë që nesër të bëhej mësues, apo diçka

tjetër, por kushtet e vështira ekonomike që i kishte në familje bënë që Qemali të mbetet vetëm me shkollë fillore pa i shkuar mendja se kur të bëhej më i madh do ta kryente me nderë artin ushtarak të atdheut, përkatësisht do të ndeshej me bajloz të zi të cilët shqiptarëve ia kishin errësuar jo vetëm jetën, por edhe të ardhmen e tyre.

Dhunën dhe brutalitetin serb, dëshmori Qemal Thaçi e përjetoi që në vitet e 90-ta, kur policia serbe ia torturojnë rëndë axhën e tij Xhevahirin.

Brutalitetin e policisë serbe e përjeton edhe në rrahjen pothuajse të tërë fshatit për armë dhe me fillimin e luftës banorët e këtij fshati me dhunë shpërngulen në Sillare të Maqedonisë, ndërsa Qemali bashkë me shumë bashkëmendimtarë të tij i bashkangjitet radhëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në Puset e Nikës në kuadër të së cilës tregoi një shkathtësi të veçantë ushtarake.Qemal Thaçi , krahas betejave të tjera pothuajse të përditshme në Puset e Nikës, mori pjesë dhe me plotë guxim edhe në aksionin e Kryenikut të datës 31 maj 1999 kundër forcave policoro-ushtarake serbe, të cilët shtëpitë shqiptare i kishin zaptuar si kazerma dhe ky aksion ishte njëra prej betejave më rezultative të Brigadës 164 ,,Gafurr Loku‘‘ të UÇK-së në Han të Elezit.

Me përfundimin e luftës në Kosovë dhe me çlirimin e saj nga pushtuesi serb, shqiptarët që jetojnë në Preshevë, Medvegjë e Bujonoc gjendeshin para një rreziku shfarosës, pasiqë në këto zona ishin koncentruar të gjitha forcat kriminale serbe të cilat u tërhoqën me turp nga Kosova dhe në këto rrethana si nevojë imediate u paraqit formimi i UÇPMB-së.Duke mos mbyllur sytë para këtij fati kombëtar, Qemal Thaçi që në orët e para i bashkangjitet kësaj ushtrie, por tani me një përvojë të madhe që kishte marrë gjatë luftës çlirimtare në Kosovë. Siç dëshmon bashkëluftëtari i tij Mevlud Krasniqi ,,Qemal Thaçi si ushtar i UÇPMB-së ka filluar veprimtarinë e tij në Zonën e Karadakut që më herët, por në fillim të shkurtit 2001 unë Mevlud Krasniqi, bashkë me Shahadin Qajanin, Çelik Lokun dhe Qemal Thaçin pasi shprehëm dëshirën tonë që t`i bashkangjitemi radhëve të UÇPMB-së, nën udhëheqjen e Qemal Thaçit kemi udhëtuar për Gjilan prej kah kemi shkuar në fshatin Muqibabë ku edhe kalojmë kufirin e Kosovës dhe futemi në fshatin Seferaj të Bujanocit ku ishin pozicionet e UÇPMB-së. Gjithë këtë rrugëtim e bëmë nën drejtimin e Qemal Thaçit, pasiqë ai i njihte këto shtigje, sepse siç tham Qemali në radhët e UÇPMB-së, përkatësisht Brigadës 115 ishte që në themelimin e sajë. Ne, vazhdon rrëfimin e tij Mevlud Krasniqi, kemi vepruar në zonën ushtarake të Karadakut dhe komandant kishim Nejazi

Azemin i njohur ndryshe si komandant ,,Mjekrra‘‘ . Meqënëse pozicionet serbe nuk ishin më largë se 500 metra në vijë ajrore dhe rreziku nga snajperët ishte evident hapëm istikame të thella. Një rol pothuajse të veçantë pranë UÇPMB-së kishte edhe Qemal Thaçi dhe kjo vërehej nga respekti që komanda e Brigadës kishte për te e në veçanti komandanti Nejazi Azemi. Qemali si ushtar i devotshëm dhe i dashur që ishte, i ka dashur shokët e luftës dhe në luftë ka dhënë kontribut shumë të madh.Ishte guximtar dhe në çdo moment ishte i gatshëm për aksion që ndërmerrnin forcat çlirimtare të UÇPMB-së. Këtë guxim e dëshmoi edhe në aksionin e ndërmarrë gjatë sulmit të pozicioneve serbe ku për pasojë vritet komandanti i Brigadës 115 Nejazi Azemi. Ai u vra më 26 mars 2001 dhe ishte nga Mogilla e Vitisë. Qemali si ushtar besnik që ishte, në momentin që u vra komandanti, në afërsi të fshatit Stanec, me zjarr të rrëmbyeshëm e me plot mllef ka mbuluar hapsirën luftarake me të vetmin qëllim tërheqjen e trupit të Nejazi Azemit që të mos bie në duart e armikut. Qemal Thaçi, krahas pjesëmarrjes së tij në luftë, ndikoi edhe në masovizimin e ushtrisë së UÇPMB-së me vullnetarë nga Hani i Elezit. Komandant ,,Mjekrra‘‘ gjithnjë e merrte me vete. Ai tregohej shumë i aftë në përdorimin e armës. Barte gjithmonë armë të kalibrit të madh dhe respektonte rregullat e luftës’’, kujtojnë me pietet shokët e tij bashkëluftëtarë.

Dhe jo vetëm kaq, me shpëthimin e luftës në trojet etnike shqiptare në Maqedoni, e sidomos kur me 29 mars 2001 forcat sllavomaqedonase me granata sulmuan fshatin Kryenik, e për pasojë u vra Ilaz Thaçi, Baki Krasniqi, Raif Thaçi, gazetari Kerem Leëton, e shumë të tjerë u plagosën dhe u dëmtuan shtëpitë, Qemal Thaçi, kërkoi nga eprorët e tij që të tërhiqet nga radhët e UÇPMB-së dhe i bashkangjitet radhëve të Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare, ku si viktimë nuk ishin më vetëm fshatrat shqiptare në Maqedoni, por flakët e luftës kishin përfshirë edhe fshatin e tij Kryenikun i cili është brenda hapsirës territoriale të Kosovës.

Shokët e tij bashkëluftëtarë[49] dëshmojnë se ndër grupet e para të luftëtarëve që u futën për Radushë ishte edhe Qemal Thaçi. Paraprakisht ishte takuar me komandantin Rafis Halitin ,,Mësuesin’’ si dhe me shokët e tij Çelik Lokun e Sami Lokun, pjesëtarë të UÇPMB-së. Në fshatin Rezhancë vesh uniformën e UÇ-Kombëtare dhe orëve të vona të natës, kalojnë në Radushë.Qemal Thaçi me bashkëluftëtarët e tij vendosen në fshatin Vorcë dhe pozicionohen në vendin e quajtur Lugi i Thanave. Fillimisht detyrë parësore e Qemalit dhe shokëve të tij ishte sigurimi i

[49] Informatë marrë nga Shoqata e Familjeve të Dëshmorëve në Han të Elezit me dëshmi të: Burim Bushi, Orgjan Hasallari e Ramush Hasallari.

territorit për bartjen e armëve si dhe ushtarëve të rinjë të cilët shtoheshin për çdo orë.

Bashkëluftëtarët e tij dëshmojnë se Qemali ishte luftëtar sypatrembur dhe gjithmonë printe i pari në rreziqe. Rreziku i madh ishte edhe në vendin e quajtur Reka e Thatë, ku ditën qëndronin forcat maqedonase, por s`dinim se ç`gatuante armiku natën. Pas disa ditëve forcat sllavomaqedonase tentuan të hyjnë në fshatin Vorcë, ku tanimë UÇK kishte bazat e veta. Si strategji, e përcjellur që nga luftërat e Skënderbeut kundër pushtuesit turk, luftëtarët e UÇK-së lejuan që forcat maqedonase të futen të pasulmuara në brendi të fshatit dhe pas daljes nga fshati, forcat maqedonase hasën në pritën e organizuar mirë të UÇK-së dhe forcat armike pësojnë humbje në teknikë luftarake dhe në ushtarë. Në këtë sulm, krahas shokëve të tjerë mori pjesë edhe dëshmori Qemal Thaçi.

Gjatë luftës në trojet shqiptare në Maqedoni, Qemali plagoset gjatë minimit të urave me të cilat minime synonte t`ia ndërpres lëvizjen armikut dhe për njëkohë qëndron në spital.Ende pa u shëruar mirë, kthehet në istikame të luftës pranë Brigadës 112 „Mujdin Aliu‘‘ në Radushë, dhe gjatë një beteje tjetër, armiku dëmtohet rëndë dhe në panik u merret edhe një tank, ndërsa dëshmori Qemal Thaçi arrin që ushtarit maqedonas t`ia merr edhe automatikun nga tanku.

Veprimtaria kombëtare çlirimtare e dëshmorit Qemal Thaçi, ndërpritet me vrasjen e tij më 28 korrik 2001 në Nerasht të Tetovës, duke mbetur i pavdekshëm në historinë kombëtare dhe në kujtim të thellë të bashkëluftëtarëve të tij.Veprimtaria atdhetare e dëshmorit Qemal Thaçi mbetet veprimtari motivuese për brezat që vijnë. Varroset më 30 korrik 2001 në varrezat e dëshmorëve të Puseve të Nikës në Han të Elezit, atje ku edhe filloi veprimtaria për çlirimin e trojeve shqiptare. Për dëshmorin Qemal Thaçi janë shkruar këngë e janë thurur vargje, ndërsa për kontributin e tij kombëtar është nderuar me mirënjohje.

Qemal Thaçi si ushtar i UÇPMB-së

Në nderim të dëshmorit Qemal Thaçi, pllakë përkujtimore u ngrit edhe në fshatin Radushë ku në vitin 2001 ishte zonë lufte. Në rend të parë Komandanti i Brigadës 115 të UÇ- Kombëtare, Rafis Haliti ,,Mësuesi'' bashkë me shumë luftëtarë lirie.

Ramadan Shiti (1983 – 2007)

Xherdanin me fishekë
N`karvanin e lirisë
Aty ishte Ramë Shiti
N`mbrojtje të Iliridës.

Betejë pas beteje
Në luftë me sllavomëdhenjë
N` Brodec u rilind
Bashkë me shokë të tjerë.

Flijimtar si Oso Kuka
Që ra në Vraninë
Ra për t`mos vdekur kurrë
Që shqipja të gëzoj lirinë.

Ramadan Shiti u lind më 9 maj 1983 në fshatin Dimcë të komunës së Hanit të Elezit. Shkollimin fillor e ka mbaruar në shkollën ” Tefik Çanga” tashmë shkolla fillore Ilaz Thaqi. Kur filloi lufta në Kosovë, Rama ishte vetëm 15 vjeçar. Edhe pse në këtë moshë fare të re, ku pushka ishte më e gjatë se trupi i tij, Ramadan Shiti i bashkangjitet radhëve të UÇK-së duke u kalitur në betejat e lirisë. Pas përfundimit të luftës në Kosovë, fillon lufta në Preshevë, dhe Rama i bashkohet luftës për liri radhëve të UÇPMB-së. Pas përfundimit të luftës në Preshevë dhe nisjen e luftës në Maqedoni, Ramadan Shiti i bashkëngjitet radhëve të Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare dhe mori pjesë në shum beteja. Pas luftës, Ramadan Shiti akuzohet nga forcat sllavo-Maqedonase me disa akuza (shpifje) dhe burgoset. Pas një kohe Rama arrinë të ikë nga burgu i Maqedonisë dhe shkon në fshatin Kondovë, ku aty me disa ish ushtarë të UÇK-së, mbrohen me pushkë nga

akuzat. Një burgosje të tillë Rama e përjeton edhe në Kosovë nga ushtarët e KFOR-it, dhe pas burgosjes arrinë të ikë edhe nga burgu i Dubravës dhe shkon në malësinë e Tetovës më saktë në fshatin Brodec, dhe atje formojnë grupin e tyre në mbrojtje nga forcat sllave. Pas disa muajsh qëndrimi në këtë vend, organizohet befasisht një sulm i forcave sllavomaqedonase, me tanke, autoblinda e helikopter dhe në këtë aksion kanë marrë pjesë shumë mercenar nga Serbia. Fillimi i sulmit u bë në orët e hershme të mëngjesit të 7 nëntorit 2007 dhe luftimet kanë zgjatur gjatë tërë ditës. Forcat pushtuese, humbën teknikë luftarake në mesin e tyre edhe një helikopter dhe shumë makina ushtarake mbeten të djegura, por gjatë këtyre luftimeve të rrepta, disa shokë të tij tërhiqen e disa mbetën të vrarë. Në këto rrethana, Ramadani mbet i vetmuar pa municion dhe i plagosur. Sipas banorëve të fshatit që e kanë vërejtur me sytë e tyre ngjarjen, Ramës i afrohen 5-6 polic maqedonas për ta kapur të gjallë. Për të mos rënë në duart e tyre, Ramadan Shiti, aktivizoi bombën duke i vrarë të gjithë ata, dhe njëkohësisht u vetëvra duke rënë Dëshmor për mos të vdekur kurrë.

Pas dhjetë dite, trupi i pajetë i Ramadan Shitit vjen në Kosovë dhe me 17 nëntor 2007, varroset në fshatin e tij të lindjes. Ishte një varrim madhështorë. Krahas bashkëqytetarëve të tij, në varrim morën pjesë edhe shumë bashkëluftarë të tij anë e kënd trojeve shqiptare.

Por pas verifikimit te listave nga ana e Komisionit qeveritar për njohjen dhe verifikimin e statusit të dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile dhe familjeve të tyre i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 04/L-172, si dhe Ligjin Nr. 04/L -261 për Veteranët e Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, statusi i dëshmorit të kombit iu dha edhe dëshmorit Ramadan Shiti.

Ramadan Shiti u rivarros me nderime ushtarake në Varrezat e dëshmorëve në Puset e Nikës më 29 gusht 2017. Qindra qytetarë ishin tubuar në kompleksin e Varrezave në Puse të Nikës për të bërë homazhe dhe nderuar Dëshmorët e Hanit të Elezit. Përfaqësues të institucioneve, shoqata të dala nga lufta, familjarë të familjeve të dëshmorëve dhe shumë qytetarë me respektin më të lartë u përkulën para Lapidarit, simbol i sakrificës së dëshmorëve.

Me ceremoni më të larta ushtarake trupat e dëshmorëve u përcollën nga pjesëtarët e Forcës së Sigurisë së Kosovës. Në fjalën e rastit të kryetarit të atëhershëm të komunës z. Rufki Suma, tha se: Jemi tubuar sot këtu, pikërisht në Ditën e Dëshmorëve të komunës Hanit te Elezit për të bërë

rivarrimin e dëshmorit Ramadan Shiti nga fshati Dimcë i Hanit të Elezit. Ramdan Shiti, UÇK-së iu bashkangjit që në moshë të re në vitin 1999. Ai dha një kontribut të madhë në UÇK pranë Brigadës 164,,Gafurr Loku'' në fshatin Gjergjedell, në UÇPMB në mbrojtje të viseve shqiptare të Kosovës Lindore si dhe në vitin 2001 në trevat shqiptare në Maqedoni. Ramadan Shiti jo vetëm që mori pjesë në luftë, por u tregua edhe shumë i suksesshëm në beteja. Sukseset e Ramës në luftën e vitit 2001, nuk harroheshin nga pushtuesi sllavo maqedonas i cili tanimë kishte ndërruar formën e veprimit. Burgoste padrejtësisht dhe vriste ushtarë në forma të ndryshme dhe të gjitha këto, bënë që Ramadan Shiti të mos pajtohej dhe ky mospajtim solli edhe konfliktin me armë në vitin 2007 në Brodec të Tetovës, ku Ramadan Shiti vritet nga forcat policore-ushtarake sllavo-maqedonase, duke mbetur i pavdekshëm ndër ne dhe bashkëluftëtarët e tij, tha ndër të tjera Rufki Suma.

Momente nga rivarrimi dëshmorëve Ramadan Shiti e Izet Bushi më 29 gusht 2017 në Puset e Nikës

Rivarrimi në vitin 2017, Puset e Nikës

Izet Bushi (1971 – 1991)

U vra Izet Bushi
Kushtrimi ra në Puse të Nikës
Hakun duhet t`ia marrin
Kryetrimat, bijtë e shqipes.

Izet Bushi u lind më 15.07.1971 në fshatin Puset e Nikës të Hanit të Elezit. Një pjesë të shkollës fillore e kreu në fshatin e lindjes, ndërsa tjetrën në Han të Elezit. Mësimet i vazhdon pranë gjimnazit Skënderbeu në Kaçanik në drejtimin ekonomik dhe ishte një nxënës i mirë.

Izet Bushi, si nxënës i shkollës së mesme ishte pjesëmarrës i protestave dhe demonstratave që zhvilloheshin në Kosovë kundër politikës fashiste të Sllobodan Millosheviqit. Jehona e demonstruesve shqiptarë me kërkesën kushtrimore *„Jo, jo Serbi, nuk do të jesh perandori"* tanimë gjithkah kishte marrë dheun dhe çdo kund ku flitej për lirinë dhe çlirimin e atdheut, aty ishte edhe Izet Bushi.

Ishte koha kur mbi popullatën shqiptare bëhej një terror specifik. Brenda këtij plani antishqiptar ishte edhe dërgimi i ftesave tek të rinjët shqiptar për shërbimin e dhunshëm ushtarak jugosllav. Qershori i vitit 1990, Izet Bushin e gjen ushtar në Çupri të Serbisë. Ishte koha, kur nga kjo armatë famëkeqe jugosllave vriteshin ushtarët shqiptarë, ndërsa në Kosovë ktheheshin të mbyllur në arkivol të bllombuar duke iu thënë familjes se ushtari ka bërë vetëvrasje. Kështu ndodhi edhe me Izet Bushin. Vrasja u

organizua nga eprorët e tij në natën e Vitit të Ri, më sakt më 1 janar të vitit 1991.

E madhe ishte dhembja kombëtare për të rinjët tanë që vriteshin në kazermat jugosllave. Një dhembje e tillë e përjetoi edhe treva e Hanit të Elezit dhe jo vetëm. Më 4 janar 1991 u bë varrimi i Izet Bushit në prani të mijëra pjesëmarrësve. Shpatijet e Sumrekës ishin mbushur njerëz të ardhur anëve të ndryshme dhe në këtë mënyrë jo vetëm që i gjendeshin në ngushëllime familjes, por vetë pjesëmarrja e tyre ishte një protestë dhe revoltë kundër shtypjes serbe. Jo më shumë se 7 – 8 vite më vonë, pikërisht këtyre fushave dhe maleve epike të këtij vendi, shpërthejnë pushkët çlirimtare për liri. Ishte Ushtria Çlirimtare e Kosovës, ishin bijtë e saj më besnik që tanimë jo vetëm që po merrnin gjakun e Izetit, por hak po merrnin edhe për shumë nëna, hak po merrnin edhe për shumë motra, hak po merrnin për tërë Kosovën.

Me vendim të organeve gjegjëse, statusi i dëshmorit iu dha edhe Izet Bushit dhe pikërisht në Ditën e Dëshmorëve të Hanit te Elezit, me 29 gusht të vitit 2017, rivarroset në Varrezat e dëshmorëve në Puset e Nikës.

Në fjalën e rastit, ish kryetari i komunës, Rufki Suma, ndër të tjera tha se: Jemi tubuar sot këtu, pikërisht në Ditën e Dëshmorëve të komunës Hanit te Elezit për të bërë rivarrimin e dëshmorit Izet Bushi. Gjatë historisë një shekullore, dhuna, persekutimet, vrasjet dhe dëbimet e shqiptarëve nga pushtuesi serbo-sllav nuk kishin të ndalur. Të tilla ishin edhe vitet e 90-ta, të shekullit XX, vite të qëndresës shqiptare, vite ku sistemi socialist jugosllav i kishte çastet e fundit, por jo edhe pushtimi serb mbi Kosovën. Dhuna, ndjekjet dhe vrasjet në qenien shqiptare kishin marrë hov, mbi të gjitha në armatën e pushtuesit. Plumbat gjakatar, tinëzisht ranë edhe mbi trupin e njomë të Izet Bushit i cili u vra nga eprorët e tij serbo-jugosllavë në Çupri të Serbisë në natën e ndërrimit të motmotit, me 1 janar të vitit 1991. Izetin dhe shumë të tjerë si Izeti, jo vetëm që u vranë, por krimin e tyre antishqiptar, eprorët jugosllavë e justifikonin me vetëvrasje. E madhe ishte revolta qytetare për bijtë që u vriteshin në armatën jugosllave. Me qindra e mijëra vetë morën pjesë në nderim të tyre si kundër përgjigje ndaj vrasjeve që bëheshin ndaj më të dashurve të tyre. Kështu ishte edhe me varrimin e Izet Bushit në janarin e vitit 1991, të cilin pas 26 viteve, në rrethana krejtësisht të tjera, po e rivarrosim sot. E madhe ishte dhembja familjare, farefisnore, lokale dhe kombëtare sepse e thellë ishte robëria.

Momente nga rivarrimi i dëshmorit në vitin 2017, Puset e Nikës



Faksimil nga revista ,,Kosovarja'' rreth varrimit të Izet Bushit e janarit 1991

Revista ,,Kosovarja'' duke raportuar nga vendi i ngjarjes, njoftonte opinionin se në varrimin e Izet Bushit morën pjesë rreth 150 mijë veta.

Luftën për liri, sakrificën e të burgosurit, ushtarit, invalidit dhe sakrificën sublime të dëshmorëve të komunës së Hanit të Elezit, e nderoi dhe e vlerësoi lartë edhe simboli i rezistencës shqiptare për liri, Adem Demaçi. Ai me pjesëmarrjen e tij në manifestime, nderoi dëshmorët e kësaj komune. Dhe jo vetëm kaq, Adem Demaçi na nderoi edhe me pjesëmarrjen e tij në rastin e përurimit të librit të parë monografik për dëshmorët ,,Flakadanët e Lirisë'' që u mbajt në Prishtinë.
Andaj, përpjekjet dhe lufta për liri, komunën e Hanit të Elezit e bëri të barazvlerëshme me të gjitha pjesët e atdheut.

Rafi Halili, Binak Ulaj, Berat Luzha, Hydajet Hyseni me autorin e monografisë, Puset e Nikës 2019

Kompleksi memorial në Puset e Nikës

Luftës për çlirimin e Kosovës, treva e Hanit të Elezit, krahas burgosjeve[50], torturave[51] dhe protestave kundër dhunës dhe shtypjes serbe, qytetarët e kësaj ane iu kundërvënë edhe me kryengritje të armatosur dhe nëpër flakët e luftës, luftëtarët e kësaj komune ngritën Brigadën 164 „Gafurr Loku'' të UÇK-së, komandant i së cilës ishte Rufki Suma, zv.komandant Mehmet Ballazhi, ndërsa Emrush Suma me një pjesë të kësaj Brigade, përkatësisht me Batalionin e tretë, suksesshëm ka vepruar në anën tjetër të lumit Lepenc, në fshatin Gjergjedell.

Pjesëtarët e Brigadës 164 „Gafurr Loku'' të UÇK-së, jo vetëm që ranë në Puset e Nikës, por lufta e saj shkëlqeu edhe në Koshare, Pashtrik, Jezerc e Kaçanik duke mos lënë anash as rënien e dëshmorëve edhe në trevat etnike në Maqedoni.

Përfundimi i luftës[52], krahas të tjerave, solli si imperativ edhe rivarrimin e dëshmorëve i cili u bë më 29 gusht 1999 në Puset e Nikës, në truallin të cilin e falën familja Daci. Njëkohësisht kjo datë u caktua edhe si Dita e Dëshmorëve të komunës së Hanit të Elezit.

Për të respektuar e nderuar dëshmorët e rënë, me vetëkontributin e qytetarëve u ngrit edhe lapidari, një simbolikë unikale e së kaluarës, të tanishmës dhe të ardhmes së popullit shqiptarë, si dëshmi për qëndresën, luftën dhe çlirimin e Kosovës, përurimin e të cilit e bëri ish Kryeministri i Kosovës z. Bajram Rexhepi (tani i ndjerë) i shoqëruar nga kryeparlamentari Jakup Krasniqi (aktualisht, padrejtësisht në burgun e Hagës), gjenerali Shaban Shala (tani i ndjerë) dhe veprimtari Fazli Veliu.

Kompleksi memorial i dëshmorëve në Puset e Nikës, jo vetëm që u vizitua dhe vizitohet nga më të afërmit e dëshmorëve, por në shenjë

---

[50] Nga viti 1945-1999 kemi 23 persona të dënuar për vepra penale politike, 7 persona të dënuar në mungesë, 22 persona për kundëvajtje politike, 1 i pushkatuar në burgun e Dubravës, 1 vetëvrasje, 2 të shkëmbyer me ushtarët serb.

[51] Vetëm nga periudha 1990-1999 kemi rreth 600 banorë të trevës së Hanit të Elezit që janë keqtrajtuar nga policia serbe, ndërsa para lufte vriten: Izet Bushi, Selman Daci dhe nxënësi dhjetë vjeçar Isa Berisha. Gjatë luftës: Menduh Bushi, Xhevat Bushi, Adem Bushi, Afet Bushi, Hajdin Bela.

[52] Nga 21 shkurti 1999 deri më 9 prill 1999 u dëbuan rreth 10 mijë banorë me dhunë dhe u plaçkitë tërë pasuria e tundëshme dhe e patundëshme e qytetarëve si dhe u djegën shumë shtëpi duke shkaktuar dëme të mëdha ekonomike.Ndërsa nga 21 shkurti 1999 e deri në përfundim të luftës dhe më pas, 5 qytetarë gjejnë vdekjen në fusha të minuara: Feriz Guri ushtar, Xhevdet Guri ushtar, Isen Suma civil, Hasan Hasallari civil, Fadil Dernjani civil. Tetë qytetarë mbetën me këmbë të amputuara: Jahi Shkreta ushtar, Fuad Luri ushtar, Muhamet Maliqi ushtar, Kemal Beqa civil, Afet Vila civil, Zyber Suma civil, Sherif Krasniqi civil, Hazbi Shkreta civil.

respekti e nderimi, këtë kompleks deri më tani e kanë vizituar mijëra qytetarë nga viset e ndryshme të atdheut tonë ilirik. Xhamia-shkollë e rinovuar, shtëpitë kazerma, shtëpia ku qëndroi Delegacioni që po kthehej nga Konferenca e Rambujesë, bunkerët luftarak të UÇK-së dhe trashëgima tjetër e luftës dhe e vlerave të tjera kulturore e arkitekturale, po ndikojnë që çdo ditë e më shumë Puset e Nikës të jenë të vizituar nga subjekte të ndryshme.

Puna për ngritjen e lapidarit filloi në vitin 2001, ndërsa përurimi i tij u bë më 29 gusht 2003. Mjetet financiare për ngritjen e lapidarit ishin vullnetare. Arkitektët e lapidarit ishin shokët e dëshmorëve, bashkë-luftëtarët e tyre duke e konkretizuar idenë hap pas hapi. Lapidari është i gjatë 17 metra dhe ka këto simbolika:

Bazamenti tregon zonën e luftës në Puset e Nikës

Vazhdon me 8 këmbët e ushtarit të ngulur fortë në tokë, që simbolizojnë tetë dëshmorët e UÇ të Kosovës.

Vijat e mësipërme simbolizojnë 7 dëshmorët e UÇ-Kombëtare që ranë nga kjo anë në çlirimin e trojeve shqiptare në Maqedoni në vitin 2001

Emblema e UÇK-së në mes, ndërlidhë idealin e përbashkët të ushtrive çlirimtare, ndërsa në pamjen tjetër, paraqet rrypin e ushtarit.

Në maje të lapidarit qëndron plisi i bardhë i cili simbolizon lashtësinë dhe autoktoninë shqiptare. Lapidari përmban elemente edhe të uniformës së UÇK-së, pushkës automatike dhe të fishekut. Në pamje të dytë, Lapidari merr formën e luftëtarit të lirisë, ndërsa në pamje të tretë Lapidari ka formën e një rakete që synon hapësirat kozmike.

Kompleksi i varrezave të dëshmorëve në Puset e Nikës

Kryeministri Bajram Rexhepi, tanimë i ndjerë dhe kryeparlamentari Jakup Krasniqi (padrejtësisht në burgun e Hagës) në përurimin e kompleksit memorial në Puset e Nikës më 29 gusht 2003

Në Ditën e dëshmorëve, 29 gusht 2003 në Puset e Nikës. Në fokus Gjeneral Shaban Shala, tanimë i ndjerë

Familjet e dëshmorëve pranë më të dashurve të tyre

Në Ditën e dëshmorëve

Në Ditën e dëshmorëve

Në nderim të dëshmorëve dhe luftës për liri

Në përkujtim të dëshmorëve dhe luftës së tyre. Fotografi të vitit 2007

Nga e djathta: Nuri Brava dhe Rexhep Berisha (babai i Heroit Nuhi Berisha) nga Gjilani, tanimë i ndjerë, i cili na nderonte me pjesëmarrjen e tij në të gjitha manifestimet që mbaheshin në këtë komunë në nderim të luftës dhe dëshmorëve të atdheut

Arsimtarët nga qyteti i Bajram Currit - Tropojë gjatë vizitës në Puset e Nikës në vitin 2006

Në ditën e dëshmorëve

Bashkëluftëtarët e dëshmorëve

Kryetari i komunës së Hanit të Elezit, Mehmet Ballazhi, në nderim të dëshmorëve, Puset e Nikës 2022

Emblemat e tri Ushtrive Çlirimtare

Puset e Nikës, gurra e trashëgimisë sonë historike e kulturore

Vendbanimi i Puseve të Nikës shtrihet në anën e veri-perëndimore të qytezës së Hanit të Elezit, në lartësi mbidetare prej 871 metra. Në këtë vendbanim është edhe kufiri klimatik ndërmjet klimës së ndryshueshme mesdhetare që vie nga jugu dhe asaj të ndryshueshme kontinentale nga veriu. Vendbanimi i Puseve të Nikës shquhet me një pozitë të mirë gjeostrategjike dhe kufizohet me Malet e Sharrit në anën veriore dhe me Grykën epike të Kaçanikut.

Puset e Nikës si vendbanim është i hershëm dhe përbëhet prej disa lagjeve, apo mëhallëve, si: Bushët e Poshtëm, Bushët e Epërm, Dacët, Bravët dhe Ballazhët, ndërsa më herët në Puset e Nikës ka qenë i përfshirë edhe fshati Laç. Të gjitha këto lagje, pos jetës, punës, gëzimit dhe pikëllimit, si objekte shoqërore i ka bashkuar shkolla dhe xhamia.

Si vendbanim kodrinoro-malorë, siç thotë plaku Nuri Brava (1934), në të kaluarën ishte një vend pa udhë dhe si i tillë më rrallë frekuentohej nga policia e pushtuesit. Duke pasur parasysh se Puset e Nikës ishin një vend strategjik në kuptim luftarak, këtyre bjeshkëve janë strehuar edhe kaçak të ndryshëm që ndiqeshin nga pushtuesi.

Në Puset e Nikës në vitin 1920, në kohën e krajlit, për një kohë është strehuar edhe Salih Shabani nga Kabashi i Prizrenit. Këtë dëshmi e ka dhënë babai i Nuri Bravës, Xhavit Brava (1894-1971).

Po kush ishte Salih Shabani?

Salih Shabani vrau Spiro Dobrosavleviqin apo siç njihej ndryshe Spiro Kapetanin ose Spirë Dellovcin në vitin 1919. E vrau bashkë me truprojen e tij Filip Nedelkoviqin, të cilët në marsin e vitit 1913 bënë masakrën e Kabashit në Prizren ku u prenë me sakicë 99 burra shqiptarë. Gjashtë vite më vonë, Salih Shabani u zë pritë afër Grykës së Baqevcit, afër fshatit Grejkoc duke i ekzekutuar që të dy. Salih Shabani bëri hakmarrje kombëtare ndaj kriminelëve serb dhe meqë ndiqej egërsisht nga xhandarmëria serbe ai kaloi në Shqipëri. Salih Shabani nga vitet 1920-1923 rikthehet herë pas here nga Shqipëria në Kosovë dhe u ndihmon çetave kaçake nëpër male dhe kishte kontakte me Azem Bejtën e Bajram Currin. Gjatë këtyre viteve, kaçaku Salih Shabani është strehuar në Puset e Nikës. Salih Shabani ka vdekur në vitin 1936 në Shqipëri.

Krahas Salih Shabanit, në Puset e Nikës pas Luftës së Dytë Botërore është strehuar edhe kaçaku Avdyl Dura me shokë dhe Puset e Nikës ishin njëra nga bazat e tij. Ata ndiqeshin nga regjimi i Jugosllavisë së Titos. Si pasojë,

në vitin 1947, si bukëdhënës dhe mbështetës të Avdyl Durës dënohen me vite të gjata burgu Nazmi Brava e Rufat Brava nga Puset e Nikës. Për të njëjtën akuzë dënohen edhe Halil Rogaqi nga Rezhanca dhe Shefket Thaçi nga Kryeniku, ndërsa Islam Brava dënohet në vitin 1946. Pra, nga Puset e Nikës ishin edhe të burgosurit e parë kundër shtetit pushtues serb, duke u lënë gjeneratave pasuese një trashëgimi me vlera historike. (Më gjerësisht shih monografinë „Jatakët e Lirisë'' nga autori Shaban Çupi.) Krahas këtyre të burgosurve, në vitin 1991 u vra edhe Izet Bushi, ndërsa në majin e vitit 1999 në burgun e Dubravës u vra Suad Brava.

Duke pasur parasysh këtë pozicion strategjik, më 19 qershor 1998 në Puset e Nikës u formua edhe Njësiti i parë i UÇK-së i cili nëpër flakë lufte u ngrit në Brigadën 164 „Gafurr Loku''. Ky Njësit, mbështetjen e gjeti pikërisht te familja Brava, ku krahas mbështetjes ushqimore, iu bashkangjitën edhe si forcë luftarake. Shtëpitë e tyre u shndërruan në kazerma dhe Puset e Nikës u bënë mikëpritëse të luftëtarëve të lirisë që vinin nga anë të ndryshme të atdheut. Në këto shtëpi kazerma, në prillin e vitit 1999, një natë qëndruan edhe pjesëtarët e Drejtorisë Politike të UÇK-së që u kthyen nga Konferenca e Rambujesë, si Hashim Thaçi, Ramë Buja e Agim Çeku. Nëpër këtë zonë luftarake për në brendësi të Kosovës kaluan armë e municion, eprorë dhe logjistikë tjetër lufte. Rritja e numrit të ushtarëve, bëri që një pjesë e Brigadës të kaloj në anën tjetër të lumit, në fshatin Gjergjedell duke zgjeruar edhe më shumë zonën luftarake.

Pra, Puset e Nikës ishin dhe mbetën një vend me vlera të rralla historike, ishin dhe mbetën kalaja e qëndresës popullore për liri. Këtu u derdh gjaku i dëshmorëve, këtu mbetën gjymtyrë të këputura të trupit, këtu betejat i humbi edhe armiku, ndërsa më 11 qershor 1999, humbi edhe luftën.

Sot, Puset e Nikës janë shndërruar në një zonë rekreative dhe hulumtuese; qoftë nga aspekti historik, kulturor, etnologjik, antroponimik dhe arkitektural. Sa më largë që Puset e Nikës futen në histori, aq më afër na vjen qëndresa dhe jehona e sajë.

Si dëshmi të një kohe të rëndë, por shumë të lavdishme të luftës së UÇK-së në Puset e Nikës, shfaqim disa relikte si trashëgimi me vlerë historike: oxhakun ku nxeheshin ushtarët e UÇK-së, gjegjësisht dëshmorët, sofrën ku ngrënën bukën ata, hamamgjikun dhe bojlerin ku bënë pastrimin trupor, tangarin për prush, gjygimat për çaj dhe llambën me vajguri për dritë. Në kuadër të këtyre relikteve, bashkangjesim edhe një pjesë të shtëpive kazerma ku qëndruan dëshmorët dhe vijat mbrojtëse të luftëtarëve të lirisë, tanimë si pjesë e trashëgimisë sonë historike.

Oxhaku dhe sofra

Hamamgjiku dhe bojleri

Tangari, gjygimat dhe llamba me vajguri

Shtëpia ku qëndroi delegacioni i UÇK-së që u kthye nga Rambujeja

Në këtë shtëpi u vendos Shtabi i UÇK-së i Brigadës 164. Në këtë shtëpi qëndruan edhe shumë dëshmorë.

Bunkeri UÇK-së në *Kodër të Faslisë*

Vijat mbrojtëse të UÇK-së *Te qarrat*

Vijat mbrojtëse të UÇK-së në Lagjen e Dacëve në Puset e Nikës

Pasthënie

Që nga lirimi prej burgut të Nishit më 10 gusht 2000, dhe për 20 vite me radhë, jam munduar që dëshmorët e komunës së Hanit të Elezit, në forma të ndryshme t`i mbajmë prezent në mesin e nxënësve, studentëve, institucioneve, bashkëluftëtarëve e qytetarëve tanë; qoftë me monografi, qoftë me poema poetike, qoftë me shkrime nëpër gazeta dhe mjete elektronike, qoftë me fjalime në manifestime, qoftë me tekste këngësh, dokumentar nga lufta e lavdishme e UÇK-së e mënyra të tjera.
Mesazhin e dëshmorëve dhe rënien sublime të tyre për liri, kam synuar ta mbajmë në mesin tonë si trashëgimi me vlera të larta historike dhe në të njëjtën kohë, flakën e lirisë ta përcjellim te brezi i ri.
E tërë përpjekja ime ka qenë vullnetare, krejtësisht vullnetare, pasiqë e kam konsideruar detyrë timen dhe natyrisht që jam i kënaqur me punën e bërë.
Gjithçka që ka mbetur pa u thënë, e natyrisht që ka mbetur, rrjedh nga mungesa e informacionit, dhe për këtë kërkoj ndjesë nga vetë dëshmorët, familjet e tyre dhe bashkëluftëtarët.
Në fund, falënderoj të gjithë ata që më ndihmuan me informacione e forma të tjera, pavarësisht se shumicën e dëshmorëve i njihja në forma e situata të ndryshme në rrugën e lirisë e të çlirimit të atdheut.
Si gjithë të tjerët, edhe ne jemi qenie njerëzore dhe si të tillë nuk e dimë se ku dhe kur na *fiket kandili*, andaj urojmë që *Flakadanët e Lirisë* të vazhdojnë së botuari në numra të tjerë dhe nga autorë të ndryshëm.

Shaban Çupi: Autori i *Flakadanëve të Lirisë*, korrik 2022

Shënime për autorin

Shaban Çupi është i lindur më 2 janar të vitit 1961 në fshatin Paldenicë, komuna e Hanit të Elezit. Ka të kryer Fakultetin e Edukimit dhe në arsim punon nga viti 1980. Është dy herë i burgosur politik dhe ka mbajtur 6 vite burg. Është përjetues i masakrës serbe ndaj të burgosurve shqiptar në burgun e Dubravës në majin e vitit 1999. Ka qëndruar në këto burgje: Gjilan, Prishtinë, Lypjan, Gurakoc, Dubravë dhe në Nish të Serbisë.
Deri më tani ka botuar këto libra:
1.*Nga gjaku i tyre rrjedh liria*, poemë
2.*Gafurr Loku (1949-1999)* monografi
3.*Shënime në kohë të mugëllt-publicistikë*
4.*SHKA ,,Sharri'' në 40 vjetorin e aktivitetit" në Han të Elezit*-monografi
5.*Jatakët e lirisë*- monografi
6.*Gjurmime etnografike në trevën e Hanit të Elezit*
7.*Shkolla popullore shqiptare në fshatin Paldenicë*, me bashkautor
8.*Trashëgimia kulturore në trevën e Hanit të Elezit* me bashkautor
9.*Historiku i xhamive dhe shkrimet mbivarrore në trevën e Hanit të Elezit*
10. *Gafurr Loku në kthetrat e UDB-së*
11.*Veprimtaria poetike e grupit letrar ,,Luigj Gurakuqi'' (1991-1993) në Han të Elezit*
12.Buzëqeshje lirie, poemë kushtuar dëshmorit Gafur Luma
13. *Gafurr Luma*, jeta dhe vepra, monografi
14. *Gafurr Loku simbol lirie e bashkimi*, monografi
15. Nositët e lirisë, poemë kushtuar dëshmorëve të komunës së Hanit të Elezit
16. *Rrëfimet e Elez Hangjiut*, tregime

17. *Flakadanët e lirisë,* e botuar në emër të Shoqatës së Familjeve të Dëshmorëve të Hanit të Elezit, monografi
18. *Gjurmime antroponimike* në trevën e Hanit të Elezit
19.*Të burgosurit politik 1946-1999 në komunën e Hanit të Elezit,* monografi
20. *Flakadanët e lirisë 2* monografi për dëshmorët e komunës së Hanit të Elezit